BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

POLITEIA

Revistë shkencore

për studime juridike, sociale dhe politike

UMSHPRESS

Qershor 2023

BOTIM I UNIVERSITETIT MESDHETAR TË SHQIPËRISË

POLITEIA

Revistë shkencore për studime juridike, sociale dhe politike

POLITEIA

Scientific journal for law, social and political studies.

Editor in Chief/ Redaktor Shkencor:

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Scientific Board/Bordi Shkencor:

Prof. Dr. Paskal Milo

Prof. Dr. Gaetano Dammacco

Prof. Asoc. Nevila Rama

Prof. Asoc. Arben Cici

Prof. Asoc. Roland Lami

Prof. Asoc. Nevila Xhindi

Prof. Asoc. Alketa Elezi

PhD Kriton Kuci

PhD Besmir Premalaj

PhD Redion Luli

Dr. Ilir Hebovija

Dr. Emilio Cika

Dr. Luljeta Kodra

Dr. Gilda Hoxha

Dr. Klodiana Rafti

Editors:

Prof. Asoc. Nevila Rama
Prof. Asoc. Arben Cici
Prof. Asoc. Roland Lami
Prof. Asoc. Nevila Xhindi
Prof. Asoc. Alketa Elezi
PhD Kriton Kuci
PhD Besmir Premalaj
PhD Redion Luli
Dr. Ilir Hebovija
Dr. Emilio Cika
Dr. Luljeta Kodra
PhD. Erina Caka
PhD. Fiona Tako
Dr. Gilda Hoxha
Dr. Klodiana Rafti

Administrative assistant:

Dr. Gilda Hoxha

Redaktimi letrar&Arti grafik
Rita Mborja KANANAJ

POLITEIA është një revistë shkencore e cila publikon peer reviewed artikuj në shqip ose në anglisht në fushën e shkencave juridike, sociale, politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave humane. Revista publikohet dy herë në vit nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Revista ofron një hapësirë ku studiuesit të publikojnë punën e tyre kërkimore shkencore duke ruajtur standardet më të larta të kontrollit të cilësisë.

POLITEIA is a leading open access journal that publishes peer-reviewed research in Albanian or English on critical issues in law political and social science, international relations and related fields. It fosters both theoretical and quantitative contributions in the above mentioned fields. It is published twice a year by the Faculty of Law and Humanities of the Mediterranean University of Albania. The journal provides a venue for scholars to communicate, rapidly and succinctly, important new insights to the broadest possible audiences while maintaining the highest standards of quality control.

PËRMBAJTJA

1.	Hyrje për numrin e parë të Revistës shkencore ***Politeia*** – **një revistë e re në shkencat juridike dhe humane** – Prof. Dr. Ksenofon Krisafi	7
2.	Koncerti europian dhe shqiptarët - Prof. Dr. Ksenofon Krisafi	11
3.	Reform of the legislation on copyright in the framework of the approximation of the Albanian legislation with the acquis communautaire - Besmir Premalaj PhD	37
4.	Challenges of the Rule of law in Albania and prospects - Redion Luli PhD	59
5.	The evolution of the practice of gestation for others (surrogacy) throughout history and religion - Erina Caka Ph.D	79
6.	Analiza ekonomike e së drejtës. Shpjegimi i fenomeneve juridike me konceptet ekonomike - Prof. Dr. Adrian Civici	91
7.	Raporti qendër - periferi në situata krizash politike në Shqipëri - Prof. Asoc. Roland Lami, Dr.(p) Ilir Hebovija	113
8.	Qasjet Teorike në Studimin e Lëvizjeve Sociale - Dr. Gilda Hoxha	137
9.	Williams, Noli dhe Konica, ambasadorët e parë të marrëdhënieve Shqipëri-SHBA- Prof. Asoc. Arben Cici	153
10.	Evazioni fiskal në Shqipëri dhe Itali – një vështrim krahasues - Fiona Tako PhD	165

Politeia – një revistë e re në shkencat juridike dhe humane

Në katalogun e botimeve periodike në fushën e shkencave juridike dhe humane, i cili përbëhet ndoshta nga mijëra e dhjetëra tituj, shtohet sot edhe një tjetër titull, *Politeia,* në botimet shqiptare; ku numri i tyre edhe pse modest, vazhdon të rritet.

Ajo vjen si një përpjekje e sinqertë për t'iu bashkuar kontributeve të brezave të tërë, të cilët me përkushtim, rigorozitet shkencor dhe kompetencë të lartë profesionale, kanë synuar të çojnë përpara dijet dhe formimin e shoqërisë. në fushën e shkencave juridike dhe humane.

Kur po skicohej projekti i saj, u diskutua jo pak për titullin e saj, sepse ai, si njëlloj *Key word,* prezanton përnjëherësh thelbin e objektit të saj shkencor. Pati disa propozime, përgjithësisht me prejardhje nga gjuha latine, e cila parapëlqehet nga fakti se, për një kohë të gjatë, ka qenë gjuha e komunikimit politik, diplomatik, gjuha e shkencës, kulturës, artit etj.

Njëri nga anëtarët e bordit editorial, propozoi fjalën greke *Politeia*. Pasoi një çast hutimi, që nuk kishte të bënte as me fjalën dhe as me gjuhën nga e cila vinte. Duket se hezitohej të thyhej tabuja e latinishtes, aq shumë e përhapur edhe aktualisht në botën akademike. Por, edhe grekët, sikurse romakët dhe popuj të tjerë të antikitetit, përmenden veçanërisht për kontributet praktike institucionale. për instalimin e një mjedisi politik e social të bashkekzistencës dhe bashkëpunimit qytetar, për krijimin e një kulture, arti, shkence dhe qytetërimi nga më të zhvilluarit e kohës, që, siç thoshte Fridrich Engelsi, rrezatuan në qytetërimin romak. e përmes tij në mbarë kontinentin, duke u bërë djepi i qytetërimit dhe i kulturës evropiane. Pikërisht aty u hodhën themelet e vlerave materiale, shpirtërore, estetike, të

cilat më pas, në një shkallë apo në një tjetër, do të gjenin zhvillimin e tyre pothuajse në të gjithë popujt evropianë e më gjerë.

Grekët patën edhe meritën e përpunimit teorik të doktrinave të avancuara në fushat e politologjisë, filozofisë, sociologjisë, të drejtës etj.

Termi dhe koncepti *Politeia* është krijuar dhe përdorur në antikitet nga Platoni dhe Aristoteli. Nëpërmjet tij Platoni prezantonte vizionin e vet për një sistem politik ideal, kurse Aristoteli, krijuesi i shkollës peripatetike, shtjellonte kategorizimin e sistemeve politike, në të drejta dhe të gabuara, duke e konsideruar *Politeia*-n si sistemin më të mirë ndër sistemet e drejta. Njeriu, përbindësh ose zot, thoshte ai, nga natyra është një kafshë politike, që e gjen përmbushjen e tij vetëm kur është në marrëdhënie me të tjerët. Sepse është i destinuar të jetojë bashkë me ta, të përplaset, të negociojë, të krijojë, të vendosë rregulla dhe të marrë vendime të detyruara për veten dhe për të tjerët. Me fjalë të tjera, të bëjë POLITIKË. Komuniteti i organizuar politikisht është "natyra" e çdo shoqërie.

Politeia rrjedh nga fjala *polis* dhe ka një sërë kuptimesh, duke filluar nga "të drejtat e qytetarëve" deri te "format e qeverisjes". Në sensin e gjerë nënkupton tërësinë e rendit politik dhe social në *Polis*, njësi territoriale, politike dhe administrative e organizimit të lashtë helen. Në të njëjtën kohë nënkupton edhe të drejtën e qytetarëve për të kontribuar në ndërtimin e një rendi politik. Identifikohej gjithashtu me tërësinë e qytetarëve, me bashkësinë e atyre që kishin të drejta politike brenda *polisit*.

Politeia është një koncept i rëndësishëm, njëkohësisht filozofik dhe politik (praktik), kompleks dhe thelbësor, ashtu siç është vetë procesi nëpërmjet të cilit qytetarët angazhohen për të vendosur rregullat e përgjithshme të bashkekzistencës së tyre kolektive. Në këtë kuptim u gjykua se ajo mund të shërbejë mjaft mirë si një titull i denjë për një përpjekje kolektive akademike, siç është kjo revistë shkencore, e cila do t'i dedikohet studimit, analizës dhe trajtimit shkencor të zhvillimeve politike, shtetit, të drejtës,

diplomacisë, shkencave psiko-sociale dhe humaniteteve në përgjithësi, në vend, në rajon, kontinent e më gjerë.

Politeia do të jetë tribunë e mendimit të lirë, forum i shkëmbimit të ideve dhe pikëpamjeve shkencore për çështje të rëndësishme të zhvillimit ekonomik, politik, social, juridik etj.

Ajo do të jetë e hapur për të gjithë pedagogët dhe studiuesit e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë, universiteteve dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë të hapësirës shqiptare dhe vendeve të tjerë. Një vend i respektuar do t'iu rezervohet krijimeve me vlera shkencore, të studenteve.

Do të jetë një revistë me pretendime të mirëfillta shkencore që, duke respektuar standardet më të larta të cilësisë, do të publikojë *peer reviewed* artikuj në shqip ose në anglisht në fushën e shkencave juridike, sociale, politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shkencave të tjera humane.

Publikohet dy herë në vit nga Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë.

Duke pasur privilegjin të shkruaj këto pak rreshta prezantuese, i uroj *Politeia*-s rrugë të mbarë dhe suksese.

Prof. Dr. Ksenofon KRISAFI

Editor in Chief / Redaktor Shkencor

Koncerti europian dhe shqiptarët

Prof. Dr. Ksenofon Krisafi

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

ksenofon.krisafi@umsh.edu.al

Abstract

The European Concert, whose creation was designed and officially inaugurated by the Congress of Vienna, 1814-1815, represented an important event in the history of international relations, which would leave its mark on the political future of the European continent and beyond. By maintaining political balances, he intended to allow the European peoples to move towards the future in relative peace, easing tensions and encouraging institutional transformations, meetings of diplomats, ministers and sovereigns, to avoid general wars. Seeking to establish and relatively guarantee compromise and cooperation between the Great Powers - France, England, Prussia, Russia and Austria, maintaining their balance, avoiding tendencies towards hegemony, suppressing insurrections with joint armies, the Concert sanctioned the practice of diplomatic representation of the states, normalized and legally regulated the system of diplomatic relations between them, which was concretized in the exchange of diplomatic representations between them and the sending of respective ambassadors. In addition to bilateral diplomacy, the Concert gave further impetus to multilateral diplomacy. The representatives of the member states decided to meet from time to time to discuss problems of a political, diplomatic, military, economic, etc. character, which belonged to various aspects not

only diplomatic. Hans Morgenthau states that "the Holy Alliance was an international government in the true sense of the word". It is considered the first version of a "*de facto* government" in international life. The Great Powers appeared as a political union, as a European Directorate, in order to preserve the balance and the *status-quo*.

Albania, which was not yet a state, would encounter the European Concert for the first time institutionally at the time of the Congress of Berlin (June 13-July 13, 1878), which revised the Treaty of Saint Stephen, March 3, 1878. In that time it was part of the Balkan area of the Ottoman Empire, whose status and borders were addressed by the Treaty of Saint Stephen. But unlike what had happened to the other peoples of this space, who had benefited to the maximum from the provisions of the Treaty of Saint Stephen, the opposite had happened to Albania and the Albanians. He, significantly truncating the territorial totality of the Ottoman Empire, had sacrificed important parts of the Albanian territories, which he had passed on to other states, which were created on its ruins.

Albania would again become the object of treatment by the European Concert in one of its closing editions, in the proceedings of the Conference of Ambassadors of London, December 1912-August 1913. This time he recognized it as a subject of international law, accepted it into the community of states, even set the state borders, but broke it up, passing significant Albanian territories to its neighbors, in the south, southeast, north and northeast.

Keywords: European Concert, Great Powers, Berlin Congress, London Conference, Ottoman Empire, Albania,

Abstrakt

Koncerti Europian, krijimi i të cilit u projektua dhe u inagurua zyrtarisht nga Kongresi i Vjenës, 1814-1815, përfaqësonte një ngjarje me rëndësi në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, që do të linte gjurmë në të ardhmen politike të kontinentit europian e më gjerë. Duke ruajtur ekuilibrat politikë ai synonte t'iu lejonte popujve europianë të ecnin drejt të ardhmes në paqe relative, duke fashitur tensionet dhe inkurajuar transformime institucionale, takime të diplomatëve, ministrave dhe sovranëve, për të shmangur luftërat e përgjithshme. Në kërkim të vendosjes dhe garantimit relativ të kompromisit dhe bashkëpunimit midis Fuqive të Mëdha - Francës, Anglisë, Prusisë, Rusisë dhe Austrisë, ruajtjes së ekuilibrit të tyre, shmangies së tendencave për hegjemoni, shtypjes me ushtri të përbashkëta të kryengritjeve, Koncerti sanksionoi praktikën e përfaqësimit diplomatik të shteteve, normalizoi dhe rregulloi juridikisht sistemin e lidhjeve diplomatike midis tyre, që u konkretizua në shkëmbimin e përfaqësive diplomatike ndërmjet tyre dhe dërgimin e ambasadorëve respektivë. Krahas diplomacisë bilaterale, Koncerti i dha hov të mëtejshëm diplomacisë multilaterale. Përfaqësuesit e shteteve pjesëtarë vendosën të takoheshin herë pas here për të diskutuar probleme me karakter politik, diplomatik, ushtarak, ekonomik etj., që iu përkisnin aspekteve të ndryshme jo vetëm diplomatike. Hans Morgentau shprehet se "Aleanca e Shenjtë ishte një qeveri ndërkombëtare në kuptimin e vërtetë të fjalës". Ai konsiderohet si versioni i parë i një "qeverie *de facto*" në jetën ndërkombëtare. Fuqitë e Mëdha u shfaqën si një bashkim politik, si një Direktorat Europian, në ruajtje të ekuilibrit dhe *status-quo*-s.

Shqipëria, e cila nuk ishte ende shtet, do të ndeshej për herë të parë në mënyrë institucionale me Koncertin Europian në kohën e Kongresit të Berlinit (13 qershor-13 korrik 1878), që rishikoi Traktatin e Shën Stefanit, 3 mars 1878. Në atë kohë ajo ishte pjesë e hapësirës ballkanike të Perandorisë

Otomane, statusi dhe kufijtë e të cilave ishin trajtuar nga Traktati i Shën Stefanit. Por ndryshe nga sa kishte ndodhur me popujt e tjerë të kësaj hapësire, të cilët kishin përfituar maksimalisht nga dispozitat e Traktatit të Shën Stefanit, me Shqipërinë dhe shqiptarët kishte ndodhur e kundërta. Ai, duke cunguar ndjeshëm tërësinë territoriale të Perandorisë Osmane, kishte sakrifikuar pjesë të rëndësishme të trevave shqiptare, të cilat ua kishte kaluar shteteve të tjerë, që u krijuan mbi rrënojat e saj.

Shqipëria do të bëhej sërish objekt trajtimi nga Koncerti Europian në një nga edicionet e tij përmbyllëse, në punimet e Konferencës së Ambasadorëve të Londrës, dhjetor 1912-gusht 1913. Kësaj here ai e njohu atë si subjekt të së drejtës ndërkombëtare, e pranoi në bashkësinë e shteteve, i caktoi madje edhe kufijtë shtetërorë, por e copëtoi, duke kaluar territore të konsiderueshme shqiptare te fqinjët e saj, në jug, në juglindje, në veri dhe verilindje.

Fjalët kyçe: Koncerti europian, Fuqitë e Mëdha, Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës, Perandoria Osmane, Shqipëria,

Historiku i krijimit të Koncertit Europian

Nocioni bazë i organizatave ndërkombëtare qeveritare lidhet me anëtarësinë në to, kryesisht të shteteve sovranë, si subjektet kryesorë të së drejtës ndërkombëtare. Parë në këtë optikë thuhet se zanafilla e tyre shkon te strukturat e krijuara nga Traktati i Vastfalisë, i vitit 1648, i cili, siç shprehet Karen Mingst, hodhi bazat e sovranitetit të shteteve, duke shënuar fundin e sundimit të autoritetit fetar në Europë dhe afirmimin e autoriteteve laike. Së këtejmi lindi një ndër parimet bazë të marrëdhënieve ndërkombëtare, ai i integritetit territorial të shtetit sovran dhe të barabartë(Mingst, 2010:38). Shteti Vestfalian, me atributet e veta kryesore - sovranitetin, integritetin territorial dhe parimin e mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjerë do të përhapej gradualisht në hapësirën gjeopolitike të

kontinentit europian dhe më gjerë duke i çelur rrugën përvojës së krijimit të organizatave ndërkombëtare. Pas Vestfalisë, "kontrolli i decentralizuar nëpërmjet shteteve sovrane"(Richard, 1969: 69), hodhi bazat e një rendi ndërkombëtar horizontal për zhvillimin e mëtejshëm të organizatave ndërkombëtare (Thopson and Snidal, 1999: 63). Duke iu referuar kësaj kohe dhe këtij fenomeni, Manlio Graziano shpehet se një nga karakteristikat e periudhës që përfshihet midis shekujve XVII dhe XX është lindja dhe konsolidimi i formës politike të shtetit-komb. Politika i braktisi në mënyrë progresive themelet e saj fetare dhe e gjeti justifikim në vetvete, derisa e shenjtëroi shtetin (Graziano, 2015). Këto shtete sovranë do të bëheshin themeluesit e të parave organizata ndërkombëtare me karakter tekniko-administrativ, ndër të cilat përmenden Administrata e Përgjithshme për lundrimin në lumin e Rhinit, që u themelua në vitin 1804 dhe u ristrukturua në vitin 1815 duke marë emrin Komisioni Ndërkombëtar për Lundrimin në Lumin Rhin dhe Komisioni Europian për Lundrimin në Lumin Danub, në vitin 1856. Përveç ndikimeve të padiskutueshme në zhvillimet politiko-ekonomike të kontinentit ato shërbyen gjithashtu si modele strukturore për krijimin e organizatave me karakter politik. Ishte koha kur Fuqitë e Mëdha ishin angazhuar fuqimisht në marrjen e përgjegjësive për zgjidhjen e çështjeve politike, të cilat hera herës përfundonin në konflikte të armatosura. Për këtë qëllim ato mblidheshin në takime ndërkombëtare për të marrë vendimet përkatëse. Një ndër to ishte Kongresi i Vjenës që themeloi *Koncertin europian të Fuqive të Mëdha* ose *Koncertin e Madh të Fuqive,* i zhvilluar në nëntor 1814 - qershor 1815. Morën pjesë Austria, Franca, Mbretëria e Bashkuar, Portugalia, Prusia, Rusia dhe Suedia.

Organizimi i Kongresit

Në nëntorin e vitit 1814, në kryeqytetin austriak - Vjenë, mbërritën më shumë se 200 të dërguar të shteteve të mësipërme për të zhvilluar konsultime për rendin e ri të kontinentit. Organizatorët e Kongresit kishin marrë të

gjitha masat e duhura protokollare, përfshirë edhe hartimin e një programi te larmishëm e mjaft të pasur argëtues. Pjesëmarrës të Kongresit dhe studiues të shumtë kanë vënë në dukje edhe këtë aspekt spektakolar. Ballot, suaretë dhe darkat e shumta që organizoheshin vazhdimisht bënë që ai të quhej edhe "Kongresi që vallzon", siç do ta quante atë një ndër pjesëmarrësit, diplomati francez Charles Joseph, Kont i Ligne-s (1735 - 1814). Në një letër drejtuar mikut të vet, ministrit të jashtëm francez, Charles Maurice de Talleyrand (1754 – 1838), ai shprehej se "Kongresi vallzon së tepërmi, por nuk përparon. Prej tij nuk del kurgjë përveç djersës së këtyre zotërinjve që vallzojnë."(Dumont-Wilden, 1999) "Është diçka e çuditshme ajo që shihet këtu, për herë të parë, qejfi (kënaqësia) ka pushtuar paqen." Natyrisht, ky ishte hiperbolizimi i njërit prej aspekteve të Kongresit, që, me sa duket, lidhej edhe me karakterin e veçantë të qytetit aristokratik, ku zhvilloheshin punimet. Në fakt ai përfaqësonte një sipërmarrje të rëndësishme, nga më të veçantat e kohës së vet, ku u morrën vendime me rëndësi të madhe për historinë evropiane.

Diskutimet u përqëndruan kryesisht në rikthimin e monarkive të vjetra, të cilat gjatë kohës së pushtimit francez humbën territore dhe një pjesë të influencës. Restaurimi i Evropës së vjetër ishte në të njëjtën kohë refuzim i objektivave të revolucionit francez dhe forcave nacionaliste në shumë vende evropiane, të cilat ishin angazhuar në krijimin e shteteve kombëtare. Në kontinent pas shumë vjet luftrash e ballafaqimesh violente, që shkaktuan turbulenca të fuqishme politike të cilat prishën ekuilibra të rëndësishëm, po tentohej të rivendosej ekuilibri ndërmjet pesë fuqive të mëdha,- Francës, Anglisë, Prusisë, Rusisë dhe Austrisë. Franca, e frymëzuar nga synimet hegjemoniste të Perandorit Napoleon i II, kishte shkaktuar ndryshime rrënjësore politike në Europë. Asaj iu kërkua që të hiqte dorë nga shumë zotërime dhe të rikthente territoret e pushtuara gjatë fushatave aneksioniste të Napoleonit, të cilat iu kaluan fuqive të tjera të mëdha, si dhe disa shteteve më të vegjël si Suedia, Holanda etj. Polonia, nga e cila, pas "ndarjeve

polake" të viteve 1772, 1793 dhe 1795, ekzistonte vetëm dukati i vogël i Varshavës, u rivendos sërish në hartën politike evropiane, duke u mbiquajtur madje "Polonia e kongresit". Po në atë kohë u njoh ndërkombëtarisht statusi i neutralitetit të Zvicrës.

Kongresi i Vjenës projektoi dhe inaguroi krijimin e një organizmi ndërkombëtar, i njohur me emrin Koncerti Europian, i cili përfaqësonte një zhvillim të posaçëm, një ngjarje me rëndësi në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare, që do të linte gjurmë në të ardhmen politike të kontinentit europian e më gjerë. Duke ruajtur ekuilibrat politikë ai do t'iu lejonte popujve europianë që të ecnin drejt të ardhmes së tyre në paqe relative, pa luftra të përgjithshme, nëpërmjet transformimesh të thella institucionale, duke fashitur tensionet dhe duke inkurajuar takimet e diplomatëve, ministrave dhe sovranëve. Në kërkim të vendosjes dhe garantimit relativ të kompromisit dhe bashkëpunimit midis Fuqive të Mëdha, ekuilibrit të tyre, shmangies së tendencave për hegjemoni, shtypjes me ushtri të përbashkëta të kryengritjeve, Koncerti sanksionoi praktikën e përfaqësimit diplomatik të shteteve, normalizoi dhe rregulloi juridikisht sistemin e lidhjeve diplomatike midis tyre, që u konkretizua në shkëmbimin e përfaqësive diplomatike ndërmjet tyre dhe dërgimin e ambasadorëve respektivë. Krahas diplomacisë bilaterale, Koncerti i dha hov të mëtejshëm diplomacisë multilaterale. Përfaqësuesit e shteteve pjesëtarë vendosën të takoheshin herë pas here për të diskutuar probleme me karakter politik, diplomatik, ushtarak, ekonomik etj (Dumont-Wilden, 1999) që iu përkisnin aspekteve të ndryshme jo vetëm diplomatike. Hans Morgentau shprehet se "Aleanca e Shenjtë ishte një qeveri ndërkombëtare në kuptimin e vërtetë të fjalës".[1] Ai konsiderohet si

[1] Në mbështetje të mendimit të vet Morgentau shton se "Një listë jo e plotë në agjendën e Kongresit të Aix–La-Chapelle, do të pasqyrojë hapësirën e veprimtarive të saj qeveritare: pretendimet e princërve vasalë kundër abuzimeve të sovranëve të tyre të rinj, peticioni i Elektorit të Hisit për të ndryshuar titullin e tij me atë të mbretit, kërkesa e nënës së Napoleonit për lirimin e djalit të saj, pakënaqësitë e popullit të Monakos kundër princërve të tyre, pretendimet e Bavarisë dhe Shtëpisë së Hohberg për trashëgiminë në Baden, një mosmarrëveshje ndërmjet Dukës së Oldenburgut dhe Kontit Bentinkt rreth titullit të lordit të Knupenhaussen, gjendja e hebrenjve në Prusi dhe në Austri, rangu i

versioni i parë i një "qeverie *de facto*" në jetën ndërkombëtare. Fuqitë e Mëdha u shfaqën si një bashkim politik, si një Direktorat Europian, në ruajtje të ekuilibrit dhe *status-quo*-s.

Për këtë ngjarje dhe funksionin e vetë Koncertit, Fridrih Gentz, thoshte se:

> "Sistemi që është vendosur në Europë, që nga 1814 dhe 1815, është një fenomen i padëgjuar në historinë e botës. Parimi i ekuilibrit ose për ta thënë më mirë, i kundërpeshave të krijuara nga aleanca të caktuara, një parim që ka qeverisur dhe shpesh gjithashtu ka trazuar dhe ka mbuluar Europën me gjak për tre shekuj, është zëvendësuar nga një parim i bashkimit të përgjithshëm, duke bashkuar tërësinë e shteteve në një federatë nën drejtimin e fuqive kryesore… Europa duket se formon më në fund një familje të madhe politike, e bashkuar nën patronazhin e një gjykate për krijesën e saj."[2]

Më 26 gusht 1815, me marrëveshjen e nënshkruar nga Perandoria Ruse, Perandoria Austriake dhe Prusia u themelua *Aleanca*[3] *e Shenjtë,* e quajtur ngandonjëherë *Neo Aleanca e Shenjtë* (Morgenthau, 2008), në dallim nga ajo që u themelua në Kongresin e Vestfalisë. Këto tri monarki kujdeseshin që rendi i ri i paqes në Evropë, i vendosur në Vjenë të respektohej. Ishte përpjekja e dytë e shteteve evropiane pas Paqes së Vestfalisë të vitit 1648, për t'u marrë me gjithë kontinentin dhe për të vendosur një rend të përbashkët paqeje.

Në një nga nenet e Traktatit të Parisit, të nënshkruar ndërmjet Austrisë, Britanisë së Madhe, Prusisë dhe Rusisë, më 20 nëntor 1815, që pasoi

përfaqësuesve dipliomatikë, eliminimi i tregtisë së skllevërve dhe i piratëve barbarë dhe çështja e kolonive spanjolle." Hans Morgentau, vep.cit.f.338.

[2] Gentz Friedrich von Prokesch von Osten Anton graf,- *Depeches inedites du chevalier de Gentz aux Hospodors de Valachie*, pour servir a l'histoire de la politique europeenne (1813 a 1828), Paris: ed. Plon, 1876, vol.1, p.354. Citohet nga Hans Morgentau, vep.cit. f.333-334.

[3] Në kuptimin politiko-diplomatik, fjala *aleancë* përdoret për të treguar një pakt ndërmjet vendeve të ndryshme, kurse me fjalën *koalicion* kuptohet bashkimi e palëve të ndryshme, lidhja e disa fuqive, tërësia e forcave të bashkuara kundër një armiku të përbashkët. Në formë të përgjithshme me koalicion kuptohet një aleancë e natyrës politike.

Kongresin e Vjenës dhe që iu kushtohej çështjeve që kishin qenë objekt trajtimi i tij, thuhej shprehimisht:

> "Për të lehtësuar zbatimin e këtij traktati dhe për të konsoliduar marrëdhëniet e afërta midis tyre, palët e larta kontraktuese u morën vesh që të ripërtërijnë, për epoka të caktuara, qoftë nën kujdesin e drejtëpërdrejtë të sovranëve, qoftë nën kujdesin e ministrave të tyre përkatës, mbledhje kushtuar interesave të mëdha të përbashkëta dhe shqyrtimit të masave, të cilat në secilën prej këtyre epokave, do të gjykohen si më shpëtimtaret për qetësinë dhe prosperitetin e popujve dhe për ruajtjen e paqes në Europë."[4]

Në këtë mënyrë u hodhën bazat juridike për krijimin e asaj që u quajt *tetarki*, formuar nga Mbretëria e Bashkuar, Austria, Prusia dhe Rusia, e cila u kthye në *pentarki* me pranimin e Francës në Kongresin e Aix la Chapelle, në vitin 1818.

Shekulli i XIX, koha kur veproi efektivisht Koncerti i Fuqive, karakterizohet nga një varg kongresesh e konferencash të rëndësishme, gjatë të cilave dominonte fryma e ruajtjes së hegjemonive përkatëse dhe administrimit të efekteve të lëvizjeve kryengritëse, kontrollit të idesë së shtetit-komb dhe aspiratave për bashkim si në rastin e Italisë dhe Gjermanisë dhe të proceseve për pavarësi si në rastin e Greqisë, Bullgarisë, Serbisë, disiplinimin e etjes për koloni, koordinimin e sjelljes ndaj rrënimit të perandorisë osmane etj. Gjatë kësaj kohe, nëpërmjet vendimeve që u morën në takimet e organizuara në kuadrin e funksionimit të tij juridiko-institucional u zgjidh çështja dhe neutraliteti i Belgjikës (Konferenca e Londrës, 1830, 1839), pranimi i Perandorisë osmane në përbërjen e Koncertit (Konferenca e Parisit, 1856),

[4] G.F.Martens, Frédéric Murhard; Karl von Martens; Friedrich Saalfeld (ed.) – *Nouveau recueil de traités d'alliance, de paix, de trève, de neutralité, de commerce, de limites, d'echange etc. et de plusieurs autres actes servant à la connaissance des relations étrangères des puissances et etats de l'Europe tant dans leur rapport mutuel que dans celui envers les puissances et etas dans d'autres parties du globe depuis 1808 jusqu'à present*. - Gottingue: Dieterich, 1817-1841. D'après *Traité entre la France et les puissances alliées: conclu à Paris, le 20 novembre 1815 (reproduction*), Imprimerie royale, 1815; visionnable sur Gallica.

por me një status specifik, që është përkufizuar si pozita e një anëtari që konsiderohej si i tillë, por që mbahej gjithmonë "jashtë dere", rregullimi i pretenduar i çështjes ballkanike në Kongresin e Berlinit, 1878, trajtimi dhe vendosja e kufijve kolonialë, gjithashtu në Berlin, në Konferencën e vitit 1885 etj.

Anëtarësia

Duke mos qenë organizatë ndërkombëtare në tërë kuptimin e fjalës, nuk mund të flitet për anëtarësi, si e drejtë ose si tërësi procedurash që duheshin ndjekur për t'u bërë anëtar i Koncertit. Por dihet saktë se anëtarët e tij ishin pjesë e drejtëpërdrejtë ose tërthortë e të ashtuquajturës *Aleancë e Shenjtë*[5]. Anëtarë themelues mund të konsiderohen Rusia, Austria dhe Prusia. Pak më vonë rrethi i anëtarëve zgjerohet duke përfshirë Mbretërinë e Bashkuar dhe Francën. Përmenden si pjesë e koncertit Portugalia, Suedia dhe Perandoria Osmane. Roli dhe pjesëmarrja e tyre nuk kanë qënë të njëjta me ato të shteteve që formonin bërthamën dhe strukturën kryesore vendimmarrëse.

[5] Lufta e Tridhjetevjeçare (1618-1648) ishte një konflikt për hegjemoni, për ekuilibrin politik dhe dominimin fetar. Ajo u zhvillua ndërmjet fuqive të mëdha të kontinentit. Teatri kryesor i luftës ishte hapësira e Perandorisë së Shenjtë Romake (Gjermano-Romake). Ajo u zhvillua ndërmjet Lidhjes Katolike dhe Bashkimit Protestant. Në planin e dominimit në kontinent aktorët kryesorë ishin nga njëra anë habsburgët në aleancë me Austrinë, Spanjën dhe nga ana tjetër francezët në aleancë me Holandën, Danimarkën dhe Suedinë. Betejat kryesore u zhvilluan kryesisht në Gjermaninë e sotme, por u shtrinë dhe patën ndikime, viktima dhe shkatërrime të shumta në të gjitha principatat dhe shtetet europiane. Nuk zgjati 30 vjet, siç le të kuptohet emërtimi me të cilin është fiksuar në histori. Periudha prej 24 tetorit të viti 1618 deri në 24 tetor të vitit 1648, përshkohet nga së paku 13 luftëra dhe 10 marrëveshje paqeje. Qëllimet fillestare ishin të karakterit fetar, por ishte e qartë se interesat ekonomike qëndronin në themel. Traktatet e Vestfalisë i dhanë fund Luftës, më 24 tetor 1648. Ato qëndrojnë në bazën e "sistemit vestfalian", të sanksionuar prej tyre. Për shkak se përfaqësuesit e katolikëve dhe protestanëve kishin refuzuar të takoheshin së bashku, u vendos që negociatat për katolikët të zhvilloheshin duke filluar nga dhjetori i vitit 1644 në Münster dhe për protestanët nga 1645 në Osnabrück. Tre traktatet e Vestfalisë janë: Traktati i Paqes së Münster, i 30 janarit 1648, ndërmjet Perandorisë Spanjolle dhe Provincave të Bashkuara si dhe dy traktatet e nënshkruara më 24 tetor 1648, Traktati i Münster (*Instrumentum Pacis Monasteriensis*) ndërmjet Perandorit të Perandorisë së Shenjtë romano-gjermanike dhe Francës (dhe aleatëve të tyre përkatës), Traktati i 'Osnabrück (*Instrumentum Pacis Osnabrugensis*) ndërmjet Perandorit të Perandorisë së Shenjtë romano-gjermanike dhe Perandorit suedez.

Rrethi i shteteve të përfshira në grupin e Fuqive të Mëdha, ose në kuptimin modern të konceptit anëtarësi, gjatë shekullit të XIX, ka ndryshuar. Në fundin e shekullit të XIX ato ishin gjashtë dhe konkretisht Anglia, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria, Rusia, Italia.

Koncerti Europian pati jetë deri ne fillimin e Luftes së Parë Botërore.

Qëllimi dhe veprimtaria

Aleanca e Shenjtë u rikrijua si mburojë e "restaurimit" të legjitimitetit, e rikthimit në pushtet të dinastive të vjetra në disa nga shtetet e Europës, përfshirë edhe vetë Francën. Në këtë kuptim ajo është cilësuar si shprehje e fitores së përkohshme të "Europës konservatore" mbi "Francën revolucionare". Por përpjekjet për rivendosjen e feudalizmit nuk mund të kishin sukses. Duke përfaqësuar tentativa për rikthim në të kaluarën, ato dështuan, sikurse dështoi edhe tentativa për rimëkëmbjen e "Perandorisë së Shenjtë Romake".

Rosemary Beard në studimin e vet *Talleyrand and the Congress of Vienna*, duke iu referuar librit të Harold Nicolsonit *The Congress of Vienna*, (Nicolson, 1961) shkruan se

> "Në qoftë se... minimumi i forcës kundërshtuese...do të ishte i barabartë me maksimumin e forcës agresore... do të kishte një ekuilibër real. Por situata lejon vetëm një ekuilibër, që është artificial dhe i papërcaktuar dhe që mund të zgjatë për aq kohë, sa disa shtete të mëdhenj do të ruajnë frymën e vetëpërmbajtjes dhe drejtësisë."[6]

Edhe pse ky ekulibër ishte deri diku artificial ndihmonte sidoqoftë në ndërtimin e marrëdhënieve midis shteteve pjesëmarrës në këto organizata. "Aleanca e Shenjtë ishte aspekti më origjinal i konfiguracionit të Vjenës. Emri i lartë largonte vëmendjen nga kuptimi i saj veprues, që ishte fuqia e

[6] Tallewyrant, në Harold Nicolson, *The Congress of Vienna*.

një elementi të vetëpërmbajtjes morale në marrëdhëniet midis Fuqive të mëdha."(Kissinger, 1999)

Kongresi i Vjenës dhe Aleanca e Shenjtë e krijuar prej tij arritën të vendosnin paqe dhe siguri relative për një kohë të gjatë. Por legjitimiteti i pretenduar nga ana e Kongresit të Vjenës solli edhe triumfin e konservatorizmit. Henri Kisingeri, (Henry Kissinger) ish sekretar shteti i SHBA dhe studiues i shquar i marrëdhënieve ndërkombëtare, thotë se me Aleancën e Shenjtë palët nënshkruese u angazhuan për të ruajtur *status quo*-në e brendshme në Europë dhe "për herë të parë në historinë moderne, Fuqitë Europiane ndërmorën një mision të përbashkët."(Kissinger, 1999)

Lidhja përfaqësonte aleancën ndërmjet monarkive europiane, të cilat zotoheshin se do t'i përmbaheshin "parimeve kristiane të besimit dhe rregullit për drejtimin e subjekteve brenda vendit në marrëdhënie me njeri tjetrin". Sipas Aleancës, në qoftë se regjimi qeverisës i njërit prej shteteve anëtare të Lidhjes ishte i kërcënuar deri në përmbysje, të tjerët duhet t'i ofronin ndihmë të gjithanshme. "Kursi i adoptuar nga Fuqitë në marrëdhëniet midis tyre, duhet të ndryshonte rrënjësisht dhe ishte urgjente që ai të zëvendësohej me një sistem të gjërave të mbështetura në të vërtetat e frymëzuara nga besimi i përjetshëm te Shpëtimtari ynë." (Schwarz, 1935)

Idea fillestare bazë ishte që Koncerti të përbënte një organizëm joformal, ku fuqitë Europiane të kishin rast për t'u konsultuar së bashku në momente krizash dhe të shërbente si një instancë supreme, si një qeveri ndërkombëtare, e pajisur me kompetenca të gjera, e autorizuar zyrtarisht për të ndërhyrë në punët e brendshme të shteteve të tjerë. Por ajo, u kundërshtua nga britanikët, të cilët insistonin që ky organizëm ndërkombëtar të ngrihej dhe të vepronte mbi bazën e parimit të mosndërhyrjes, i cili duhet të afirmohej si thelbi i sistemit ndërkombëtar të asaj kohe, që mbështeteshin edhe mbi parimet e vetevendosjes kombëtare dhe të liberalizmit, të propaganduara nga Revolucioni Francez i 1789. Ishte shprehje e një realiteti të caktuar historik, që u shfaq në faktin se në projektet për krijimin e

Koncertit u ballafaquan interesa të ndryshme kombëtare nga palët pjesëmarrëse.

Henri Kisinger, vlerëson se sistemi i Kongresit të Vjenës, i lidhur me emrin e Von Meternich-t, princit të Austrisë, që adoptoi për herë të parë në histori në rrugë institucionale konceptin e përbashkët të drejtësisë në sistemin ndërkombëtar, do t'i paraprinte dhe do t'i shërbente si model Uillsonit. Nëpërmjet skemave që ndërtoi pas Luftës së Parë Botërore me themelimin e Lidhjes së Kombeve, Uillsoni krijoi një sistem ndërkombëtar në emër të ekuilibrit të forces, të mbështetur pikërisht në përdorimin e dhunës, ku forca dhe e drejta ishin në harmoni të plotë. (Kissinger, 1999, 79) Ekuilibri i forcës, përdorimi i të cilit shpresohej se do të shërbente për të siguruar paqen, do të pushonte së ekzistuari pas Luftës së Dytë Botërore. Siç deklaroi në prill 1949, Uorin Ostin (Warren Austin), ish ambasadori i SHBA në OKB, "Popujt e Kombeve të Bashkuara, të cilët morën përsipër të bashkonin përpjekjet e tyre në organizatën ndërkombëtare për të ruajtur paqen ndërkombëtare dhe sigurinë dhe, me këtë qëllim, për të marrë masa kolektive të efektshme, paraqitën zyrtarisht elementin e epërsisë së forcës për paqen. E kështu u shua ekuilibri i plakur i forcës". (Kissinger, 1999, 458)

Sistemi i Koncertit me strukturat dhe vendimet që merrte herë pas here kontribuoi në krijimin e një atmosfere përgjithësisht paqësore. Periudha e tij u karakterizua nga mungesa relative e konflikteve ndërmjet fuqive Europiane. Ai i siguroi Europës një jetë gati njëshekullore pa luftëra midis Fuqive të Mëdha. Për rreth 40 vjet, deri në Luftën e Krimesë, 1854 dhe pastaj për rreth 60 vjet të tjera nuk pati konflikte midis Fuqive të Mëdha ose luftë të përgjithshme. Vlerësohet orientimi i tij që, në raste mosmarrëveshjesh midis shteteve, palët t'iu drejtoheshin fillimisht konsultimeve dhe negociatave diplomatike përpara se të rrëmbenin armët dhe të nisnin luftën. Kjo filozofi e përgjithshme, kjo vijë sjelljeje ndihmoi në

parandalimin e një vargu konfliktesh lokale dhe të luftës botërore, së paku deri në vitin 1914, vit që vulosi shkatërrimin spektakolar të këtij sistemi.

Roli i Koncertit nuk duhet të mbivlerësohet, sepse sërish luftërat dhe vuajtjet, mundimet dhe kostot e mëdha njerëzore që ato shkaktonin edhe pse nuk ishin të pranishme në kontinent, zhvilloheshin në kolonitë e shteteve europiane.

Koncerti Europian - pararendës i të parës organizatë ndërkombëtare politike

Koncerti Europian i Fuqive të Mëdha ishte një aleancë e organizuar shtetesh dhe mund të cilësohet si pararendësja e të parës organizatë ndërkombëtare politike. Ai veproi jo si organizatë ndërkombëtare në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, por si aleancë e Fuqive të Mëdha për dominimin dhe disiplinimin e jetës politike dhe ekonomike në kontinentin Europian, madje edhe jashtë tij. Në një varg konferencash të zhvilluara gjatë jetës së vet njëshekullore ai kultivoi frymën e bashkëpunimit të vazhdueshëm në shërbim të garantimit të paqes nëpërmjet rregullimit paqësor të mosmarrëveshjeve ndërkombëtare.

Ai nuk kishte tiparet e plota formalo-juridike të një organizate të mirëfilltë ndërkombëtare, për shkak se nuk ekzistonte një marrëveshje midis shteteve, që të fiksonte angazhimin për takime periodike ose për krijimin dhe funksionimin e organeve institucionale. Rregullat mbi të cilat vepronte nuk ishin të formalizuara në një akt themeltar apo në një dokument kushtetues, sikurse do të ndodhte një shekull më vonë me Lidhjen e Kombeve dhe me OKB-në, të cilat u krijuan mbi bazën e Statutit apo të Kartës themeluese. I mungonte permanenca, nuk kishte organe të përhershme legjislative, administrative apo ekzekutive. Baza juridike e tij ishte thjesht një marrëveshje për t'u bashkuar dhe organizuar në rast kërcënimi të paqes dhe qetësisë së Europës. Por, ishte i pari forum shumëpalësh joformal, ku fuqitë evropiane konsultoheshin në raste krizash për administrimin e tyre. (Lindley,

2006: 83) Udhëhiqej nga parimi i domosdoshmërisë së zhvillimit të konsultimeve dhe demarsheve diplomatike përpara se palët në konflikt t'iu drejtoheshin armëve, çka ndihmoi në parandalimin relativ të konflikteve të armatosura.

Në këndvështrimin e konceptit të organizatës ndërkombëtare të mirëfilltë do të ishte e vështirë që Koncerti Europian të cilësohej si e tillë. Megjithatë, konsiderohet si një nga organizmat ndërkombëtare më të spikatura dhe më jetëgjata të kohës që, me sanksionimin e disa të drejtave dhe privilegjeve për Fuqitë e Mëdha, krijoi një numër precedentësh si për Lidhjen e Kombeve ashtu edhe për OKB-në, të cilat iu dhanë disa prej Fuqive të Mëdha anëtarësim të përhershëm dhe të drejtën e vetos.

Nga pikëpamja formale, Koncerti Europian, kapërceu dukshëm kufijtë normalë të një organizate ndërkombëtare dhe mori përsipër të drejtën e një organi gjyqësor. Ai i njohu vetes atributin për të diskutuar mbi fatin e shteteve që ekzistonin apo që mund të krijoheshin. Koncerti jepte verdiktin përfundimtar rreth "legjitimitetit ndërkombëtar" dhe statusit të tyre. Ai vendosi edhe një numër normash të përgjithshme, një pjesë e të cilave lidheshin me politikën e brendshme dhe të jashtme të shteteve. Të tilla ishin ato që kishin të bënin me lundrimin në lumenjtë ndërkombëtarë, me gjykimin e rasteve të tregtisë së skllevërve, me mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve etj. Marrja përsipër e kësaj kompetence përligjej në emër të interesave të komunitetit ndërkombëtar.

Ai u ideua, u strukturua dhe u konsolidua nëpërmjet një sistemi traktatesh, siç ishin ai i Shomonit (Chaumont), i Parisit dhe akti i Vienës. Në vend të një ekuilibri gati mekanik që ekzistonte në shekullin e XVIII, vendosi dhe ruajti një sistem më të strukturuar marrëdhëniesh ndërmjet shteteve, një farë Bashkimi europian, të krijuar pikërisht në djepin e kombeve, të cilët në atë kohë ishin thjesht instrument, që, siç thoshte Jacques-Alain Sédouy, aspironin të bëheshin objekt i këtij "Koncerti brilant". (de Sedouy, 2009)

Koncerti i kishte atribuar vetes pushtete të veçanta që iu përngjasonin funksioneve qeveritare, të cilat duheshin zbatuar për të siguruar rendin monarkik, (Rich, 2006: 24-27)për të vendosur rregull edhe në ndarjen e kolonive. Gjatë çerekut të fundit të shekullit XIX përfundoi ndarja e botës midis Fuqive të Mëdha. Prej vitit 1876 dhe deri në vitin 1900 zotërimet koloniale në hapësirat e gjashtë Fuqive më të mëdha të Europës u shtuan nga 40 milionë km² deri në 65 milionë km². Por jo gjithëçka shkonte sipas vullnetit dhe dëshirës së të gjitha Fuqive. Nga njëra anë ishte fryma e zgjimit kombëtar dhe e lëvizjes për çlirim e dekolonizim, nga ana tjetër ishin kontradiktat midis vetë Fuqive.

Pas luftës franko-prusiane (1870-1871), në Europë, rifilluan konfliktet diplomatike midis fuqive kryesore, që u pasuan nga gara e shfrenuar e armatimeve dhe nga formimi i blloqeve ushtarake të kundërta. "Koncerti Europian", i cili pati një qëndrueshmëri normale deri në Kongresin e Berlinit (qershor-korrik 1878), pas përfundimit të tij mori plasaritjet e para dhe nisi rrugën e shthurjes. Pas Kongresit të Berlinit, Koncerti, i gërryer nga përplasje interesash midis fuqive, filloi të shthuret. Jeta ndërkombëtare do të karakterizohej tashmë nga acarime të hapta midis dy grupimeve të fuqishme, *Aleancës Tripalëshe,* të përbërë nga Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia, të themeluar në vitin 1882 dhe *Aleancës*, në fillim dypalëshe, Francë-Rusi, të themeluar në vitin 1891, që u shndërrua më pas në *Aleancën Tripalëshe* ose *Antanta Kordiale,* e përbërë nga Anglia, Franca dhe Rusia, 1904-1907. Ndërkohë po dilnin në skenë shtete të reja të fuqishme, si Gjermania dhe Japonia, të cilat u shfaqën në arenën e politikës koloniale kur pjesa më e madhe e kolonive ishte e ndarë midis Anglisë dhe Francës. Eshtë kjo arsyeja që në pragun e shekullit XX midis tyre fillojnë ballafaqimet e hapura në periferitë e globit për rindarjen e botës, rezultat i të cilave ishin luftrat amerikano-spanjolle (1898), anglo-boere (1899-1902), ruso-japoneze (1904-1905) dhe italo-turke (1911-1912).

Koncerti Europian dhe Shqiptarët

Shqipëria, e cila nuk ishte ende shtet, do të ndeshej për herë të parë në mënyrë institucionale me Koncertin Europian në kohën e Kongresit të Berlinit (13 qershor-13 korrik 1878), që rishikoi Traktatin e Shën Stefanit, 3 mars 1878. Në atë kohë ajo ishte pjesë e hapësirave ballkanike të Perandorisë Otomane, statusi dhe kufijtë e të cilave ishin trajtuar nga Traktati i Shën Stefanit. Por ndryshe nga sa kishte ndodhur me popujt e tjerë, të cilët kishin përfituar maksimalisht nga dispozitat e tij, me Shqipërinë dhe shqiptarët kishte ndodhur e kundërta. Ai, duke cunguar ndjeshëm tërësinë territoriale të Perandorisë Osmane, kishte sakrifikuar edhe pjesë të rëndësishme të trevave shqiptare, të cilat ua kishte kaluar shteteve të tjerë[7], që u krijuan mbi rrënojat e saj. Shqiptarët shpresonin se nga rishikimi i tij do të korigjoheshin padrejtësitë dhe në përfundim do të ndryshonin për mirë pozita dhe kufijtë e tyre. Ishte kjo arsyeja pse në Byronë e Kongresit u depozituan ato ditë një varg kërkesash, peticionesh, letrash, ankesash, thirrjesh etj, që vinin nga përfaqësues të krahinave të ndryshme shqiptare,[8] të cilat, siç rezulton, nuk u përfillën. Shqiptarët nuk u ftuan dhe nuk u dëgjuan në Kongres. Çështja e të ardhmes së tyre, si e tillë, nuk gjeti vend as tërthorazi në ndonjë nga pikat e rendit të ditës dhe as nuk u përmend në diskutimet e zhvilluara. Kryetari i Kongresit, Bismarku, refuzoi të pranonte të flitej për ta, duke i cilësuar thjesht si "turq malësorë". Madje dhe nuk nguroi të shprehej se nuk dinte të kishte ndonjë komb shqiptar. (Taylor, 1954:253)

[7] E drejta ndërkombëtare e asaj kohe e konsideronte të ligjshme dhe krejt normale nga çdo pikëpamje pushtimin dhe aneksimin e territorit të shtetit të mundur nga ana e shtetit fitues. Sër Gerald Fitzmaurice tregon normën që zbatohet në këto raste: "Tani mund të shihet si një parim i rrënjosur i të drejtës ndërkombëtare që, në raste të tilla, situata në fjalë duhet të vlerësohet dhe traktati duhet të interpretohet në dritën e normave të të drejtës ndërkombëtare, që ekzistonin në atë kohë e jo ashtu siç janë sot". Ian Browlie, *Principles of Public International Law*, Sixth edition, Oxford University Press, Inc New York, 2003, f. Brownlie, f. 203 (Doktrina e të drejtës ndërkombëtare). Por Fuqitë e Mëdha të asaj kohe gjykuan se pretendimet e Rusisë kishin qënë tepër ekcesive dhe kishin prishur ekuilibra të rëndësishme në rajon. Prandaj, për rishikimin dhe korigjimin e tyre organizuan Kongresin e Berlinit.

[8] Shih shënimin 33 më sipër.

Edhe pse zëri i Shqipërisë mbeti pa jehonë në këtë "forum të lartë" të diplomacisë evropiane, aspekte të veçanta të saj u bënë, dashur pa dashur, objekt diskutimi, për shkak se me to implikoheshin interesa të Fuqive të Mëdha ose të klientëve të tyre, fqinjë të Shqipërisë.

Në Traktatin e Berlinit dhe në 20 protokollet e tij, përmenden me dhjetra e ndoshta me qindra herë emrat e gjithë popujve të tjerë të rajonit, të cilët ishin pjesë e Perandorisë Otomane. Shqipëria dhe shqiptarët u shpërfillën prej Fuqive të Mëdha në Kongres. Emri i saj, i një rajoni që ndodhej në Ballkan, "te pragu i derës" i Fuqive të Mëdha dhe emri i banorëve të saj, shqiptarëve, përmenden gjithashtu, por kryesisht vetëm nga përfaqësuesit e Turqisë, në mënyrë rastësore dhe pa ndonjë kontekst të rëndësishëm. Përfaqësuesit e Fuqive heshtën krejtësisht për ekzistencën dhe domosdoshmërinë e trajtimit dhe përcaktimit të statusit të tyre. Heshtja, kjo mënyrë diplomatike për të mos thënë as po dhe as jo, pasoi edhe reagimin ndaj dhjetëra e dhjetëra kërkesave me shkrim që iu drejtuan atyre nga organet e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, të personifikuara nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, themeluar tre ditë përpara çeljes së punimeve të Kongresit. Nuk pati ndonjë veprim apo vendim që të merrte në konsideratë aspiratën e shqiptarëve për t'u shkëputur nga Perandoria Osmane dhe për të krijuar shtetin e tyre. E vetmja gjë që, me sa duket, i interesonte diplomacisë së Fuqive të Mëdha në ato kohë, ishte përdorimi i territoreve të tyre si monedhë shkëmbimi, si hapësira për zmadhimin e shteteve të tjerë të Ballkanit. Lirinë dhe pavarësinë e shqiptarëve nuk e trajtoi si domosdoshmëri, si një të drejtë natyrore, por si një prerogativë ekskluzive të vetën, për të vendosur një paqe për të tjerët në kurriz të shqiptarëve, që, siç pritej, rezultoi e brishtë dhe e paqëndrueshme.

Rezultuan iluzive shpresat për një mbështetje apo përkrahje nga ana e diplomacisë së Fuqive të Mëdha apo për zgjidhje të bazuara te principialiteti i normave të së drejtës ndërkombëtare, të reklamuara si neutrale dhe në dobi të triumfit të së drejtës. Atëherë e drejta ndërkombëtare ishte produkt, për

The year 1975 was the year that witnessed the first embryo transfer, utilizing in vitro fertilization that was completed while adhering to ethical standards. In the chronicles of surrogacy, the first official surrogacy contract was negotiated in 1976 by Attorney Noel Keane. Keane was responsible for sealing the agreement. In total, there were around 600 babies brought to life between the year in question and 1988. When one considers the historical period and year in which the first legal contracts were written, it is especially astonishing to see that legal guardianship is still generally neglected. Because there is a lack of information, even the attention of the fourth power, which is made of the media, is low for these institutes.

One form of surrogacy that is considered to be more conventional is one where the surrogate mother does not receive any form of monetary remuneration for bearing the child. The Center for Infertility, which was established by Keane and backed by his experience, will be responsible for placing hundreds of surrogates each year and will play an important part in the history of surrogacy in the United States (Webster, 2022). The birth of a child using assisted reproductive technology has been heralded as a watershed moment in the area of assisted reproductive technology. This has paved the way for a greater knowledge of molecular mechanisms such as conception and the maturation of oocytes. There have been several innovative approaches to the preservation of gametes found. In the not-too-distant future, we will also be able to "alter" genes extracted from gametes and embryos, as well as choose embryos to have particular characteristics. There was a huge effect on the ground (Sayani Mitra, 2018). In most of the literature on artificial insemination, for surrogacy, everywhere you will find the reference to the first famous case of "Baby M", which featured a traditional kind of surrogacy, which is often regarded as the most notable

incident in the annals of surrogacy. In 1984, Bill and Betsy Stern agreed that if they used Mary Beth Whitehead as their surrogate, they would pay her $10,000. Because Whitehead's eggs were used in the artificial insemination process, she is considered the child's biological mother. On March 27, 1986, Baby M came into the world. Whitehead did not want to give up her parental rights after the baby was born, so she immediately took custody of Melissa Stern (also known as "Baby M"), which kicked off a protracted custody battle in the year 1986. The decision reached in the custody battle had an impact on the formulation of some of the more restrictive surrogacy legislation in the United States.

Following a decision by the New Jersey Supreme Court that the surrogacy agreement between Whitehead and the Sterns violated the constitutional rights of Whitehead, the court reinstated Whitehead's parental rights. Whitehead was allowed to have visitation rights while Bill Stern was awarded custody of the child in 1985. Melissa Stern (Baby M) established her parental relationship with Elizabeth Stern, the commissioning mother, through adoption in 2004, when she was 18 years old, and legally terminated Mary Beth Whitehead's parental rights and any further contact with Whitehead (Karen Smith Rotabi, 2017). Another case, having linkages to Sweden and the US occurred in the UK at the same time in 1985, and at first instance, it features a normal surrogacy arrangement. It is the case of Baby Cotton, where a British surrogate, had a baby for a Swedish couple in the U.S. At the time, British law didn't ban commercial surrogacy. After the British officials learned of the financial transaction, the youngster became a court ward.

The surrogate and the commissioning couple were criticized for "baby peddling". The UK banned commercial surrogacy in 1985 with the Surrogacy Arrangements Act. The Swedish couple was allowed by UK courts to repatriate the child to their home in the US (Kim Cotton, 1985), on the condition that the child does not have contact with the surrogate mother

(Karen Smith Rotabi, 2017). During the next thirty years, states are expected to maintain their bans on traditional surrogacy as well as surrogacy in general. As a direct consequence of this, lawyers and politicians have begun to devise strategies that allow intended parents to acquire their parental rights through the use of surrogacy. These strategies often include the use of a pre-birth or post-birth paternity order. It is now much simpler for intended parents as well as possible surrogates to learn more about the process and engage in it as a result of the rise in prominence and level of experience of surrogacy firms and professionals.

When it comes to various reproductive difficulties, the United States has become “a Wild West of procreative possibilities," according to Barnard College president and writer Debora L. Spar, the author of “The Baby Business: How Money, Science, and Politics Drive the Commerce of Conception” (Times, 2014)[48]. The development of surrogacy practice includes the influence of different elements such as social, demographic, and/or economic ones.

The freedom to reproduce and the welfare of the child should be weighed against one another when considering the first problem in the legal ethics canon. In the context of contract law, the term "surrogate" is derived from civil law and the principles of the latter. It refers to the substitution of a creditor or debtor with a third person who, by agreement, adopts the same procedural position as the creditor or debtor. Surrogacy is opposed on moral, ethical, and theological grounds since life is a creation of God, and humans should not try to play His “role” by tampering with natural processes. The debate about the end of life is historically expected to determine the beginning of life. Clarification of the time of death has always

[48] Note: See the link where it is published an article of The New York Times https://www.nytimes.com/2014/03/24/us/baby-m-and-the-question-of-surrogate-motherhood.html

had a strong impact on pre-organ donation practice, criminal law, and private law (think murder or private law), but the beginning of life began in the early 1970s with abortion. American judicial cases related to rights (case Roe v. Wade) (Cassonato, Indtroduzione al biodiritto, 2012).

In the event of adoption, the fundamental right to be protected and guaranteed serves the child's best interests. This is because the child who is the subject of the law in this instance has been denied basic rights including the right to have a family. Meanwhile, in ethical arguments on surrogacy, it appears that the rights of the child take a back seat, with the primary goal being satisfying the right to procreate (Benedetto, 2019). However, in general, authoritative doctrine argues that fetal life is at the same time essential (abortion) in some situations and not unnecessary in other situations. A set of rules (Cassonato, Indtroduzione al biodiritto, 2012) are applied to all possible contexts (Zatti, 1995). Finally, many religious groups, most notably Roman Catholics, oppose surrogacy because it involves the death of human embryos during IVF rounds, which contradicts their theological belief that life begins at conception and with God’s will. If individuals' right to procreate naturally through sexual intercourse is protected, then begetting a child with the use of assisted human reproductive technology, including surrogacy, should be protected as well (Gordon, 1993). In the historical account of the development of surrogacy that was presented before, the first documented data had allusions to the Bible. Because the "justification tool" in Christian nations is typically based on religious or ethical considerations, a more in-depth investigation into whether this justification is valid or not is required. At a congress on ethics and bioethics, Giampaolo Pancetti, a professor at the Protestant Theological Institute Martin Luther, who teaches deaconry, ethics, spirituality, and Anglicanism, presented an analysis that not only does not see the need to use these justifying tools as barriers to acceptance by universal, national, or personal surrogacy cultures, but also gives another dimension to the issue.

The alteration of the reproductive experience from an uncontrollable "event" inserted, socially and legally, primarily in the marriage experience, to a deliberate and programmable "option" within a vast mutation of social and legal reality, has nourished many people's idea that the quest for parenting by choice, was a right whose boundaries aligned with those of medical technology (Angelini, Profili Costituzionali Della Procreazione Medicalmente Assistita E Della Surrogazione Di Maternità La legge n. 40 del 2004 e la sua applicazione fra volontà ed esigenze di giustizia, 2020).

Throughout the course of history, many dimensions and pillars have been used to support a variety of hypotheses and explanations for various occurrences, facts, and phenomena. During the Middle Ages, people looked to religion and belief as the primary sources of knowledge that extended beyond man and nature to explain everything. During the Modern period, which coincided with the beginning of the Enlightenment, there were notable departures from religion as a result of the advancement of mankind, which turned reason into the primary pillar.

This was because the faith was based on the absence of progress in humanity. In the meanwhile, postmodernism introduced the discussion, combined faith, and reason, and initiated an ethical transformation of all issues due to the realization that reason alone was no longer adequate. It was growing increasingly difficult to persuade only via the use of argument. It is well known that traditional religions, most notably Christianity, take a negative stance toward new reproduction processes.

However, the point at which I intended to focus my attention, was on locating constructive techniques and environments for alternative types of procreation. The fundamental premise of Christian theological perspectives is that the biological family link, which is regarded sacrosanct, is lost when a child is born via the practice of surrogacy. But does that hold, or is there some other line of reasoning that we may use as an alternative to what is written in the holy books? In the holy texts, it is said that "God sees the

heart" or "A child has the right to be welcomed and wanted" or "Parents are" those who love you and nurture you ". This question may be answered using a variety of relativistic processes of biological or "blood" ties. All these things are utterly severe biological links, as they do not believe them to be the sole connecting node of family relationships, which transcend the body and reflect real relationships based on the principles of responsibility and love. When viewed through this lens, pregnancy may be understood as a way to serve love, the autonomy of choice, and freedom on both an individual and societal level.

What is more sacred than life itself and the moment of birth?

If the goal is to accomplish a mission, then it will earn God's approval. The aspect of self-sacrifice in all beings involved and the body, in this perspective surrogacy, may be considered a holy means to introduce a new type of sacrifice to bring life into the world[49].

[49] Note: Gianmpaolo Pancetti conference Etica e Bioetica WS 12 “tra etica laica e cristiana” 24.05.2021

Bibliography

- Alia, L. (2016). Il Codice Consuetudinario Albanese; Le categorie etico-morali, 2016, pag.22. . Siena: Siena.
- Angelini, F. (2020). Profili Costituzionali Della Procreazione Medicalmente Assistita E Della Surrogazione Di Maternità La legge n. 40 del 2004 e la sua applicazione fra volontà ed esigenze di giustizia. Napoli: Editoriale Scietifica.
- AT Gjeçovi, S. K. (1933). Kanuni i Lekë Dukagjinit. Shkodër: Shtypshkronja Françeskane.
- Beeson, D., Darnovsky, M., & Lippman, A. (2015). What's in a name? Variations in the terminology of third-party reproduction. Reproductive BioMedicine Online, 805-814.
- Benedetto, M. D. (2019). La maternità surrogata: le principali questioni bioetiche. Biodiritto, 25-55.
- Cassonato, C. (2012). Indtroduzione al biodiritto. Torino: Giappichelli.
- Castelleti, G. (2012). Normat zakonore dhe jeta shoqërore në malësitë shqiptare sipas Kanunit te Lekë Dukagjinit. Tirana: Ombra GVG.
- Ferber, S., Marks, N., & Mackie, V. (2020). IVF and Assisted Reproduction; A global history. London: Springer Nature.
- Gordon, E. A. (1993). The Aftermath of Johnson v. Calvert: Surrogacy Law Reflects a More Liberal View of Reproductive Technology. In E. A. Gordon, The Aftermath of Johnson v. Calvert: Surrogacy Law Reflects a More Liberal View of Reproductive Technology (pp. 191-200). london: Thomas Law Review.

- Inhorn, M., & Patrizio, P. (2014). Procreative tourism: debating the meaning of cross-border reproductive care in the 21st century. Expert Review of Obstetrics & Gynecology , 509-511.
- Karen Smith Rotabi, N. F. (2017). From Intercountry Adoption to Global Surrogacy; A Human Rights History and New Fertility Frontiers. In N. F. Karen Smith Rotabi, From Intercountry Adoption to Global Surrogacy; A Human Rights History and New Fertility Frontiers (pp. 120-130). Oxfordshire: Routledge Taylor and Francis Group.
- Kim Cotton, D. W. (1985). Baby Cotton for love and money. In D. W. Kim Cotton, Baby Cotton for love and money (pp. 122-132). London: Dorling Kindersley.
- Malcolm, N. (1999). Storia del Kosovo. Dalle origini ai giorni nostri. Milano: Bompiani.
- Margaret Masluck Masson Hardie. (1954). HKanuni: Ligji i pashkruar Shqiptar (The unwritten law in Albania). Cambrige: Cambrige University Press.
- Points, K. (2009). Commercial Surrogacy and fertlity tourism in India; The Case of Baby Manji . The Kenan Institute for ethics; Duke University, 1-11.
- Salvatore Vilari OMBRA GVG, T. 2. (2012). Normat zakonore juridike të Shqipërisë. Kanuni i Lekë Dukagjinit. Tirana: Ombra GVG.
- Sayani Mitra, S. S. (2018). Cross-Cultural Comparisons on Surrogacy and egg donation; Interdisciplinary perspectives from. Switzerland: Palgrave Macmillan.
- Skinner, M. K. (2018). Encyclopedia of Reproduction. Amsterdam: Elsevier Inc.

- Times, T. N. (2014, 03 24). Baby M and the question of surrogate motherhoodv. Retrieved from The New York Times: https://www.nytimes.com/2014/03/24/us/baby-m-and-the-question-of-surrogate-motherhood.html
- Valentini, A. G. (2009). Studime dhe tekste juridike. Tirana: Plejad.
- Webster, M. (2022, August 25). Merriam Webster Dictionary. Retrieved from https://www.merriam-webster.com: https://www.merriam-webster.com/dictionary/state
- Yuko, E. (2016, January 8). The First Artificial Insemination Was an Ethical Nightmare; The 19th-century procedure involved lies, a secrecy pledge, and sperm from a surprise donor" . The atlantic, pp. 22-30.
- Zatti, P. (1995). Verso un diritto per la bioetica: risorse e limiti del discorso giuridico, cit., 56. Approfondiremo nella parte dedicata al Metodo del biodiritto . Medicina legal, 26-45.

Analiza ekonomike e së drejtës

Shpjegimi i fenomeneve juridike me konceptet ekonomike

Prof. Dr. Adrian Civici

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

adrian.civici@umsh.edu.al

Abstract

Economic analysis of law, or "law under economic optics" is a relatively new discipline that seeks to explain legal phenomena thanks to the methods and concepts of economic science. Combining legal theory with economic theory, "Law and Economy" tries to explain classical legal phenomena "differently".

Currently, the concept of "economic analysis of law" or "Economics of law" represents a new profile of studies in the field of law and economics, in which "the instruments of economic science are used to analyze legal phenomena. Cost-benefit analysis, average and marginal cost, income and profit, the polluter-pays principle, collateral effects, econometric tests, etc., are some of the economic concepts that are used more often in the analysis of legal phenomena as a whole.

Keywords: economy of law, law, economy

Abstrakt

Analiza ekonomike e së drejtës, apo "ligji nën optikën ekonomike" është një disiplinë relativisht e re që kërkon të shpjegojë fenomenet juridike falë metodave dhe koncepteve të shkencës ekonomike. Duke ndërthurur teorinë juridike me teorinë ekonomike, "Ligji dhe ekonomia" tenton ti shpjegojë "ndryshe" fenomenet klasike juridike.

Aktualisht, koncepti "analizë ekonomike e së drejtës" apo "Ekonomia e së drejtës" përfaqëson një profil të ri studimesh në fushën e së drejtës dhe ekonomisë, në të cilën "instrumentet e shkencës ekonomike përdoren për të analizuar fenomenet me natyrë juridike. Analiza kosto-përfitim, kosto mesatare dhe marxhinale, të ardhurat dhe fitimi, parimi ndotës-pagues,efektet kolaterale, testet ekonometrike, etj., janë disa nga konceptet ekonomike që përdoren më shpesh në analizën e fenomeneve juridike në tërësi.

Fjalë kyçe: ekonomia e së drejtës, ligj, ekonomi

Shpesh, lidhja ndërmjet shkencës ekonomike dhe të drejtës, të con automatikisht drejt konceptit të së "drejtës ekonomike apo financiare", e cila përmbledh disa degë të së drejtës që kanë të bëjnë me rregullimin e aktiviteteve ekonomike apo financiare të tilla si e drejta bankare, e drejta e konkurrencës, e drejta tregtare, etj., Por, analiza ekonomike e së drejtës është krejt ndryshe nga një konceptim i tillë. Ajo është një metodë që propozon "leximin e së drejtës me ndihmën e koncepteve të huazuara nga shkencat ekonomike".

Të dy disiplinat, juridike dhe ekonomike, që prej një kohe të gjatë kanë qënë në "lidhje"me njëra-tjetrën. Përsa i përket sistemit juridik dhe atij politik, mjaft elemente të analizës ekonomike janë trajtuar nga ekonomia politike në një optikë specifike. Tematika e ndërlidhjes midis aspekteve juridike dhe atyre ekonomike gjendet në një numër të madh teorish e shkollash të mendimit ekonomik: marksizmi, shkolla historike gjermane, shkolla e Frankfurtit, analiza klasike dhe neoklasike, shkolla institucionaliste dhe neo-institucionaliste, neokeynesianiste, etj.

Në një optikë më juridike, ekzistojnë dhe një sërë lëvizjesh apo përpjekjesh që kërkojnë "një kuptim e përfshirje më të madhe të ekonomisë në sferën e së drejtës". "Realizmi juridik" apo "Studime kritike juridike", në fillimet e shek. XX-të, këmbëngulte në "nevojën e juristëve për të njohur më mirë funksionimin e tregjeve, mekanizmat e vlerës dhe fitimit, të ardhurave dhe iniciativës së lirë, konflikteve dhe hierarkinë ekonomike, raportet e forcave ekonomike, etj."

Qysh në shekullin e 18-të, filluan diskutimet e reflektimet për efektet ekonomike të teksteve legjislative, të cilat u pasqyruan veçanërisht në punimet e Adam Smith dhe David Hume. Edhe Karl Marksi trajtoi gjerësisht nevojën për të marrë në konsideratë marrëdhëniet midis infrastrukturës, vendit të marrëdhënieve ekonomike të shfrytëzimit në kuadrin e sistemit kapitalist dhe superstrukturës, procesit të krijimit të marrëdhënieve juridike dhe politike duke reflektuar në ndikimin direkt dhe indirekt të tyre në infrastrukturën ekonomike.

Ajo që tani quhet "analiza ekonomike e ligjit" buron kryesisht nga dy artikuj të botuar në vitet 1960 dhe 1961, përkatësisht nga Ronald Coase dhe Guido Calabresi. Artikulli i të parit, "Problemi i kostos sociale", që është baza e "teoremës së Coase", dhe i të dytit, "Disa mendime mbi shpërndarjen e rrezikut dhe Ligji i dëmeve". Duke u marrë me zgjidhjen e problemeve të eksternaliteteve, ato ofruan një këndvështrim të ri për juristët dhe

ekonomistët e kohës së tyre, duke u konsideruar si pikënisja e analizës së re ekonomike të ligjit.

Nga vitet 1960, ekonomia e së drejtës u transformua për t'u bërë analiza ekonomike e ligjit. Ky zhvillim e ka origjinën në kërkimet dhe punimet e Shkollës së Çikagos dhe kontributet e disa autorëve, të tillë si fituesi i çmimit Nobel Gary Becker, teoricieni i së drejtës Richard Posner dhe ekonomisti George Stigler. Për rrjedhojë, objekti i studimit të ekonomisë së të drejtës ndryshoi: tashmë, duke përdorur mjetet e mikroekonomisë tradicionale, bëhet fjalë për të analizuar prodhimin dhe kushtet e efektivitetit të rregullave të së drejtës.

Ky zhvillim është pjesë e lëvizjes më të gjerë që disa e kanë quajtur "imperializëm ekonomik" dhe që konsiston në shtrirjen e metodologjisë së ekonomisë neoklasike në zona jashtë sferës ekonomike. Këtu nuk bëhet fjalë më për të kuptuar se si sfera ekonomike dhe juridike ndikojnë reciprokisht në njëra-tjetrën, por për të studiuar e kuptuar procesin e "prodhimit" të rregullave të së drejtës (qasja pozitive) dhe vendosja e rregullave optimale të ligjit në kuptimi ekonomik (qasja normative). Ligji bëhet një sistem i thjeshtë për shpërndarjen e burimeve dhe përcaktimin e çmimeve, funksionimi i të cilit duhet kuptuar për të vendosur çmimet në nivelin optimal për të arritur efikasitetin e përgjithshëm të sistemit.

Në vitet 1970-të, literatura mbi këtë temë u përhap ndjeshëm falë dy revistave të dedikuara në këtë fushë, Journal of Law and Economics dhe Journal of Legal Studies, të krijuara përkatësisht nga Aaron director, profesor i së drejtës në Universitetin e Cikagos dhe Richard Posner, një nga personalitetet më të spikatura të shkollës ekonomike të së drejtës. Në të njëjtën periudhë, Henry Manne, gjithashtu një nga themeluesit e ekonomisë së ligjit, mori përsipër krijimin e “Qendrës për Drejtësi dhe Ekonomi” për një përhapje më të mirë të ideve të kësaj rryme brenda komunitetit ligjor amerikan. Në këtë nismë, Manne u mbështet fuqimisht nga Fondacioni John M. Olin, i cili luajti një rol shumë të rëndësishëm në instalimin e këtij lloj

kërkimi në shumë universitete amerikane si Harvard, Yale, Chicago, Stanford, Georgetown, Michigan etj.

Megjithatë, aplikimi i mjeteve të analizës neoklasike për të studiuar ligjin që rregullon veprimtaritë ekonomike e financiare është një fakt relativisht i ri. Shfaqjen serioze dhe imponuese në publik, ekonomia e së drejtës e bëri gjatë gjithë shek.XX-të, sidomos me punimet e John Rogers Commons dhe shkollës institucionaliste amerikane, e cila synonte të kuptonte se si sfera ekonomike dhe ajo juridike ndërthureshin dhe ndikonin reciprokisht te njëra-tjetra.

Më vonë, në gjysmën e dytë të shek.XX-të, autorë të shquar si Ronald Coase dhe Guido Calabresi, trajtuan problematikën e eksternaliteteve duke hapur një perspektivë të re studimesh të përbashkëta ndërmjet juristëve dhe ekonomistëve, duke i hapur rrugën "analizës së re bashkëkohore të ekonomisë së të drejtës".

Por, do të ishin disa teoricienë të shquar të shkollës së Cikagos dhe disa universiteteve të tjera prestigjioze amerikane, pikërisht, Richard Posner, Aaron Director, Henry Manne dhe George Stigler, të cilët i dhanë një vizion të ri dhe zhvillim më bashkëkohor kësaj disipline : bëhej fjalë për të analizuar me ndihmën e instrumenteve mikroekonomike tradicionale, kryesisht analizës së prodhimit, kostos, fitimit dhe eficencës, të rregullave të së drejtës. Në këtë rast, nuk bëhet më fjalë thjesht dhe vetëm "kuptimi se si sfera ekonomike dhe ajo juridike influencojnë reciprokisht te njëra-tjetra, por, te analiza e prodhimit të rregullave të së drejtës dhe vendosjen e rregullave për një të drejtë optimale në një optikë të rregullave dhe logjikës ekonomike.

Në funksion të objektivave të saj kryesore, fushave të kërkimit dhe specializimit të ekonomistëve dhe juristëve, analiza ekonomike e së drejtës ndahet në dy degë apo drejtime themelore: analiza pozitiviste dhe ajo normative. Analiza ekonomike pozitiviste e së drejtës përdor instrumentet e

analizës ekonomike për të përshkruar dhe interpretuar efektet e rregullave të së drejtës në sjelljen e aktorëve ekonomikë. Ndërsa, analiza ekonomike normative e së drejtës, bazuar në llogaritjen e eficencës, prodhon rekomandime për politika publike. Përcaktimi i saj më kryesor është ai "optimalitetit - Pareto" dhe kriterit Kaldor - Hick.

Ne shpesh e ndajmë analizën ekonomike të së drejtë, në dy degë relativisht të dallueshme nga njëra-tjetra, por që shpesh mbivendosen e barazohen ndërmjet tyre. Megjithatë, dallimi ka një interes në kuptimin që bën të mundur evidentimin e llojeve të ndryshme të objektivave që mund të ndiqen nga juristi ose ekonomisti që praktikon këtë lloj kërkimi. Ato janë analiza pozitiviste dhe analiza normative.

Analiza ekonomike pozitive e ligjit përdor mjetet e analizës ekonomike për të përshkruar dhe parashikuar efektet e rregullave të ligjit në sjelljen e agjentëve të ndryshëm ekonomikë. Kështu, mund të përshkruhen dhe krahasohen efektet e një sistemi të neglizhencës kundrejt një sistemi të përgjegjësisë strikte dhe të deduktohen përgjigjet racionale që agjentët do të prodhojnë nëse zbatohet një nga dy modelet e përgjegjësisë. Në fillim, Richard Posner mbrojti këtë lloj analize përpara se të njihte paragjykimet normative të qenësishme në punën e tij. Për më tepër, shpesh është pretenduar se kjo lloj analize përdoret për të shpjeguar krijimin dhe zhvillimin e rregullave ligjore nëpërmjet një procesi përzgjedhjeje që priret drejt efikasitetit.

Ndërkohë, analiza ekonomike normative e ligjit kalon një prag metodologjik duke prodhuar rekomandime për politikat publike mbi bazën e krahasimit dhe llogaritjes së efikasitetit. Në qendër të kësaj tipi analize është "nocioni i efikasitetit" dhe "pareto-optimalitetit". Një rregull ligjor cilësohet si "pareto-optimal" nëse nuk mund të ndryshohet pa e bërë qoftë edhe një person në një pozicion inferior ndaj atij përpara ndryshimit (ky është përkufizimi që kërkon supozimin më pak normativ për ndërtimin e tij). Një përkufizim më i fortë, për sa i përket supozimeve, është kriteri Kaldor-Hicks

i cili lejon ndryshimin e mësipërm nëse humbjet e përgjithshme mund të kompensohen (pavarësisht nëse janë realisht apo virtualisht) nga fitimet e përgjithshme.

Si zhvillime më të fundit të analizës ekonomike të së drejtës konsiderohen përdorimi i teorisë së lojës, vënia në pikëpyetje e racionalitetit të agjentit ekonomik në bazë të mësimeve të psikologjisë kognitive, përdorim në rritje i ekonometrisë dhe statistikave në prodhimin e modeleve gjithnjë e më komplekse, zbatimi i parimeve të neuroekonomisë në analizën ekonomike të ligjit, etj.

Analiza ekonomike e ligjit është një shkollë apo metodologji kërkimi shumë e përhapur dhe vlerësuar në SHBA. Një numër i konsiderueshëm vendimesh të drejtësisë ju referohen koncepteve të huazuara nga shkenca ekonomike; një numër i madh universitetesh zhvillojnë programe e diplomojnë studentë në të tre ciklet në fushën e analizës ekonomike të së drejtës.

Në Europë, kjo rrymë apo shkollë ekonomiko-juridike u zhvillua në fillim të viteve 1980-të, fillimisht në Britaninë e Madhe, Hollandë dhe Gjermani, dhe më vonë u shtri edhe në shumë vende të tjera europiane. Tashmë, edhe "European Association of Law and Economics" është një institucion mjaft aktiv dhe i rëndësishëm në shtrirjen sa më të gjerë të kësaj disipline komplekse kudo në Europë.

Duke i dhënë çmimin Nobel në 1991 Ronald Coase, Komiteti Nobel bëri shumë për të promovuar qasjen ekonomike ndaj ligjit në qarqet akademike. Në zhvillimin e kësaj fushe kërkimore kanë kontribuar edhe laureatë të tjerë: George Stigler (1982) studioi burimet dhe efektet e rregullimit publik, James Buchanan (1986) u interesua për bazat kontraktuale dhe kushtetuese të procesit të vendimmarrjes politike. Gary Becker u shpërblye në vitin 1992 për zgjerimin e fushës së analizës mikroekonomike në një numër të madh sjelljesh jo të tregut, duke përfshirë sjelljen kriminale.

Kësaj liste duhet t'i shtojmë sigurisht edhe Friedrich Hayek, i vlerësuar në vitin 1974 dhe puna e të cilit ka ngjallur prej kohësh interesin e ekonomistëve dhe juristëve, por edhe William Vickrey apo James Mirrlees, fitues i çmimit Nobel në vitin 1996, kontributet e të cilëve në fushën juridike kanë qenë domethënëse.

Ekspertë të ndryshëm shohin në këtë qasje ndërdisiplinore një rizbulim të vonuar të interesit të ekonomistëve "klasikë" për lidhjet e ngushta që bashkojnë disiplinat që ndikojnë në organizimin e shoqërisë (filozofia, ligji, ekonomia, historia). Të përmendura shpesh në këtë drejtim janë veprat e Jeremy Bentham ose Cesare Beccaria në fund të shekullit të 18-të.

Në traditën utilitare, llogaritja bentamiane dëshiron që një ligj të vlerësohet në lidhje me aftësinë e tij për të promovuar "lumturinë" e anëtarëve të shoqërisë, për të çliruar një tepricë kënaqësie. Nëse vërtet mund të perceptojmë një ndërlidhje intelektuale midis këtyre pararendësve dhe ithtarëve të analizës bashkëkohore, rezulton se kjo metodë sot hyn në teorinë mikroekonomike.

Richard Posner – Funksionet ekonomike të së drejtës

Richard Posner konsiderohet si “pionieri i analizës ekonomike të së drejtës”. Duke filluar që në vitin 1969 në gjirin e “National Bureau of the Economic Research”, Posner realizoi një seri kërkimesh me fokus “funksionet ekonomike të së drejtës”, mbi konceptet themelore të së drejtës kushtetuese dhe civile. Ai nuk hezitoi të përdorte parimet themelore të shkencës ekonomike për të “goditur” bazat tradicionale të së drejtës në SHBA, veçanërisht të drejtën e konkurrencës (Antitrust Law).

Posner kontestoi ekzistencën e barrierave “të krijuara” për të hyrë në një treg të dhënë, gjë që favorizonte ndërmarrjet e tjera që vepronin në kuadrin e këtij tregu. Për shkollën e analizës të së drejtës, ky konstatim nuk ishte gjë

tjetër veçse "reflektim i eficencës më të madhe që kishin ndërmarrjet ekzistuese në këtë treg". Për Posnerin, të vetmet pengesa që ka për të hyrë në një treg, janë ato që imponohen nga pushtetet publike nëpërmjet "masave të rregullimit të tregut".

Me një këndvështrim krejt të ri për kohën, ai tregoi se "për të gjykuar për egzistencën apo mosegzistencën e konkurrencës nuk mjaftonte vetëm një fotografim i tregut në një moment të dhënë, por mbasi të kesh njohur të drejtën dhe lirinë e konkurrentëve të rinj për të hyrë në këtë treg dhe ofruar atje produktet apo shërbimet e tyre".

Në këtë kuptim : monopoli nuk e përjashton konkurrencën. Sipas Posner, nëse në treg ka vetëm një ndërmarrje që e dominon atë, por nuk ka asnjë pengesë që ndërmarrje të tjera të hyjnë atje, kjo do të thotë se kjo ndërmarrje është e vetmja që i përgjigjet me eficencë kërkesave të këtij tregu. Ai e shtriu studimin në shumë elemente të tjera të Common Law: kontratat, përgjegjësia kontraktore dhe jashtë-kontraktore, e drejta penale, konfliktet, arbitrazhet, etj. Teza e tij kryesore synonte të ilustronte eficencën e madhe të së drejtës bazuar në sistemin Common Law, që nuk vinte nga natyra e së drejtës, por nga qëllimi i saj. Duke mbrojtur këtë tezë, Posner nënvizonte se sistemi gjyqësor anglo-sakson është eficent sepse gjykatësit amerikanë apo britanikë, ndryshe nga magjistratët europianë, kanë motive ekonomike direkte të lidhuara me ushtrimin e juridiksionit të tyre .

Në manualin e tij të parë "Economic Analysis of Law", Posner hodhi bazat e këtij koncepti të ri. Në të njëjtin vit, ai themeloi dhe "Journal of Legal Studies", revistën më prestigjioze në trajtimin e problematikës së analizës ekonomike të fenomeneve juridike, e cila botohej nga universiteti i Chicago-s, duke qenë për dhjetë vite edhe kryeredaktori i saj.

Posner evidentonte "dy degë kryesore në analizën ekonomike të së drejtës" : të parën të krijuar nga Adam Smith, e cila analizonte të drejtën ekonomike në kuptimin e mirëfilltë të saj së bashku me rregullimin e tregut; të dytën, të

krijuar nga Jeremy Bentham, me të cilën identifikohej dhe vetë Posneri, e cila aplikonte konceptet e analizës ekonomike në sjelljet jashtë tregut të tilla si aksidentet, kriminaliteti, ndotja, procedurat dhe proceset politike, aborti, droga,etj.

Për Posnerin, njeriu vepron gjithmonë në mënyrë racionale, jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në shumë fusha të tjera, pra në gjithë aktivitetin e tij. Sjelljet "kriminale" apo "anti-ligjore" të një individi vijnë si pasojë e "llogaritjeve me natyrë ekonomike" që ai bën : për të frenuar kriminalitetin duhej gjetur "çmimi i drejtë i krimit", duhej gjetur një ekuilibër i drejtë ndërmjet ashpërsisë së ndëshkimit nga njëra anë dhe probabilitetit të kryerjes së tij nga ana tjetër.

Posner dallonte "sjelljen normative" dhe "sjelljen pozitive" në analizën e të drejtës, duke u pozicionuar në favor të sjelljes pozitive, dhe në këtë kuadër ai mbronte hipotezën e tij se "e drejta me origjinë juridike (common law ose judge-law) inkurajon eficencën, në ndryshim nga e drejta me origjinë legjislative ose rregulluese, që e frenon apo nuk e stimulon eficencën.

Globalizimi po vë në konkurrencë edhe sistemet juridike, dhe sipas Posnerit, sistemi anglo-amerikan i Common Law i bazuar tek jurisprudenca po fiton çdo ditë e më tepër terren si një sistem "i eficencës ekonomike që favorizon zhvillimin e tregjeve" ndaj të drejtës së kodifikuar "romano-gjermane".

Por, megjithëse Posner ka një vizion pozitivist, ai nuk legjitimon një rol të madh të Shtetit në prodhimin e ligjeve, duke e cilësuar Shtetin "vetëm si një institucion ndërmjetësues" të ngjashëm me një ndërmarrje private, por jo një aktor unik në prodhimin e së drejtës.

Richard Posner i ka kushtuar një analizë specifike problemit të krizës financiare globale që filloi në vitin 2008 në SHBA. Nën një fokus të veçantë interpretimi, Posner kritikon kolegët e tij liberalë të "Chicago School" duke nënvizuar se "lëvizjet derregulluese të industrisë financiare që shkaktuan krizën nuk ishin gjë tjetër veçse një rënie e kapitalizmit në kurthin e

“laisser-faire”..se kjo katastrofë nuk ishte fryt i një “dritëshkurtësie fajtore”, por rezultat i vendimeve individuale racionale, pasojat e të cilave nuk u integruan si duhet me tërësinë e sistemit financiar.

Duke studiuar shkaqet e lindjes dhe mënyrat e shfaqjes së krizës, Posner pozicionohet kundra idesë se flluska financiare dhe kriza erdhën si pasojë e irracionalitetit të agjentëve ekonomikë, apo si pasojë e “oreksit për risk të sektorit financiar”. Përkundrazi, “ekzistenca e flluskës financiare si dhe pasojat e shpërthimit të saj ishin të njohura në mjediset bankare amerikane, por çdo aktor i këtyre mjediseve nuk mund të bënte gjë tjetër veçse të kërkonte të përfitonte nga kjo situatë, sepse në rast të kundërt, duhet të përballej me humbje të rënda në raport me konkurrentët e tij”.

Ai kërkoi të bindte konservatorët amerikanë, se kjo krizë evidentoi më së miri dështimin e teorisë së “kapaciteteve autorregulluese të tregut” dhe provoi “domosdoshmërinë e ndërhyrjes publike masive për të amortizuar pasojat imediate të saj, ndërkohë që, në një vështrim më afat-gjatë, vetëm një rregullim aktiv dhe orientues i tregjeve financiare do të krijonte mundësitë që një fenomen i tillë të mos përsëritej” .

Sipas tij, gabimi mund të përmblidhet në “dy politikat shkatërruese”: eksesi në ofertën monetare dhe derregullimi i skajshëm i tregjeve financiare, i cili nuk u krye në bazë të argumenteve ekonomike solide, por thjesht në besimin te vetitë autorregulluese të konkurrencës, që i bëri ekonomistët dhe politikanët “të verbër përballë rolit specifik të sektorit monetar e financiar”, që bëri të mos dëgjohej asnjë prej paralajmërimeve për riskun sistemik që po zgjerohej çdo ditë e më tepër.

Kundër ideve liberale, Posner mbron qëndrimin se për të dalë nga kriza duhet një “ndërhyrje masive publike, qoftë edhe duke rritur borxhin publik apo taksat”. Sipas Posnerit, edhe pse ndërhyrja qeveritare konsiderohet si joefektive, ajo do të ndikojë pozitivisht në zbutjen e parashikimeve

pesimiste që janë shkaktare nga më kryesoret në thellimin e recesionit apo depresionit .

Gary Stanley Becker

- Analiza ekonomike e krimit dhe korrupsionit

Ekonomist amerikan i njohur veçanërisht për punimet në analizën mikroekonomike në studimin e sjelljes njerëzore de teorinë e kapitalit human. Laureat i çmimit Nobel në vitin 1992. Punimet e tij mbi analizën ekonomike të kriminalitetit hodhën bazat e zhvillimit të "analizës ekonomike të së drejtës" duke ndikuar në njëkohësisht si në teorinë ekonomike ashtu dhe në teorinë e së drejtës.

Becker arriti të modelizojë sjelljet devijante nën një optikë racionaliteti duke nënvizuar se ....ekonomia është arti për të nxjerrë sa më shumë përfitime nga jeta..... kërkimet e mia përdorin logjikën ekonomike për të analizuar problemet shoqërore që ndodhin jashtë preokupimeve të zakonshme të ekonomistëve....metoda ekonomike që unë i referohem nuk supozon se individët janë të motivuar vetëm nga egoizmi dhe dëshira për fitim. Unë përdor një metodë analize dhe jo një hipotezë për motive të veçanta. Jam përpjekur ti shkëpus ekonomistët nga hipoteza e ngushtë e interesit personal, sepse sjellja e njeriut komandohet nga një tërësi elementesh shumë më të larmishëm se sa vlera dhe preferencat. Analiza ime supozon se individët maksimizojnë mirëqenien duke qenë të ndryshëm në karakterin e tyre: egoistë, altruistë, besnikë, mashtrues, mazokistë.....ata tentojnë të parashikojnë sa më mirë pasojat e paqarta të veprimeve të tyre. Një sjellje e caktuar që shikon e nga e ardhmja mund ti ketë rrënjët e saj në të kaluarën, sepse e kaluara ndikon në mënyrë të qëndrueshme në sjelljet dhe vlerat e të sotmes, apo mendimet për të ardhmen.

Në librin "The Economics of Discrimination" (1957), Becker vlerëson se diskriminimi është një problem ekonomik, dhe për pasojë, në studimin e tij mund të aplikohen të njëjtat instrumente të analizës ekonomike si për gjithë problemet e tjera ekonomike. Sipas tij, diskriminimi kulturor vjen nga fakti se tregu i punës shpërblen dhe mjaft cilësi që nuk shprehen nëpërmjet diplomës apo nivelit të shkollimit, cilësi që varen nga origjina sociale. Një pjesë e punëdhënësve "ka një sjellje të veçantë ndaj diskriminimit", sjellje në emër të së cilës ata pranojnë disavantazhin konkurrues, pasi refuzojnë të marrin në punë kandidatë të vlefshëm duke u vendosur kështu në një situatë ekuilibri jo-optimale. Kur një punëdhënës i bardhë punëson shumë pak ose aspak punëtorë me ngjyrë, ai vepron sikur kosto e kësaj fuqie punëtore të ishte e barabartë me ë(1+d), ku ë është paga mesatare, ndërsa d është koeficienti i diskriminimit. Ekonomia e diskriminimit krijon mundësi që të shpjegohet më qartë edhe vetë teoria e kapitalit human, e cila e vetme nuk arrin të japë argumente të qarta për diferencat në pagë kur cilësitë profesionale dhe produktiviteti i të punësuarve është i njëjtë.

Becker tregoi me shembuj konkretë se punësuesit e bardhë janë gati të pranojnë koston shtesë që atyre ju vjen nga sjellja diskriminuese ndaj zezakëve. Në vend që të aplikojë hipotezën standarde që punëdhënësit interesohen vetëm për produktivitetin e të punësuarve, se të punësuarit injorojnë karakteristikat e kolegëve të tyre të punës, dhe se konsumatorët interesohen veçse për cilësinë dhe çmimin e mallrave apo shërbimeve që blejnë, Becker përdor "koeficientët e diskriminimit" të cilët integrojnë influencën e racës, seksit, ngjyrës, pamjes, etj., në mënyrat e sjelljes. Sipas tij, shumë njerëz mund të refuzojnë të punojnë si vartës të një femre zezake edhe pse mund të paguhen mirë për këtë post pune, shumë blerës nuk preferojnë të blejnë në dyqanet e afrikanëve, portorikanëve apo aziatikëve thjesht sepse i përbuzin apo nuk i vlerësojnë ata,etj. Vetëm duke e zgjeruar në këtë drejtim hipotezën tradicionale është e mundur të kuptohen dhe shpjegohen vështirësitë dhe pengesat e mjaft projekteve apo politikave në

mbështetje të integrimit të emigrantëve apo të ecurisë normale të karrierës së emigrantëve në fushën ekonomike e sociale .

Në librin e tij të njohur "Human Capital" (1964), Becker sugjeron se kërkesa për edukim reagon në funksion të kostove direkte e indirekte të shkolllimit e edukimit dhe variacionit të të ardhurave potenciale që mund të fitohen nga ky shkollim. Sjellja e studentit identifikohet me atë të një investitori racional që krahason atë që atij i kushton shkollimi me të ardhurat që do të përfitojë më vonë në karrierën profesionale si efekt i këtij shkollimi. Kosto e formimit të kapitalit human krahasohet me të ardhurat e ardhshme që individi do të përfitojë nga puna dhe kualifikimi i tij. Kjo kosto ka natyra të ndryshme: kosto edukimi, shërbime mjekësore, kërkim informacioni, stazh profesional, ç'vendosje gjeografike,etj. Të gjitha këto konsiderohen si një investim për kapitalin human, investim që duhet të jetë rentabël, pra ti japë frytet e tij në të ardhurat e mëvonshme që kanë burimin pikërisht nga vënia në shfrytëzim e këtyre kapaciteteve të fituara të kapitalit human.

Në këtë kontekst, Becker analizon dhe mënyrat se si duhet të financohen sistemet edukative dhe ato shëndetësore : nga një pikëpamje është logjike që individët duhet të paguajnë për studimet e tyre, sepse qenia e tyre falas i con në shpërdorime dhe neglizhencë ndaj tyre, si dhe zhduk konkurrencën ndërmjet institucioneve arsimore; ndërsa nga ana tjetër, duke parë efektin e madh që edukimi dhe shëndeti kanë në cilësinë e kapitalit human, në rastet me interes të dukshëm publik, është e justifikueshme dhe një financim publik i këtyre sistemeve .

Në studimin "Crime and punishment: An economic approach " (1968), Becker propozon një analizë ekonomike të krimit dhe korrupsionit. Ai studion mundësinë e aplikimit të arsyetimit ekonomik në teorinë pozitive të sjelljes kriminale dhe një politike normative optimale kundrejt krimit. Becker mendon se individët i zgjedhin aktivitetet e tyre si një lloj konsumi

individual. Të merresh me një aktivitet kriminal është thjesht një vendim individual që vë në balancë kostot dhe përfitimet nga ky aktivitet.

Individët bëhen kriminelë në funksion të rendimentit financiar të krimit, të krahasuar me rendimentin financiar të pagës në kushte normale ligjore, përfshirë këtu dhe mundësinë e arrestimit apo dënimit. Është e rëndësishme të kuptohet se nxitja për të ushtruar një aktivitet ilegal bëhet më e fortë kur është e vështirë të gjesh një vend pune normal e të rregullt, apo kur ndëshkimet kundra krimit janë të buta apo kur neglizhohet zbatimi i tyre. Korrupsioni përbën një treg me ofertën (atë të funksionarëve apo politikanëve) dhe kërkesën (atë të bizneseve dhe individëve) e tij.

Edhe në këtë rast, tregu i korrupsionit dhe "çmimi" i tij funksionon si raport i kërkesës me ofertën. Ekuilibri i tyre përcakton sasinë optimale të korrupsionit, në sensin që lejon një çmim të dhënë ekuilibri ndërmjet sasisë së ofruara dhe atyre të kërkuara të korrupsionit.

Becker nënvizon rëndësinë që kanë masat ndëshkuese ndaj korrupsionit si mjeti më efektiv i luftës kundër tij. Por, nga ana tjetër, edhe perfeksionimi i metodave të zbulimit të korrupsionit ka rëndësi të madhe, pasi i jep më tepër vlerë masave ndëshkuese. Becker tregon me shembuj konkretë se kur sanksionet janë efektive, kjo cilësohet dhe si "mospagim i krimit", pra, aktivitetet kriminale shkojnë drejt shuarjes me përjashtim të atyre që pranojnë një shkallë të lartë rreziku.

Në vitin 1981, Becker boton librin "Trease on the Family" në të cilin e paraqet familjen si "një ndërmarrje të vogël : vendimi për të pasur fëmijë, p.sh., mund të analizohet si një kërkesë për "mallra të qëndrueshëm" afat-gjatë. Ky vendim mbështetet mbi një sjellje racionale të prindërve të cilët kanë preferenca përsa i përket sasisë dhe cilësisë së fëmijëve të tyre, dhe sasisë së shpenzimeve që duhet të bëjnë për të arritur nivelet që dëshirojnë. Becker evidentoi se në këtë rast ekziston një ekuilibër real tregu por me çmime fiktive. Zvogëlimi i përmasave të familjeve, pra, rënia e numrit të

fëmijëve për familje, shpjegohet nga rritja e kostos për çdo fëmijë, kosto në para, kohë e impenjime që prindërit duhet të bëjnë për fëmijët në raport me objektivat e tyre. Edhe vetë vendimi për tu martuar është i ngjashëm me motivacionet që i shtyjnë individët për të krijuar një ndërmarrje: të dy partnerët lidhen nëpërmjet një kontrate specifike në mënyrë që të reduktojnë koston e transaksioneve. "Organizimi i prodhimit në ekip" kushton më pak se rinegocimi i vazhdueshëm "ndërmjet dy punëtorëve të veçuar nga njëri-tjetri".

Ndarja e punëve në gjirin e familjes shpjegohet me avantazhet krahasuese që krijohen nga diferencat gjinore biologjike. Nëpërmjet kontratës apo institucionit të martesës, femra "angazhohet në lindjen dhe kujdesin për fëmijët", kundrejt mbrojtjes dhe garancisë në qëndrueshmërinë e familjes që jep mashkulli. Një martesë është optimale kur raportet e kontributit të dy bashkëshortëve janë teknikisht plotësuese në "prodhimin e përbashkët" që janë fëmijët dhe jeta familjare. Shtimi i divorceve shpjegohet me rritjen e pagës së femrave në tregun e punës dhe ekzistencën e politikave sociale që ndihmojnë gratë e divorcuara, elemente që i shtojnë atyre mundësinë dhe garancinë se mund t'ja dalin të vetme në përballimin e jetës dhe rritjen e fëmijëve.

Gary Becker ka një kontribut origjinal në "teorinë e re të konsumatorit". Tradicionalisht, analiza ekonomike e trajton konsumatorin si një agjent final, si një individ që fiton një sasi të ardhurash, që ka një sasi nevojash apo dëshirash që synon ti plotësojë apo kënaqë duke blerë në treg mallra apo shërbime, duke qenë i limituar nga fuqia blerëse e tij. Megjithëse në përputhje me postulatin e çdo teorie ekonomike, konsumatori është një qenie racionale, llogaritës dhe maksimizues i utilitetit, roli i tij është pasiv. Ai kënaqet duke harmonizuar "shportën" e blerjeve në funksion të intensitetit të nevojave të tij, ndërmjet të cilave ai ushtron një seri arbitrazhesh ndërmjet parave që disponon dhe çmimeve që duhet të paguajë për të kënaqur nevojat.

Në përputhje me këtë, teoria ekonomike i konsideron nevojat dhe dëshirat si "ekzogjene", dhe ekonomistët ja lënë sociologëve apo psikologëve detyrën që të shpjegojnë procesin e formimit të këtyre dëshirave. Problemi i vetëm i ekonomistëve është analiza se si aparati prodhues i përgjigjet ndryshimeve të strukturës së nevojave. Nuk kërkohet nëse ekziston apo jo një lidhje e ndërsjellë ndërmjet mënyrës se si formohen apo evoluojnë të ardhurat dhe kësaj strukture nevojash. Sjellja e individëve në raport me punën, edukimin, shëndetin,etj., konsiderohen si të veçuara nga sjellja e konsumatorit në raport me zgjedhjet që ai bën në procesin e konsumit.

Gary Becker me analizën e tij e ndryshoi hipotezën tradicionale të ekonomisë së konsumatorit. Monetaristët hodhën idenë që konsumatori nuk ishte thjesht një qenie pasive, por ishte një individ llogaritës, i aftë që të "arbitronte në mënyrë ndër-kohore", në të cilën shpenzimet e konsumit vareshin jo vetëm nga niveli imediat i të ardhurave të tij, por edhe nga parashikimet për nivelin e tyre në të ardhmen.

Por, ndërkohë që monetaristët u kënaqën duke e shpjeguar këtë inovacion në kuadrin e analizës ekonomike dhe shpjeguan mënyrën se si formohet shpërndarja e të ardhurave të familjeve apo njësive ekonomike ndërmjet kursimit dhe konsumit (nocioni i "ciklit vital të kursimit"), Becker shkoi akoma më tej në studimin e tij duke analizuar veçanërisht "mënyrën e sjelljes parashikuese të konsumatorit dhe reagimin e tij jo vetëm në marrëdhëniet ekonomike të tregut por edhe në ato jashtë tregut.

Rezultat i kësaj ishte lindja e një teori të re mbi sjelljen konsumatore", pika e nisjes të së cilës ishte se "blerja e një malli apo shërbimi nuk përbën një akt ekonomik final". Akti i konsumit nuk ishte veçse një "akt ekonomik ndërmjetës i përdorur nga konsumatori për të prodhuar një kënaqësi apo dëshirë finale, kënaqësi që për të njëjtin objekt mund të ishte i ndryshëm në përputhje me karakterin dhe specifikat e individit.

Në këtë optikë, konsumatori nuk ishte vetëm një qënie që konsumonte, por një agjent ekonomik që "prodhonte". Që prodhonte kënaqësi për të cilat ai ishte konsumator. Pra, është një prodhues, që për të prodhuar kënaqësitë që ai kërkon, përdor "inputet" që janë në fakt blerjet që bën në treg, si dhe një burimi tjetër krejtësisht jashtë skemave ekonomike klasike, por shumë thelbësore siç është "koha". Konsumatori kërkon që të plotësojë në maksimumin e mundshëm kënaqësitë e tij në funksion të të ardhurave dhe kohës. Në këtë pikëpamje, çdo akt individual konsiderohet si një akt ekonomik që kushtëzohet nga dy kufizime : "sasia e parave dhe sasia e kohës". Shuma e të dyjave jep shumën totale të "të të ardhurave sociale" që konsumatori disponon për të kënaqur qëllimet e tij.

Përfshirja nga Becker e "kohës" në analizën e aktiviteteve të individit është elementi çelës i teorisë së re të sjelljes konsumatore. Prej saj rrjedhin tre konsiderata thelbësore : 1) lejon që të shpjegohet pasioni shpesh irracional i shoqërive të sotme për akumulimin e objekteve, apo realizimin e shumë shpenzimeve "irracionale" thjesht e vetëm për "kënaqësi" shpirtërore apo "për tju bërë përshtypje të tjerëve"; 2) na jep një vizion të ri për të shpjeguar arsyen e modifikimit në kohë të strukturës së blerjeve dhe modeleve të konsumit, e cilësuar dhe "destabilitet i preferencave", ose sic shprehet Becker, "e vetmja gjë që ndryshon është çmimi i kohës"; 3) na ndihmon për të zbuluar përse "liria e të konsumuarit" është më thelbësore se "liria individuale".

Becker riformuloi teorinë e zgjedhjes së konsumatorit duke integruar në të edhe shpërndarjen e kohës të destinuar për punë shtëpiake. Ky model krijon mundësi që të analizohet oferta e punës dhe specializimi në detyrat apo "profesioneve" në gjirin e familjes. Utiliteti nuk vjen nga blerjet që kryhen direkt në treg, por vlerësohet si një "nënprodukt" i të gjitha llojeve të prodhimeve të familjes, pra dhe atyre që realizohen "jashtë tregut normal". Becker analizon edhe pasojat që shkakton sjellja afektive e njërit prej anëtarëve të familjes për një anëtar tjetër, duke formuluar "teoremën e

fëmijës së përkëdhelur", e cila evidenton "rolin altruist në familje". Supozohet se kryetari i familjes është altruist dhe preokupohet vecanërisht për utilitetin që gëzojnë anëtarët e tjerë të familjes duke marrë rolin e një "mirëbërësi".

Në këtë rast, Becker nënvizon se kënaqësia që "mirëbërësi" ndjen nga mirëqenia e anëtarëve të tjerë të familjes çon në një lloj "infektimi të virtytit". Fëmija apo fëmijët egoistë, duke parashikuar sjelljen altruiste të kryetarit të familjes, sillen në mënyrë të tillë që nxjerrin përfitim maksimal prej saj. Në këtë sens, vlerësohet se funksioni i utilitetit të familjes është ai i "mirëbërësit" i cili nuk e ka problem tërësinë e agreguar të sadisfaksionit në gjirin e familjes.

Sipas Becker, prindërit veprojnë shpesh në mënyrë altruiste kundrejt fëmijëve egoistë duke investuar shumë tek fëmijët e tyre në mënyrë që të evitojnë vetminë dhe varfërinë kur të jenë në moshën e pensionit, megjithëse në shumë raste investimi për fëmijët e kalon ndjeshëm investimin potencial për të garantuar të ardhura të mjaftueshme gjatë moshës së pensionit.

Kjo sjellje i "detyron" fëmijët që të ndjehen përgjegjës për prindërit e tyre kur këta të kenë nevojë për ndihmë. Becker e vlerëson sistemin e sigurisë sociale si një armik potencial të familjes, i cili i dobëson lidhjet familjare prindër-fëmijë, dhe sidomos sjelljen altruiste të prindërve ndaj fëmijëve. Sipas tij, kjo shpjegon dhe fenomenin e shpërbërjes së familjes dhe tendencave të një jete sa më individuale të anëtarëve të saj, sidomos në vendet e zhvilluara apo ato me sisteme mbështetje sociale të zhvilluara.

Në shumë artikuj të botuar në shtypin amerikan dhe atë europian në vitet 1980-të, Becker analizon shkakun e papunësisë në Europë në dekadën 1980-90 dhe konkludon se papunësia e lartë e kësaj periudhe nuk u shkaktua nga vështirësitë makroekonomike, por nga "ashpërsia e tregut të punës" dhe niveli i lartë i sigurimeve sociale dhe taksave që rëndonin mbi të punësuarit dhe pagat. Ai denoncoi pretendimet e politikave mbështetëse keynesianiste

si dhe politikat e ashtuquajtura të "ndarjes së punësimit" : reduktimi i sforcuar i numrit të orëve të punës, në vend që ta rrisë punësimin e zvogëlon atë, pasi ai rrit artificialisht koston efektive të punës.

Megjithëse qeveritë europiane e gjenin politikisht komode të besonin se niveli i lartë i papunësisë vinte nga progresi teknik apo nga konkurrenca e vendeve të tjera, Becker konstatoi se SHBA dhe Britania e Madhe përballeshin me të njëjtat zhvillime si Europa kontinentale, por ato kishin nivel dukshëm më të vogël papunësie.

Sipas tij, diferenca vinte si pasojë e fleksibilitetit dhe lirisë në tregjet e punës që ishte një dukuri tipike në vendet anglo-saksone. Por, përse nuk kopjohej modeli anglo-sakson i tregut të punës nga vendet europiane? Përgjigjja duhej kërkuar tek forca e madhe që kishin sindikatat në Europë dhe te ekzistenca e "punëtorëve fiks" të cilët përfitonin paga të larta dhe luftonin me çdo mjet e mënyrë për ti ruajtur sa më gjatë avantazhet dhe privilegjet e tyre të fituara në kuadrin e modelit social europian dhe traditës sindikaliste.

Bibliografia

- Gary Becker (1993) [1964]. Human capital: a theoretical and empirical analysis, with special reference to education (3rd ed.). Chicago: The University of Chicago Press.
- Gary Becker (1968), "Discrimination, economic", in Sills, David L. (ed.), International Encyclopedia of Social Sciences, Vol. 4 Cumu to Elas, New York, New York: Macmillan,
- Gary Becker (1971). The economics of discrimination. Chicago: University of Chicago Press.

- Gary Becker (1974). Essays in the economics of crime and punishment. New York: National Bureau of Economic Research distributed by Columbia University Press.
- Gary Becker (January 1985). "Human capital, effort, and the sexual division of labor". Journal of Labor Economics. 3 (1): 33–58.
- Gary Becker (1974). Essays in the economics of crime and punishment. New York: National Bureau of Economic Research distributed by Columbia University Press.
- Gary Becker; Kevin M. Murphy (2000). Social economics market behavior in a social environment. Belknap Press of Harvard University Press.
- Steven M. Teles (2008), The rise of the conservative legal movement: the battle for control of the law, Princeton University Press.
- William Harms (May 4, 2014). "Gary S. Becker, Nobel-winning scholar of economics and sociology, 1930–2014". University of Chicago.
- Richard A. Posner (2004). Frontiers of legal theory. Harvard University Press.
- Richard A. Posner (1992), Economic Analysis of law, Hardcover, January 1992, Publisher:Aspen Publishers
- Richard A. Posner (1981) , The Economics of Justice, Harvard University Press, 432 Pages
- Richard A. Posner (2001), The Economic Structure of the Law: The Collected Economic Essays of Richard A. Posner, Volume One, Hardcover, Edward Elgar Publishing, 462 Pages
- Richard A. Posner (2011), What Caused the Financial Crisis, Paperback, University of Pennsylvania Press, 376 Pages

- Mitchell Polinsky (2018), An Introduction To Law and Economics (Aspen Coursebook Series) 5th Edition, 224 pages
- Thierry Kirat (2012), Économie du droit, Pocket Book – September 20, 2012, French Edition LA DECOUVERTE edition (September 20, 2012)
- Nicita Antonio & Massimiliano Vatiero, (2007), "The Contract and the Market: Towards a Broader Notion of Transaction?". Studi e Note di Economia, 1:7-22, 2007
- David Friedman (1987). "law and economics," The New Palgrave: A Dictionary of Economics, v. 3, p. 144.
- Paolo Silvestri, (October 1, 2019). "On the (Methodological) Future of Law and Economics. The Uneasy Burden of Value Judgments and Normativity". Global Jurist. 19 (3);
- Nicholas L. Georgakopoulos, (2005). Principles and Methods of Law and Economics: Basic Tools for Normative Reasoning (Cambridge University Press);
- Lewis Kornhauser, (2006), "The Economic Analysis of Law," Stanford Encyclopedia of Philosophy.
- Steven Shavell, (2004). Foundations of Economic Analysis of Law. Harvard University Press.
- Samuel Ferey, [2009], Une histoire de l'analyse économique du droit, Bruylant, Bruxelles.
- Lewis A.Kornhauser, [1985], « L'Analyse économique du droit », Revue de Synthèse, série III, n°118-119, pp. 313-329.

Raporti qendër - periferi
në situata krizash politike në Shqipëri

Prof. Asoc. Roland Lami
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
roland.lami@umsh.edu.al

Dr. (p) Ilir Hebovija
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
ilir.hebovija@umsh.edu.al

Abstract

Countries with a hybrid regime, since they have weak law-enforcement institutions, give political parties a lot of room for influence. In 31 years of political pluralism. political crises have shown that they negatively influence the functionality of the market, public administration, local government, foreign investments, justice institutions, electoral administration, the education system, the academy of sciences, civil society, unions, etc. All the measurements carried out by international and local institutions confirm the causal relationship between the political crisis and the deterioration of the performance of the aforementioned institutions.

In these circumstances, the political actors (the two main parties), in quite a few cases, seek the legitimacy to solve the crisis from international institutions and not from the institutions that they have produced themselves over the years. This, not without reason, as they know the quality of the functioning of the institutions that are at best captured by both parties or at worst, only by one party. In these conditions, the solution does not come from within, but from without. Moreover, we are listing some of the most

important crises of the period 2018 - 2020 to illustrate the approaches of the international community in relation to the very complex situations in which political actors are placed in Albania, at the same time to test the validity of this approach in relation to democratization processes in the country.

Keywords: Center-periphery report, Albania, crisis

Abstrakt

Venden me regjim hibrit duke qenë se kanë institucione ligjzbatuese të dobta, iu jep shumë hapësirë për influencë partive politike. Në 31 vite pluralizëm politik. krizat politike kanë treguar se influencojnë negativisht në funksionalitetin e tregut, administratën publike, pushtetin lokal, investimet e huaja, institucionet e drejtësisë, administratën zgjedhore, sistemin arsimor, akademinë e shkencave, shoqërinë civile, sindikatat etj. Të gjitha matjet e kryera nga institucione ndërkombëtare dhe lokale konfirmojnë marrëdhënien shkakësore mes krizës politike dhe përkeqësimit të performancës së institucioneve të lartpërmendura.

Në këto rrethana, aktorët politikë (dy partitë kryesore), në jo pak raste e kërkojnë legjitimitetin për zgjidhjen e krizës tek institucionet ndërkombëtare dhe jo tek institucionet që kanë prodhuar vetë në vite. Kjo, jo pa arsye, pasi dinë cilësinë e funksionimit të institucioneve që janë në rastin më të mirë të kapura nga të dy palët ose në rastin më të keq, vetëm nga njëra palë. Në këto kushte, zgjidhja nuk vjen nga brenda, por nga jashtë. Për më tepër po rendisim disa nga krizat më të rëndësishme të periudhës 2018 – 2020 për të ilustruar qasjet e komunitetit ndërkombëtar në raport me situatat shumë komplekse në të cilën vendosen aktorët politikë në Shqipëri, njëkohësisht edhe për të testuar vlefshmërinë e kësaj qasjeje në raport me proceset demokratizuese në vend.

Fjalë kyce: Raporti qender – periferi, Shqipëri, kriza

1. Kuadri Teorik

Shteti partiak për Rusell dhe Cohn (2013) përkufizohet shumë thjesht si çdo sistem socio-kulturor dhe/ose ekonomik, në të cilin vendimet themelore të jetës së përditshme publike dhe private nuk merren nga individë ose korporata (si në ekonomitë kapitaliste të tregut dhe ekonomitë e përziera) dhe as nga qeverisja (si në komunizëm dhe fashizëm) dhe as nga udhëheqësit fetarë (si në teokraci), por nga partitë politike. Ky shndërrim strukturor për Ragazzoni (2019) iu ka mundësuar partive politike një rol përcaktues në procesin e krijimit të vullnetit dhe të vendimmarrjes, madje edhe në administratën shtetërore. Jo pak studiues e interpretojnë shtetin partiak si fenomeni i shkërmoqjes së republikës dhe si përparim antidemokratik i njëcezarizmi pothuajse absolutist të udhëheqësit apo të udhëheqësve të partisë (Schmidt, 2012).

Shteti i partive (Mair, 2002) është përcaktimi më i përshtatshëm për një shoqëri si e jona kur përpara se të fitohet një vend pune, të bëhet karrierë, të merret një provim shtetëror, të merret shtetësia, të pranoheni në një universitet (publik ose privat), të hapni një llogari bankare, pra në çdo aktivitet tjetër për të cilin mund të mendoni, t'ju lindë nevoja t'i drejtoheni partive kryesore politike. Pra, falë rolit të dy partive kryesore i gjithë sistemi kontrollohet dhe influencohet, ose është i pafuqishëm për t'i bërë ballë presionit ose interesit të partive politike.

Superstruktura politike - nëse do flisnim me logjikën marksiste - implikon të gjitha strukturat e tjera social-ekonomike dhe kulturore. Nëse kjo superstrukturë shfaq probleme, i gjithë sistemi ndikohet nga të tilla probleme (Louis, 2016). Ky sistem partitokracie ka prodhuar krizë besimi tek shumica e shqiptarëve, të cilët nuk besojnë te subjektet politike shqiptare dhe institucionet e ndërmjetme të shtetit shqiptar pasi mendojnë se ato janë burimi i krizës. Në këto rrethana, aktorët politikë (dy partitë kryesore), në jo

pak raste e kërkojnë legjitimitetin për zgjidhjen e krizës tek institucionet ndërkombëtare dhe jo tek institucionet që kanë prodhuar vetë në vite. Kjo, jo pa arsye, pasi dinë cilësinë e funksionimit të institucioneve që janë në rastin më të mirë të kapura nga të dy palët ose në rastin më të keq, vetëm nga njëra palë. Në këto kushte, zgjidhja nuk vjen nga brenda, por nga jashtë (Wittkopf,1998).

Një arsye tjetër është se legjitimiteti i komunitetit ndërkombëtar është shumë herë më i besueshëm në sytë e opinionit publik sesa ai i institucioneve lokale. Demosi lokal si burim legjitimiteti zëvendësohet me komunitetin ndërkombëtar kur ndërkohë ky i fundit nuk voton as nuk votohet nga zgjedhësit shqiptarë dhe ajo që është më e rëndësishme, qasja e tyre është e orientuar drejt respektimit të procedurave dhe institucioneve, sesa tek përmbajtja që prodhojnë këto procedura dhe vendimet që marrin institucionet në fjalë (Hurd, 1999).

Shpesh, vërehen tendenca për të implementuar praktika dhe standarde universale pa marrë parasysh kontekstin e një vendi të caktuar. Mirëpo, kjo qasje nëse do të përdornim syzet e Schmitter (1994) është e pamjaftueshme, pasi konteksti dhe roli i aktorëve politikë është shumë i rëndësishëm. Ndërsa, për autorë të tjerë, respektimi i procedurave është i domosdoshëm për vazhdimësinë e demokracisë. Bunce (1995:119)është njeri prej tyre që pranon rëndësinë e procedurave kur argumenton se "demokracia dhe kapitalizmi bazohen në të njëjtin parim që zbatohet në fusha të ndryshme të aktivitetit njerëzor: rezultate të paparashikueshme me procedura të parashikueshme. Crick (2003) gjithashtu, argumenton se demokratizimi "duhet kuptuar si një proces që bazohet më shumë tek rregullat, tek konsensusi dhe pjesëmarrja".

Autorë të tjerë si Whitehead (2002) kërkojnë më shumë vëmendje tek përmbajtja sesa tek procedura. Për ta, politika duhet të shikohet më shumë sesa një proces thjesht teknik – si vendosja e procedurave demokratike dhe metodave zgjedhore, formimi i partive politike dhe i organizatave

joqeveritare, e kështu me radhë. Në këtë mënyrë, konteksti specifik jo vetëm nuk merret parasysh por anashkalohet si një rrethanë që fsheh në fakt thelbin e problemit. Shpesh, theksi te institucionet dhe jo te proceset ka bërë të mundur që institucionet të reflektojnë fizionominë e proceseve politike dhe jo e kundërta. Nëse u referohemi ngjarjeve politike të viteve 2018 – 2020 vërehet pikërisht kjo tendencë e komunitetit ndërkombëtar i cili i mëshon më shumë aspektit institucional dhe procedural sesa kontekstit politik. Mirëpo, shpesh kjo lloj qasjeje e imponuar nga komuniteti ndërkombëtar ndaj problematikave komplekse që nxjerr në pah konteksti, e bën respektimin e procedurës apo institucionin thjesht një akt formal ku problemet mbeten aty dhe në jo pak raste përkeqësohen edhe më shumë.

2. Metodologjia

Në studim është përdorur metoda e analizës së ligjërimit kritik. Kjo metodë cilësore synon të interpretoj ligjërimin politik të pasqyruar në media dhe masmedia në kontekste të ndryshme të aktorëve të rëndësishëm politik. Burim të dhënash për analizën janë disa deklarata të përfaqësuesve të rëndësishëm të partive politike në Shqipëri si dhe të institucioneve ndërkombëtare. Si raste studimor janë përzgjedhur: djegia e mandateve nga ana e PD në 2019 dhe bojkoti i zgjedhjeve lokale në 2019. Këto dy raste shërbejnë për të kuptuar rolin e faktorit ndërkombëtar në situata krizash dhe lojën e aktorëve lokal.

Pyetja kërkimore, Çfarë ndikimi ka në procesin politik formula e sugjeruar nga faktori ndërkombëtar në situata krizash politike në Shqipëri?

Hipoiteza: Për komunitetin ndërkombëtar ka shumë rëndësi respektimi i procedurës dhe institucioneve dhe jo aq shumë garancitë që ofrojnë institucionet dhe mënyrën se si janë hartuar procedurat dhe çfarë efektesh sjellin në zbatim ato në rast krizash.

3. Analizë dhe rezultate

Pas protestës së datës 16 shkurt 2019, opozita bëri publike për herë të parë nismën për dorëzimin e mandateve parlamentare. Ky akt është konsideruar unik në historinë e parlamentarizmit në Shqipëri pas ndryshimit të regjimit politik të viteve 1990. Kjo për faktin se nuk ka ndodhur në pluralizmin shqiptar që opozita të dorëzojë në grup mandatet. Ka pasur raste të bojkotimit të parlamentit për disa jave ose muaj, por asnjë rast të dorëzimit të mandateve para afatit që përcakton kushtetuta. Fillimisht, propozimi për dorëzimin e mandateve gjeti mbështetje të gjerë tek strukturat partiake dhe militantët e opozitës, të cilët mendonin se pakënaqësitë në rritje ndaj qeverisë, protestat e studentëve ndaj dështimit të reformës në arsim, akuzat ndaj ish-Ministrit të Rendit Tahiri, përgjimet ndaj vëllait të ish-Ministrit të Rendit Xhafa, mos-hetimi nga ana e prokurorisë i dosjeve shumë të përfolura për korrupsion elektoral, si dhe rënia e besimit publik tek parlamenti e qeveria, mund të përkthetheshin në mbështetje për nismën e pazakontë të opozitës për zgjedhje të parakohshme.

Vendimi i opozitës për dorëzimin e mandateve solli reagime kundërshtuese nga përfaqësues të SHBA-së, dhe BE–së. "Dalja nga institucionet në mënyrë kolektive dhe në vitin e dytë të mandatit 4-vjeçar krijon një precedent të ri në politikën shqiptare"[50] pohoi ndër të tjera Ambasada Amerikane. Ndërsa Drejtori i Përgjithshëm për Politikat Evropiane e Fqinjësi dhe Negocimet e Zgjerimit, Christian Danielsson, deklaroi: "Sa i takon opozitës kam theksuar se vendimi i tyre për të djegur mandatet në bllok, minon integrimin në rrugën drejt BE-së. Parlamenti është shtyllë e shtetit, është motori i çdo demokracie të pjekur, duhet të ketë dialog konstruktiv në Kuvend. Ky bojkot i Kuvendit është jo produktiv dhe minon

[50]Ambasada e ShBA në Shqipëri (2019) https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shba-25/ (parë për herë të fundit, 20 mars 2020)

rrugën drejt BE-së. Pasiguria dhe destabiliteti duhet të kalohen në mënyrë urgjente."[51] Për OSBE-në, "vendimi i deputetëve të opozitës për t'u dorëhequr nga Kuvendi minon procesin demokratik ligjvënës dhe përbën një heqje dorë nga përgjegjësia e tyre për të përfaqësuar qytetarët që i kanë votuar".[52] Pra, vihet re qartë mbrojtja e linjës institucionale si dhe dekurajimi i precedentit të bojkotimit të parlamentit si mekanizëm për të realizuar zgjedhje të parakohshme.

Opozita, në kundërshtim me qëndrimin e komunitetit ndërkombëtar para dhe pas vendimit për të djegur mandatet, zgjodhi rrugën e saj. Për të mesa duket ishte më e rëndësishme sigurimi i mbështetjes së opinionit publik sesa ai i komunitetit ndërkombëtar, i cili në përgjithësi priret më shumë të ruajë status quo-në sesa të mbështesë kauza që mund të jenë edhe të drejta por që nuk parashikohet efekti i tyre në adresë të stabilitetit dhe sigurisë së vendit dhe më gjerë. Në fakt, në jo pak studime adresohen kritika ndaj qëndrimit të komunitetit ndërkombëtar, i cili, në emrin e respektimit të institucioneve dhe shmangies së precedentëve në rajon, injoron gjykimin mbi standardet demokratike në vende që aspirojnë të anëtarësohen në BE.[53] E shprehur ndryshe, predominon në qasjen e tyre "respektimi i institucioneve dhe i procedurave formale sesa cilësia e këtyre institucioneve dhe efektet që prodhojnë aspektet formale në adresë të atij substancial."[54] Në këtë rast, precedenti i parë i vendosur nga opozita në 29 vite pluralizëm politik u dekurajua nga komuniteti ndërkombëtar me arsyetimin se qeveria e zgjedhjeve të 2017 është legjitime dhe parlamentit është institucioni i vetëm ku mund të zhvillohet debati politik. Nuk përjashtohet mundësia që në këtë

[51] Gazeta Shqip (2019) https://www.gazeta-shqip.com/2019/03/07/djegia-e-mandateve-zyrtari-i-larte-i-be-se-minon-integrimin/ (parë për herë të fundit 23 mars, 2020)
[52]Gazeta Koha Jonë (2019) https://www.kohajone.com/2019/02/20/osbe-djegia-e-mandateve-trondit-themelet-e-demokracise/(parë per herë të fundit, 23 mars, 2020)
[53] Schimmelfennig, F., Engert, S.,Knobel. (2006) International Socialization in Europe European Organizations, Political Conditionality and Democratic Change, London: Palgrave Macmilan, pp. 129 - 131
[54] Ibidem, pp. 134

qëndrim të ketë influencuar si frika se precedenti i opozitës shqiptare mund të imitohet edhe nga opozitat në vende të tjera të rajonit si në Serbi apo Maqedoni të Veriut ku situata politike ishte e acaruar, ashtu edhe bindja se opozita ka një axhendë të saj politike dhe nuk ka arsye të mjaftueshme dhe bindëse që mbasi ka pranuar rezultatin e zgjedhjeve në 2017, të kërkojë dy vite më vonë ribërjen e tyre.

Menjëherë pas dorëzimit të mandateve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u vu në lëvizje për të zëvendësuar vendet bosh nga lista shumemërore. Ky akt i KQZ-së u konsiderua i paligjshëm dhe antikushtetues nga opozita. Kjo e fundit e konsideroi ilegjitim parlamentin e dalë nga zgjedhjet e 2017-s dhe procedurën e ndjekur nga KZQ si shkelje ligjore. Për nënkryetarin e PD Paloka, "E kemi bërë të qartë që askush në atë parlament nuk përfaqëson Partinë Demokratike. Për ne, ai parlament është Parlamenti i krimit dhe as PD-ja dhe asnjë forcë tjetër opozitare nuk ka më asnjë lidhje me atë parlament." Ndërsa për nënkryetarin e LSI Vasili "Opozitës i ka mbetur e vetmja rrugë, që të kthejë shtetin në vend. Parlamenti është shndërruar në një kooperativë të Partisë Socialiste".[55]

Në debatin mbi ligjshmërinë ose jo të procedurës së ndjekur nga KQZ vjen reagimi i fortë i komunitetit ndërkombëtar. Kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ambasadori Borchardt në lidhje me hapjen e procedurës nga ana e KZQ u shpreh: "Ky është një proces absolutisht normal. Hidhini një sy Kodit tuaj Zgjedhor. Ju ofrohet një vend dhe e keni ju në dorë ta pranoni apo jo. Sipas Kushtetutës suaj, deputeti nuk lidhet me asnjë mandat detyrues. Anëtarët e parlamentit janë, si në demokraci të tjera, të lirë. Ata iu përgjigjen zgjedhësve dhe ndërgjegjes së tyre. Më pas, zgjedhësi mund të

[55] Albania Free Press (2019) " Vasili: Parlamenti është shndërruar në një kooperative e Partisë Socialiste", http://albanianfreepress.al/news/2019/03/vasili-parlamenti-eshte-shnderruar-ne-nje-kooperative-te-partise-socialiste-139364/ (parë për herë të fundit, 20 mars, 2020)

vendosë për fatin e këtyre deputetëve në zgjedhjet e ardhshme."[56] Po ashtu Ambasada Amerikane u shpreh si vijon: "Ne mbështesim të gjithë ata që vazhdojnë të jenë të përfshirë në procesin demokratik në Parlament, në mënyrë që Shqipëria të vazhdojë të ecë përpara, drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian."[57] Në të njëjtën linjë ishte edhe Ambasadori i BE-së Soreca, i cili deklaroi se zëvendësimi i vendeve bosh në parlament duhej të bëhej sipas procedurës ligjore.

Mirëpo, për disa ekspertë të kodeve zgjedhore, çështja e zëvendësimit të vendeve bosh në parlament ishte i diskutueshëm nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore pasi ligjvënësit kanë parashikuar në kushtetutë vetëm rrethanat kur zëvendësohet mandati i një deputeti dhe procedurën që ndiqet për zëvendësimin e tij/ saj dhe jo rastet e lënies së mandatit nga një grup deputetesh. Sipas nenit 71 të Kushtetutës[58], mandati mbaron ose është i pavlefshëm kur deputeti nuk bën betimin; kur heq dorë nga mandati; kur vërtetohet një nga kushtet e pa zgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë me ligjin; kur mbaron mandati i Kuvendit; kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend dhe kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi. Ndërkaq, në Nenin 164 të Kodit Zgjedhor parashikohen edhe hapat për plotësimin e vakancës në rast të lënies së mandatit. Në pikën 2 të këtij neni theksohet se mandati i ndërprerë i deputetit i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike. Nëse kandidati i radhës nuk paraqitet në Kuvend brenda 30 ditëve nga njoftimi, pa shkaqe të përligjura, mandati i kalon kandidatit vijues të listës.[59]Mirëpo,

[56] Top Channel (2019) "Plotësimi I vakancave në Kuvend, Borchardt: Legjitime, mund ta votojnë reformën zgjedhore",http://top-channel.tv/2019/03/12/plotesimi-i-vakancave-ne-kuvend-borchardt-legjitimi-mund-ta-votojne-reformen-zgjedhore/ (parë për herë të fundit, 02 prill, 2020)

[57]https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shba-17/ (parë për herë të fundit, 27 mars, 2020)

[58] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998) fq. 14 https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/sq/al/al057sq.pdf

[59] Kodi Zgjedhore I Republikes së Shqipërisë, (2008) fq, 86 https://www.osce.org/files/f/documents/5/5/159511.pdf

në rastin në fjalë ne jemi në kushtet e dorëzimit në bllok të mandateve, një situatë e pangjashme dhe e pashprehur në Kodin Zgjedhor.

Pavarësisht këtij momenti që krijon hapësirë për interpretim, Kuvendi arriti të ketë 122 deputetë nga 140 në total, pasi 40 deputetë të rinj morën mandatet nga lista proporcionale e opozitës. Zëvendësimi i vendeve bosh nga lista shumemërore e opozitës krijoi një realitet të paprecedent politik pasi u krijuan dy opozita, njëra përfaqësuese por jashtë parlamentit dhe tjetra legale por jo përfaqësuese brenda parlamentit. Koncepti "përfaqësim" në këtë rast lidhet me votat e siguruara nga zgjedhjet e vitit 2017. Pjesa dërmuese e deputetëve të rinj ishin vendosur në listat shumemërore më shumë për të plotësuar një detyrim ligjor, që është ai i numrit për çdo zonë zgjedhore, sesa për të garuar. Shumë prej tyre ishin në fund të listave dhe në kushtet e një sistemi proporcional rajonal me lista të mbyllura, nuk do të ekzistonte asnjë mundësi sigurimi mandatesh për ta. Mirëpo, në krahun tjetër, pavarësisht vendimit që morën në kundërshtim me strukturat drejtuese të partive respektive, asnjërit prej tyre nuk i hiqet e drejta që të vetë-deklarohej fjala vjen përfaqësues i Partisë Demokratike apo Lëvizjes Socialiste për Integrim, pasi ishin pjesë e listave të këtyre partive dhe kishin një histori marrëdhënieje me strukturat e partive respektive. Aq më shumë, një pjesë e tyre vinin edhe nga parti të tjera politike.

Në kushtet e mungesës së opozitës de facto në parlament, deputetët e opozitës së re u promovuan në postet drejtuese në parlament, në komisione, në delegacione dhe në strukturat e tjera parlamentare. Por në krahun tjetër jeta parlamentare është shumë pak cilësore dhe funksionale. Nga një monitorim i periudhës janar - gusht 2019 i realizuar nga Instituti i Studimeve Politike me objekt vlerësimin e jetës parlamentare nënvizohet ndër të tjera: "Në shumicën e fjalimeve, deputetët kanë dominuar retorikat e konsumit mbi zhvillimet politike të ditës (98 raste), dhe vetëm në 20 raste kanë folur për problematika të zonës së tyre elektorale. Në 13 raste deputetët e kanë kërkuar fjalën për replika personale dhe në 8 raste për procedurën e

rendit të ditës."[60] Po në këtë raport thuhet: "Mbetet interesant fakti se gjatë këtij sesioni parlamentar më shumë ka pasur debate për statuset në rrjetet sociale të kryeministrit apo kryetarit të opozitës e ish kryeministrit Berisha, sesa debate mbi nivelin e varfërisë në vend dhe rrugëzgjidhjet e mundshme të saj. Interesant është gjithashtu se ndonëse PD dhe LSI nuk janë të pranishme në parlament dhe as në pushtetin lokal, mazhoranca parlamentare vijon t'i dedikojë rreth 30% të diskutimeve dhe fjalimeve të tyre replikave e sulmeve ndaj opozitës jashtë parlamentit."[61]

Pavarësisht, degradimit të parlamentit nga pikëpamja e cilësisë së debatit dhe diskutimeve, përfaqësuesit ndërkombëtarë legjitimuan opozitën e re parlamentare ose siç njihet ndryshe opozita de jure. Për ndërkombëtarët, institucioni dhe procedura ishin më të rëndësishme se pasojat që krijonte respektimi i tyre. Në shumë takime, përfaqësuesit e opozitës parlamentare u përfshinë në tryeza të organizuara nga komuniteti ndërkombëtar. Ky legjitimitet i ofruar nga ndërkombëtarët ishte një mesazh për opozitën jashtë parlamentare për të thënë se procedura e ndjekur nga KQZ për zëvendësimin e vakancave në parlament ishte legjitime. Madje, kryetarja e grupit parlamentar të opozitës së re Hajdari u bë dhe pjesë e disa tryezave që u organizuan më vonë në kuadër të reformës zgjedhore.

Akti i zëvendësimit në grup të vendeve në parlament si precedent i parë në 29 vite pluralizëm politik u pasua me precedentin e dytë, atë të mosmarrjes pjesë në zgjedhjet lokale. Sigurisht, klima parazgjedhore në këto vite pluralizmi politik ka qenë shoqëruar gjithnjë me idenë e shtyrjes së datës së zgjedhjeve por në asnjë rast me bojkotimin e tyre. Edhe në vitin më të mbrapshtë 97, zgjedhjet nuk u bojkotuan nga ndonjë subjekt politik pavarësisht mungesës së garancive për zgjedhje normale. Vendimi i opozitës

[60] ISP (2019) Parlamenti në kohë krize: Monitorim i kuvendit Janar – Gusht 2019", fq. 74 http://isp.com.al/wp-content/uploads/2019/08/ISP-RAPORT-FINAL-MONITORUES-MBI-KUVENDIT-Gusht-2019.pdf
[61] Ibidem.

për të bojkotuar zgjedhjet vendore të 30 qershorit 2019, shënon precedentin e parë në historinë e pluralizmit shqiptar. Kryetari i PD Basha e justifikoi këtë vendim me argumentin:"Ne jemi sot në një pikë përplasjeje pa kthim dhe kjo përplasje do të marrë përmasa parapolitike në qoftë se nuk zgjidhet me të vetmen rrugë që ka parashtruar opozita. Cila është rruga? Largimi i menjëhershëm i njeriut që e ka sjellë vendin në këtë pikë, në pikën që po kthen vizat për shqiptarët. Një qeveri tranzitore, roli i parë i të cilës është t'ia zgjidhë duart prokurorisë, ato çështje të hetohen, ata politikanë që janë kapur, janë përgjuar – nuk janë fantazitë e mia – duke u thënë kriminelëve mbush këtë kuti, bli këto vota, fut këtë kriminel në listën e Durrësit, – këta duhet të shkojnë para drejtësisë, nga i pari tek i fundit." Po në këtë linjë, Kryetarja e LSI Kryemadhi shprehet "Opozita po përgatitet për bllokim të qeverisë dhe rrëzimin e kryeministrit Rama, duke mos pranuar të shkojmë në zgjedhjet vendore me këtë kryeministër"[62]

Mirëpo, opozita jashtëparlamentare edhe pse vendosi të mos marrë pjesë në procesin e zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019, shprehu kërkesën që të ketë komisionerët e saj në Komisionet e Zonave të Administrimit Zgjedhor. Ata dorëzuan listën e anëtarëve në KZAZ në përputhje me Neni 29, pika 5, paragrafi 1 i Kodit Zgjedhor, por ky i fundit e rrëzoi kërkesën me argumentin se PD dhe LSI nuk janë subjekt zgjedhor, dhe duke mos pasur interesa të drejtpërdrejta në zgjedhje nuk kanë arsye për të pasur komisionerë. Në raportin e publikuar nga OSBE / ODIHR, ky vendim u konsiderua politik dhe jo-transparent. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ishte i pabalancuar politikisht, dhe partive të opozitës iu është mohuar e drejta për të pasur komisionerë për administrimin e procesit në mënyrë që strukturat e tjera KZAZ, KQV dhe GNV të ishin të balancuara politikisht."[63]Interesant është fakti se OSBE në këtë rast i referohet aspektit

[62]https://www.kohajone.com/2018/10/05/monika-kryemadhi-me-ramen-kryeminister-nuk-futemi-ne-zgjedhje-do-e-rrezojme-me-popull/

[63]http://www.55news.al/politike/item/218398-kritikat-e-forta-te-osbe-vendimet-e-kqz-te-orientuara-politikisht-dhe-jo-transparente (parë për herë të fundit, 18 mars 2020)

politik dhe jo formal të ligjit, ndërsa në rastin e zëvendësimit të vakancave në parlament i referohet aspektit formal. Pra, kur themi aspekt politik, kemi parasysh marrëveshjen politike për formulën e kompozimit të administratës zgjedhore mes partive kryesore në vend. Jo vetëm kaq, por përbërja e administratës zgjedhore shpesh i është nënshtruar frymës së kompromisit ndërmjet partive kryesore, sesa thjesht respektimit formal të kodit zgjedhor nga ana e KQZ. Nuk mungojnë rastet kur është parë se, nëse respektimi strikt i kodit zgjedhor mbi formulën e kompozimit të administratës zgjedhore ka cenuar përfaqësimin e partive politike në këto komisione, në fund ka predominuar respektimi i marrëveshjes, jo zbatimi formal i ligjit. Kësaj praktike i referohet edhe OSBE / ODIHR në konstatimin që bën në raport. Mirëpo, në këtë rast, PS bëri përjashtim nga tradita e mëparshme duke e shkelur atë.

Në këtë situatë të paqartë parazgjedhore vjen dhe vendimi i Presidentit të Republikës që më pas bëhet objekt interpretimi i disa institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai anuloi datën e zgjedhjeve që kishte dekretuar vetë për të dekretuar një datë tjetër për zhvillimin e zgjedhjeve lokale. Presidenti Meta e justifikoi këtë vendim si vijon: "…për të shtensionuar situatën dhe për të shmangur rrezikun për përshkallëzimin e paparashikueshëm të konfliktit në vend". Sipas tij "kushtet aktuale nuk mundësojnë zhvillimin e zgjedhjeve të vërteta."[64] Nuk është rasti i parë që shtyheshin zgjedhjet përtej datës së dekretimit nga ana e Presidentit; kujtojmë këtu rastin e zgjedhjeve lokale të vitit 2007. Në rastin e zgjedhjeve lokale të 2019, shtyrja ishte përtej afateve që lejon kushtetuta. Ky akt i Presidentit u bë objekt diskutimi dhe komentesh mes konstitucionalistëve nëse i lejohej Presidentit të ç'dekretonte datën që kishte dekretuar ai vetë apo jo? A ishte e mundur që Presidenti të shtynte përtej afateve kushtetuese

[64]Lapsi.al (2019) "Presidenti Meta anulloj zgjedhjet e 30 qershorit", https://lapsi.al/2019/06/08/presidenti-meta-anulon-zgjedhjet-e-30-qershorit/ (parë për herë të fundit, 24 prill 2020)

datën e zgjedhjeve? Apo në mungesë të një konsensusi të gjerë politik mbi datën e zgjedhjeve mund të vendoste Presidenti në mënyrë të njëanshme ?

Ndërkombëtarët - duke parë situatën e paqartë në të cilën u vendosen zgjedhjet vendore - intensifikuan qëndrimet dhe deklaratat për t'i mëshuar respektimit të aspektit procedural dhe ligjor dhe jo shumë shqyrtimit të garancive që ofronte qeveria për organizimin e këtyre zgjedhjeve. Përfaqësues të SHBA, OSBE, Gjermanisë, por edhe Italisë kundërshtuan si vendimin e opozitës jashtëparlamentare për të mos hyrë në zgjedhje dhe atë të mos mbajtjes së zgjedhjeve me 30 qershor nga ana e Presidentit. "Në Shqipëri kemi mbërritur në një situatë komplekse ku disa parti që të paktën në dukje kanë mbështetje të fortë politike kanë vendosur të mos futen në zgjedhje. Në këtë pikë rregullat kanë devijuar dhe nuk mund të thuhet çfarë është më logjike, të zhvillohen zgjedhje apo të shtyhen, çka do të sillte ndryshime në ligj dhe Kushtetutë." Përmes një deklarate zyrtare të lëshuar nga deputeti i Parlamentit gjerman, Mark Hauptmann, në emër të koalicionit CDU-CSU, theksohet: "Si grup parlamentar, ne nuk kemi të drejtë të kërkojmë shtyrjen e zgjedhjeve në një shtet të pavarur. De facto, kjo do të mund të konsiderohej si një kërkesë për të ndryshuar Kushtetutën e Shqipërisë dhe ligjin zgjedhor të vendit".[65] Në të njëjtën linjë kreu i OSBE, Lajcak deklaron: "Është me rëndësi që zgjedhjet të mbahen më 30 qershor, duhet të kapërcehen dallimet, të punohet për vendin, problemet të debatohen në parlament dhe është tepër me rëndësi të forcohen institucionet demokratike". Kjo linjë u mbajt edhe nga kreu i delegacionit të Kongresit Amerikan Damon Wilson i cili deklaroi se "është kundër bojkotit të zgjedhjeve nga ana e opozitës, ndërsa bëri apel që data e zgjedhjeve të mos ndryshojë, duke kërkuar që ato të mbahen në kohën e caktuar."

I gjithë faktori ndërkombëtar përkundrejt garës pa kundërshtarë politikë - ku në "31 bashki garojnë vetëm kandidatët e Partisë Socialiste, ndërsa në 30 bashki të tjera ka më shumë se një kandidat; 12 prej të cilëve janë të

[65] https://sot.com.al/politike/pd-lsi-ne-lufte-me-nderkombetaret-shba-osbe-gjermania-e-italia-rrezojne-planet-shtyrjen-e

pavarur, 22 i takonin partisë Bindja Demokratike ndërsa tre kandidatë i përkasin një koalicioni të emëruar "Shpresa për Ndryshim"[66] - mbrojti variantin e respektimit të procedurës dhe ligjit, pra, zhvillimit të zgjedhjeve me 30 qershor. Për të, precedenti i shtyrjes së zgjedhjeve në kundërshtim me afatet që parashikon kushtetuta sa herë që mund ta kërkonte këtë gjë një force e madhe politike, ishte më i rrezikshëm sesa gara pa kundërshtarë politikë dhe administrimi i shumicës së njësive vendore nga një force politike nesër. Pra, si të thuash, garancitë për zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe përkeqësimi i pushtetit lokal nesër ishte më pak i rëndësishëm se sa mosrespektimi i procedurës dhe ligjit.

Pavarësisht këtij reagimi të komunitetit ndërkombëtar për opozitën jashtë parlamentare, mbajtja e zgjedhjeve lokale në mungesë të saj dhe aktit të Presidentit për anulimin e tyre më 30 qershor e bënin të pamundur mbajtjen e zgjedhjeve, qoftë politikisht dhe juridikisht. Përfaqësues të partive të koalicionit opozitar jashtë parlamentit deklaruan: "...do të ketë akte masive të mosbindjes civile të qytetarëve dhe bllokim të akseve kombëtare kryesore për një kohë të caktuar. Zgjedhjet e 30 qershorit nuk do të zhvillohen."[67] Opozita jashtëparlamentare, në pamundësi për të bindur komunitetin ndërkombëtar për shtyrjen e zgjedhjeve në mungesë të garancive nga ana e mazhorancës, zgjodhi si strategji, variantin e sensibilizimit të opinionin publik për të penguar mosrealizimin e zgjedhjeve pa garë dhe pa garancitë e nevojshme për zgjedhje të lira dhe të ndershme. Ndërsa opozita parlamentare ishte për zhvillimin e tyre më 30 qershor.

Situata politike u tensionua aq shumë sa nuk munguan reagimet e shoqërisë civile. Shoqata "Tirana", e përberë nga intelektualë me reputacion në vend, reagoi nëpërmjet një deklarate: "Vendi rrezikon konflikt civil të

[66] Ibidem
[67] DW (2019) "Koalicioni opozitar në Tiranë – jo zgjedhjeve fals", https://www.dw.com/sq/koalicioni-opozitar-n%C3%AB-tiran%C3%AB-jo-zgjedhjeve-false/a-48455733 (parë për herë të fundit, 20 shkurt, 2020)

pashmangshëm, ndaj palët duhet t'i japin fund krizës politike."[68] Po ashtu, Instituti Shqiptar i Shkencës, Instituti i Studimeve Politike dhe Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Ndërmjetësim bënë thirrje për "ndërgjegjësimin, marrjen e masave dhe parandalimin e një krize të rëndë politike, ekonomike e sociale që kërcënon të sotmen dhe të ardhmen tonë. Sipas tyre, nëse kriza vazhdon, mund të dëmtojë rëndë ekonominë, të përshpejtojë ikjen masive, të rrisë varfërinë, përkeqësojë skemën e pensioneve dhe të rrezikojë stabilitetin e financave publike."[69] Po ashtu intelektualë të ndryshëm bënin thirrje për skenarë të ngjashëm si ato të 97-ës, nëse zgjedhjet zhvillohen më 30 qershor pa pjesëmarrjen e opozitës jashtëparlamentare. Mirëpo, një ditë para se të zhvilloheshin zgjedhjet vjen edhe reagimi i fortë nga zv/ndihmës Sekretari i Shtetit për Evropën Matthew Palmer. Ai ndër të tjera bëri thirrje për shmangien e dhunës më 30 qershor, duke shtuar se "udhëheqësit e partive do të mbajnë përgjegjësi për dhunën e përkrahësve të tyre. Pas zgjedhjeve, do të ketë mundësi që të krijohet Gjykata Kushtetuese, është plotësisht e mundur që Gjykata të vendosë që zgjedhjet duhen përsëritur, por kjo i takon Gjykatës ta vendosë dhe jo politikanëve të veçantë."[70] Ky qëndrim i Shteteve të Bashkuara të Amerikës i bërë publik një ditë para se të zhvilloheshin zgjedhjet u kuptua si kërcënim për opozitën parlamentare apo cilindo që do të tentonte të bllokonte zhvillimin e zgjedhjeve me 30 qershor.

[68]Vizion Plus TV (2019) " Shoqata " Tirana" prememorie klasës politike për zgjidhjen e krizës", https://www.vizionplus.tv/shoqata-tirana-promemorie-klases-politike-per-zgjidhjen-e-krizes/ (parë për herë të fundit, 19 prill, 2020)

[69]Instituti I Studimeve Politike (2019) " Deklarata e Shoqërisë Civile Shqiptare mbi krizën politike dhe propozime për zgjedhjem e saj", https://isp.com.al/index.php/2019/05/08/shoqeria-civile-deklarate-per-krizen-dhe-rrugezgjidhjet-efektive-te-saj/ (parë për herë të fundit, 18 shkurt, 2020)

[70]Agjensia Telegrafike Shqiptare (2019)" Pjesemarrja dhe rezultati në zgjedhjet e 30 qershorit ka tejkaluar cdo pritshmëri", https://ata.gov.al/2019/07/08/pjesemarrja-dhe-rezultati-ne-zgjedhjet-e-30-qershorit-ka-tejkaluar-cdo-pritshmeri/ (parë për herë të fundit, 24 prill, 2020)

Opozita jashtëparlamentare, pas kësaj deklarate ndryshoi strategjinë; nga bllokim i qendrave të votimit siç kishte deklaruar, në dekurajim të pjesëmarrjes në zgjedhje dhe ironizim të procesit zgjedhor. Dita e zgjedhjeve nuk u shoqërua me incidente siç ishte premtuar ditë dhe muaj më parë, por opozita me mbështetësit e saj ironizuan në ambientet jashtë qendrave të votimit të gjithë procesit zgjedhor duke e konsideruar atë një farsë tipike për regjime diktatoriale. Sloganet, sfondi muzikor, simpatizantë të opozitës të veshur si dikur në regjimin totalitar, shoqëruan ditën e zgjedhjeve. Për një pjesë të analistëve pranë të majtës kjo sjellje e opozitës u konsiderua si një strategji e kamufluar për të dekurajuar shkallën e pjesëmarrjes në zgjedhje si dhe deligjitimimin e tyre.

Çështja e pjesëmarrjes në zgjedhje u bë objekt analize, monitorimi dhe komentesh për të dy krahët politikë. Pjesëmarrja u përdor si indikator për të kuptuar mbështetjen e votuesve ndaj aksionit opozitar dhe në krahun tjetër, qeveria për të legjitimuar shkallën e mbështetjes të ngjashme me atë të zgjedhjeve të përgjithshme të 2017. Qeveria duke pasur përfaqësuesit e saj në të gjithë administratën zgjedhore sidomos në KZAZ dhe QVN (jo pa arsye KQZ refuzoi propozimin e PD dhe LSI për komisioner në KZAZ dhe QNV), deklaronte shkallë të lartë pjesëmarrjeje, ndërsa opozita deklaronte për të kundërtën. Sipas shifrave zyrtare të KQZ numri i votuesve ishte 771.863, ndërsa sipas pretendimeve të Partisë Demokratike rezultonte të ishte 534 mije 528 votues, ose 15.2 %."[71] Secila forcë politike jepte variantin e saj zyrtar të shkallës së pjesëmarrjes, pasi KQZ duke qenë e përfaqësuar vetëm nga një krah politik ishte e pabesueshme për të dhënat që publikonte në sytë e opozitës, por në disa raste edhe kaotike në të dhënat që publikonte. Në lidhje me rolin e KQZ-së në raportin përfundimtar të OSBE ODHIR thuhet: "Ekuilibri politik i parashikuar me ligj brenda administratës zgjedhore nuk u arrit për shkak të refuzimit të partive kryesore opozitare për

[71] Shqiptarja.com (2019) https://shqiptarja.com/lajm/opozita-reagon-akuza-pwr-blerje-tw-votave-dhe-presione-ndaj-administratws-pwr-tw-votuar (parë për herë të fundit, 13 prill 2020)

të emëruar komisionerët e tyre dhe interpretimit më pas të KQZ-së se vetëm ato parti që marrin pjesë në zgjedhje mund të përfaqësohen në administratën zgjedhore."[72] Po ashtu në raportin e Komunitetit Shqiptar të Helsinkit thuhet: "… është i diskutueshëm vendimi i KQZ-së nr.127, dt. 04.04.2019, i jep disa këtij organi tagra të cilat nuk i janë akorduar në Kod Zgjedhor, për të plotësuar vakancat e krijuara në KQV, duke i propozuar KZAZ-së listat e shtetasve që mund të emërohen anëtarë/sekretarë të KQV/GNV."[73]

Kriza e legjitimitetit të zgjedhjeve lokale thellohet edhe më shumë me shkarkimin nga ana e KQZ-së e dy kryetarëve bashkiakë të sapo zgjedhur, në Shkodër dhe në Vorë, pasi nuk kishin deklaruar në formularin e dekriminalizimit faktin që ishin dënuar më parë. Në këto kushte, opozita jashtëparlamentare iu rikthye akuzave për kriminalizim të qeverisë dhe kapjen e prokurorisë që ende nuk zbardh krimin elektoral në zgjedhjet e zhvilluara në Shijak dhe në Dibër, specifikisht, dosjet 339 dhe 184. Kjo sipas tyre është një arsye më shumë për të faktuar kriminalizimin elektoral të këtyre zgjedhjeve dhe mungesën e garancive nga ana e qeverisë për të organizuar zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Mbas shpalljes së rezultatit nga ana e KQZ, opozita jo parlamentare deklaroi se nuk njeh zgjedhjet e 30 qershorit dhe ato do të ribëhen. Gjithashtu, opozita ripërsëriti kërkesën e bërë publike gjatë muajve të mëparshëm se ulja në tryezë për të zgjidhur krizën dhe qeveria tranzitore mundëson realizimin e zgjedhjeve normale në këtë vend. Po ashtu, Presidenti i Republikës Meta u shpreh: "Zgjedhjet e 30 qershorit nuk ekzistojnë ligjërisht, 13 tetori është mundësia për zgjidhjen e krizës."[74]

[72] ODIHR (2019) Raporti përfundimtarë i misionit ODIHR për zgjedhjet vendore 2019.
[73] KShH (2019) RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE KONKLUZIONET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DT. 30 QERSHOR 2019, fq.6
[74]Top Channel (2019) " Anullimi i zgjedhjeve të 20 qershorit" http://ata.gov.al/2019/07/08/meta-zgjedhjet-e-30-qershorit-nuk-ekzistojne-ligjerisht-13-tetori-mundesi-per-zgjidhjen-e-krizes/ (parë për herë të fundit, 20 maj 2020)

I menjëhershëm ishte reagimi i komunitetit ndërkombëtar i cili legjitimoi zgjedhjet, pavarësisht mangësive që evidentoheshin në këto zgjedhje nga pikëpamja e përfaqësimit politik, zhbalancimit të administrimit të procesit zgjedhor, klimës së tensionuar të zhvillimit të fushatës, mangësive të evidentuara në raportin paraprak të OSBE – ODHIR etj,. Ambasada Amerikane në një deklaratë për shtyp tha:"Ne nxisim udhëheqësit politikë që, pas zgjedhjeve të së dielës, të rikthejnë vëmendjen e tyre në forcimin e institucioneve demokratike shqiptare dhe zbatimin e ligjit, përfshirë edhe ecjen përpara me ngritjen e një Gjykate Kushtetuese të drejtuar nga gjykatës të cilët e kanë kaluar vetingun. Miratimi i reformave zgjedhore dhe zbatimi i reformës në drejtësi janë thelbësore për aspiratat evropiane të Shqipërisë dhe për ngritjen e demokracisë së fortë që i shërben të gjithë shqiptarëve."[75] Po ashtu, Zv/ ndihmës Sekretari Amerikan i Shtetit, Matthew Palmer në një prononcim për 'VOA'-n u shpreh: "Ata që dëshirojnë të sfidojnë rezultatin e zgjedhjeve, mund të presin Gjykatën Kushtetuese, e cila shpresojmë do të ngrihet së shpejti, me gjykatës të cilët kanë kaluar një proces rigoroz vettingu."[76]Ndërsa Maja Koçijanciç tha: "Zgjedhjet lokale të mbajtura të dielën e 30 qershorit u zhvilluan në një kontekst të ndarjes politike, por në një mënyrë përgjithësisht të qetë e të rregullt. Ne morëm parasysh të gjitha vërejtjet paraprake të bëra nga Shefi i Misionit të Vëzhgimit të Zgjedhjeve të OSBE / ODIHR. Të gjitha institucionet shqiptare dhe udhëheqësit politikë tani duhet të përqendrojnë përpjekjet e tyre në vijueshmërinë e zbatimit të procesit të reformës, duke përfshirë rinisjen e reformës së iniciuar më parë të legjislacionit zgjedhor për të adresuar rekomandimet e ODIHR-it."[77]

[75] Ambasada e ShBA në Shqipëri (2019) https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shteteve-te-bashkuara-te-amerikes-12/ (parë për herë të fundit, 20 prill 2020)
[76] Ibidem,
[77]ABC News (2019) https://abcnews.al/zgjedhjet-e-30-qershorit-reagon-be-ja-dhe-shba-ja/ (parë për herë të fundit 26 prill 2020)

4. Konkluzioni

Dy precedentët e mësipërm u sollën për të konfirmuar tezen se për komunitetin ndërkombëtar ka shumë rëndësi respektimi i procedurës dhe institucioneve dhe jo aq shumë garancitë që ofrojnë institucionet dhe mënyrën se si janë hartuar procedurat dhe çfarë efektesh sjellin në zbatim ato. Jo pak raste, theksi tek respektimi i institucioneve dhe i procedurave ka prodhuar të njëjtin realitet, madje ka rutinizuar dhe kalcifikuar vetë institucionet dhe procedurat, duke krijuar idenë e panevojshmërisë për t'i ndryshuar ato, pasi përsërisin të njëjtin realitet politik. Aspekti formal nuk ka kontribuar në përmirësimin e aspektit substancial. Për Kajsiun, "ky është edhe një tipar i përbashkët i faktorit ndërkombëtar në proceset e demokratizimit shqiptar; neglizhimi apo reduktimi i procesit politik. Në rastin më të keq politika neglizhohet pasi procesi i demokratizimit nënkupton një rrugëtim drejtvizor nga më pak në më shumë demokraci, apo nga institucionet e dobëta tek ato të konsoliduara. Në rastin më të mirë procesi politik reduktohet tek marrëdhënia mes institucioneve apo individëve, çka prodhon narrativa statistikore të zgjedhjeve apo aktive politike, por pa hedhur dritë mbi shkaqet e dinamikës politike. Në të dyja rastet politika shikohet si një faktor ekzogjen. Ajo është produkt i marrëdhënieve institucionale, kulturore apo individuale dhe jo procesi që në fakt i prodhon këta faktorë, ndërsa edhe formësohet prej tyre."[78]

Laclau dhe Mouffe[79] me të drejtë mbrojnë tezën se forcimi i institucioneve apo i shtetit të së drejtës janë procese thellësisht politike dhe si të tilla janë produkte dhe jo burime të procesit politik. Për sa kohë që procese të tilla do të reduktohen tek zbatimi teknik i një modeli të caktuar, ato do të prodhojnë

[78] Kajsiu, B. (2006) Ndërkombëtarët dhe demokratizimi:" Demokratizimi pa politikë: Baza konceptuale e qasjes së ndërkombëtarëve, fq. 26 Polis 4, UETPress.
[79] Laclau and Mouffe (1996) Hegemony and Socialist Strategy: Towards a Radical Democratic Politics, London, New York: Verso, pp. 153

institucione të brishta dhe të paafta për të kanalizuar dinamikën politike. Në kushte të tilla, kjo dinamikë jo vetëm që do të zhvillohet jashtë, por edhe kundër institucioneve, duke riprodhuar pikërisht ato fenomene që projektet demokratike përpiqen t'i eliminojnë. Fatkeqësisht, diçka e tillë ka ndodhur, po ndodh dhe do të vazhdojë të ndodhë në Shqipëri, për sa kohë që politika nuk shihet si pjesë e zgjidhjes, por pjesë e problemit në proceset demokratizuese.

Bibliografia

- Althusser, L. (1995/2014). On the reproduction of capitalism: Ideology and ideological state apparatuses, trans. G.M. Goshgarian (New York: Verso).
- Agjensia Telegrafike Shqiptare (2019)" pjesëmarrja dhe rezultati në zgjedhjet e 30 qershorit ka tejkaluar çdo pritshmëri", https://ata.gov.al/2019/07/08/pjesemarrja-dhe-rezultati-ne-zgjedhjet-e-30-qershorit-ka-tejkaluar-cdo-pritshmeri/ (parë për herë të fundit, 24 prill, 2020)
- Bunce, V. (1995) "Should Transitologists Be Grounded?", Slavic Review, 54:1.
- Calise, M.(1994) Particracy, The Italian Particracy: Beyond President and Parliament, Which Work
- Best?, Political Science Quarterly Vol. 109, No. 3.
- Eugene R. Wittkopf (eds.) The Global Agenda: Issues and Perspectives. New York: McGrawHill.
- Hurd, I." Legitimacy and Authority in International Politics, Spring Vol. 53, No. 2 Spring,

- IDM (2019) Sondazhi i opinionit publik 2019 besimi ne qeverisje, Tirane.
- Instituti i Studimeve Politike (2019) " Deklarata e Shoqërisë Civile Shqiptare mbi krizën politike dhe propozime për zgjedhjen e saj", https://isp.com.al/index.php/2019/05/08/shoqeria-civile-deklarate-per-krizen-dhe-rrugezgjidhjet-efektive-te-saj/ (parë për herë të fundit, 18 shkurt, 2020)
- Kushtetuta e Republikës sëShqipërisë (1998) https://www.wipo.int/edocs/lexdocs/laws/sq/al/al057sq.pdf
- Kodi Zgjedhore I Republikes së Shqipërisë, (2008) https://www.osce.org/files/f/documents/5/5/159511.pdf
- KShH (2019) RAPORT PËRFUNDIMTAR MBI GJETJET DHE KONKLUZIONET E MONITORIMIT TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DT. 30 QERSHOR.
- Gallup (2019) https://news.gallup.com/poll/225788/countries-disapproving-leadership-triples-2017.aspx
- ODIHR (2019) Raporti përfundimtarë i misionit ODIHR për zgjedhjet vendore 2019.
- Mair, P. (2002) Populist Demokracy vs Party Demokracy, New York; Palgrave
- Russell, J., Cohn, R. (2013) Particracy, London, Routledge
- Ragazzoni, D. (2019) Particracy, New York, Routledge.
- Schmidt, M. (2012) Teoritë e Demokracisë, Tiranë: Botart, fq,360
- Schmitter, P. & Terry, K. (1994) "The Conceptual Travels of Transitologists and Considologists:
- Schimmelfennig, F., Engert, S.,Knobel. (2006) International Socialization in Europe European Organizations, Political Conditionality

and Democratic Change, London: Palgrave Macmilan, pp. 129 – 131 How Far to the East Should They Attempt to Go?" Slavic Review, 53:1, pp 178 - 190

- Whitehead, W. (2002) Democratization: Theory and Practice, (Oxford: Oxford University Press).

- Ambasada e ShBA në Shqipëri (2019) https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shba-25/ (parë për herë të fundit, 20 mars 2020)

- Gazeta Shqip (2019) https://www.gazeta-shqip.com/2019/03/07/djegia-e-mandateve-zyrtari-i-larte-i-be-se-minon-integrimin/ (parë për herë të fundit 23 mars, 2020)

- Gazeta Koha Jonë (2019) https://www.kohajone.com/2019/02/20/osbe-djegia-e-mandateve-trondit-themelet-e-demokracise/(parë per herë të fundit, 23 mars, 2020)

- Albania Free Press (2019) " Vasili: Parlamenti është shndërruar në një kooperative e Partisë Socialiste", http://albanianfreepress.al/news/2019/03/vasili-parlamenti-eshte-shnderruar-ne-nje-kooperative-te-partise-socialiste-139364/ (parë për herë të fundit, 20 mars, 2020)

- Top Channel (2019) "Plotësimi i vakancave në Kuvend, Borchardt: Legjitime, mund ta votojnë reformën zgjedhore", http://top-channel.tv/2019/03/12/plotesimi-i-vakancave-ne-kuvend-borchardt-legjitimi-mund-ta-votojne-reformen-zgjedhore/ (parë për herë të fundit, 02 prill, 2020)

- https://al.usembassy.gov/sq/deklarate-e-ambasades-se-shba-17/ (parë për herë të fundit, 27 mars, 2020)

- Lapsi.al (2019) "Presidenti Meta anulloi zgjedhjet e 30 qershorit", https://lapsi.al/2019/06/08/presidenti-meta-anulon-zgjedhjet-e-30-qershorit/ (parë për herë të fundit, 24 prill 2020)

- DW (2019) "Koalicioni opozitar në Tiranë – jo zgjedhjeve fals", https://www.dw.com/sq/koalicioni-opozitar-n%C3%AB-tiran%C3%AB-jo-zgjedhjeve-false/a-48455733 (parë për herë të fundit, 20 shkurt, 2020)

- Vizion Plus TV (2019) " Shoqata " Tirana" prememorie klasës politike për zgjidhjen e krizës", https://www.vizionplus.tv/shoqata-tirana-promemorie-klases-politike-per-zgjidhjen-e-krizes/ (parë për herë të fundit, 19 prill, 2020)

- Shqiptarja.com (2019) https://shqiptarja.com/lajm/opozita-reagon-akuza-pwr-blerje-tw-votave-dhe-presione-ndaj-administratws-pwr-tw-votuar(parë për herë të fundit, 13 prill 2020)

- ODIHR (2019) Raporti përfundimtarë i misionit ODIHR për zgjedhjet vendore 2019.

- Top Channel (2019) " Anullimi i zgjedhjeve të 20 qershorit" http://ata.gov.al/2019/07/08/meta-zgjedhjet-e-30-qershorit-nuk-ekzistojne-ligjerisht-13-tetori-mundesi-per-zgjidhjen-e-krizes/ (parë për herë të fundit, 20 maj 2020)

Qasjet Teorike në Studimin e Lëvizjeve Sociale[80]

Dr. Gilda Hoxha

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

gildahoxha@umsh.edu.al

Abstract

The article aims to identify the theoretical framework in the study of social movements, participation through non-conventional forms of participation, under the systems of liberal democracy. The relationships between the theoretical approaches of 'social movements' and the 'decision-making process' and 'democratization process' will to be analyzed from three perspectives: a- in terms of the national, political and social context that conditions the purpose and strategies of social movements; b- in terms of the efforts of previous governments to change social and political conditions; c- in terms of being part of decision-making through unconventional forms of participation. The characteristics of social movements will be addressed based on the question: "What is the role of social movements in the transition process, in relation to the democratization process?" Analyzing the theoretical framework of social movements, it can be observed how social movements act and interact with different factors, such as economic, human and technical, having a limited role during the transition process towards the process of democratization and consolidation of institutions, through non-conventional forms of citizen participation in public life.

Keywords: social movements, theoretical approach, democratization

[80] Shënim: artikulli është pjesë e kuadrit teorik të studimit tim të doktoraturës.

Abstrakt

Artikulli ka për qëllim të identifikojë kuadrit teorik në studimin e lëvizjeve sociale, pjesëmarrjen nëpërmjet formave jo-konvencionale të pjesëmarrjes, nën sistemet e demokracisë liberale. Marrëdhëniet midis qasjeve teorike të 'lëvizjeve sociale' dhe 'procesit të vendimmarrjes' e 'procesit të demokratizimit' do të analizohen nga tri këndvështrime: a- në aspektin e kontekstit nacional, politik dhe social që kushtëzojnë qëllimin dhe strategjitë e lëvizjeve sociale; b- në aspektin e përpjekjeve të eltitave të mëparshme për të ndryshuar kushtet sociale dhe politike; c- në aspektin e të qenit pjesë e vendimmarrjes me anë të formave jokonvencionale të pjesëmarrjes. Tiparet e lëvizjeve sociale do të trajtohen në bazë të pyetjes: "Cili është roli i lëvizjeve sociale në procesin e tranzicionit, në raport me procesin e demokratizimit?"Duke analizuar kuadrin teorik të lëvizjeve sociale, mund të vihet re mënyra se si lëvizjet sociale veprojnë dhe bashkëveprojnë me faktorë të ndryshëm, si ai ekonomik, njerëzor dhe teknik, duke pasur një rol të limituar përgjatë procesit të tranzicionit drejt procesit të demokratizimit dhe konsolidimit të institucioneve, nëpërmjet formave jo konvencionale të pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën publike.

Fjalë kyçe: lëvizje sociale, qasje teorike, demokratizim

1. Hyrje

Përfshirja e qytetarëve në politikëbërje dhe në vendimmarrje nëpërmjet formave konvencionale të pjesëmarrjes, si për shembull të votuarit, apo duke përdorur format jokonvencionale, si protestat, përbën një nga fenomenet më të studiuara në shkencat sociale dhe veçanërisht në shkencat politike e sociologji. Orientimet dhe mënyrat e të vepruarit si edhe sjelljet kolektive nga qytetarët, përgjithësisht, janë të përcaktuara nga kufiri që

vendos politika nëpërmjet proceseve legjitime të pjesëmarrjes, si procesi zgjedhor, dhe shihen si të pranueshme, duke përcaktuar kështu hapësirën mbi të cilën elita politike merr vendimet për gjetjen e zgjidhjes ndaj problemeve, të politikave publike apo dhe të drejtën për përfaqësim. Bazuar në studimet e kryera më parë, mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje dhe në politikëbërje, si pjesëmarrja në politikë, angazhimi civil, pjesëmarrja në protestë apo angazhimi në lëvizjet sociale-politike dhe format e tjera të sjelljes kolektive, nënvizojnë faktin se janë tipare të demokracive të konsoliduara të Perëndimit.

Në një krahasim paralel me Europën Qendrore dhe atë Lindore, te këto të fundit vërehet një angazhim jo shumë i lartë ndaj pjesëmarrjes në politikëbërje dhe sidomos nëpërmjet formave të ndryshme të sjelljes kolektive. Megjithatë, në dekadat e fundit procesi i zhvillimit dhe i konsolidimit të demokracisë në Europën Lindore dhe Qendrore, elitat politike dhe rendi i politikëbërjes janë sfiduar nga format e ndryshme të sjelljes kolektive, të cilat shpeshherë etiketohen si lëvizje sociale dhe mobilizim nga poshtë, pra nga qytetarët.

Në këtë linjë, studimet mbi sjelljen kolektive dhe të mobilizimit nga poshtë janë kthyer në fokus të studiuesve, tashmë jo vetëm si tipar i demokracive të Perëndimit, por edhe i demokracive të reja[81]. Mobilizimi nga poshtë, pra nga qytetarët, njihet nga studiuesit si lëvizje sociale. Lëvizjet sociale, për vendimmarrësit politikë, kuptohen si sfida të qëndrueshme dhe afatgjata, nga ku qëllimi i mobilizimit të lëvizjeve sociale është të arrihen ndryshime shoqërore (Hooghe, 2005) dhe në raste të caktuara, edhe ndryshime politike. Studiuesit më në zë të lëvizjeve sociale, si Donatella della Porta, Mario Dian apo dhe David

Snow (Snow, Prota, Andermans, & McAdams, 2013) janë të mendimit se lëvizjet sociale nuk duhet të identifikohen ekskluzivisht me organizata apo

forma të tjera të organizimit joinstitucional, sepse ato janë të mbështetura nga faktorë të tjerë të kontrollit, që mund të dëmtojnë qëllimin fillestar të lëvizjes. Të tilla mund të jenë: veprimet individuale, manifestimet kulturore, opinionet publike apo të tjera elemente, të cilat cilësohen pjesë të ndryshimit dhe të ndërveprimit social dhe politik. Ndryshimet sociale janë vendimtare për të bërë ndryshimin mes së kaluarës dhe së ardhmes në një shoqëri (Ferguson, 1971). Të jesh pjesë e lëvizjeve sociale konsiderohet si një akt racional dhe formë pjesëmarrjeje, që është në harmoni me përhapjen e një kulture politike dhe demokratike (Hooghe, 2005).

2. Metodologjia

Studimi i lëvizjeve sociale konsiderohet si një disiplinë e re dhe e zhvilluar vetëm në dekadat e fundit. Të studiosh lëvizjeve sociale, do të thotë të përballesh me një disiplinë komplekse e cila mund të gjejë hapësira studimore në shumë disiplina të shkencave sociale. Ndaj nuk është e rastësishme që koncepti i lëvizjeve sociale, mund të gjendet nga studimet sociologjike deri tek ato të shkencave politike apo në studimet psikologjike. Për këtë arsye, studiuesit si Donatella della Porta, Mario Dian e Sidney Tarroë kanë tentuar të zhvendosin vëmendjen e studimit të tyre më së shumti te mënyra (how to do it) (Porta, 2014), pra se si lëvizjet sociale do të studiohen.

Metodat, mbledhja e të dhënave, analizimi dhe argumentimi i tyre mbi studimet e lëvizjeve të reja sociale-politike mund të konsiderohen të shumta dhe dallohen nga njëra-tjetra për secilin rast. Duhet theksuar se është e vështirë të ndërtosh një bazë teorike mbi lëvizjet e reja sociale-politike dhe më pas të aplikohet për të gjitha rastet, pasi veçantia dhe arsyet mbi të cilat ato lindin dhe zhvillohen ndryshon nga shoqëria, vendi apo dhe kushtet ku ato marrin jetë. Referimi metodologjik për studimin e lëvizjeve të reja sociale-politike në Shqipëri për periudhën 1992-2015 është bazuar në librin "Methodologjical Practicies in Social Movements Research" nga Donatella Della Porta si dhe duke ndjekur qasjen

bashkëkohore të racionalizmit kritik, në kombinim me metodologjinë sasiore dhe cilësore.

Gjithashtu, është e domosdoshme të parashtrohen disa nga arsyet pse kombinimi metodologjik, kryesisht ndërmjet metodave sasiore dhe cilësore të kërkimit, është i domosdoshëm për studimin e lëvizjeve sociale. Së pari, mungesa e të dhënave specifike mbi të cilat studiuesi i e lëvizjeve sociale do të duhet të punojë. Të dhënat mbi e lëvizjeve sociale, përgjithësisht, nuk ruhen kur ata ndodhin ose studimet e mëparshme nuk kanë pasur të njëjtin qëllim studimi me lëvizjet e reja sociale-politike. Për të konkretizuar këtë mund të sillen ndër mend shembujt e studimeve mbi sjelljen kolektive të grupeve të interesit, nga ku studiuesit e e lëvizjeve sociale do duhet të bëjnë dallimin mes tyre (Klandermans & Staggenborg, 2002). Së dyti, vihet re që studiuesit e lëvizjeve sociale kanë për tendencë t'i analizojnë lëvizjet bazuar te preferencat e tyre dhe në këtë mënyrë përjashtojnë të tjerat, duke lënë kështu kuadrin teorik dhe analizimin e të dhënave të paplotësuar. Së treti, duke qenë se studimi i lëvizjeve të reja sociale-politike është më së shumti i orientuar drejt problemit, këto të fundit kanë qenë gjithmonë të hapura ndaj teknikave të ndryshme të metodave të kërkimit shkencor.

3. Kuadri teorik

Perceptimi i lëvizjeve sociale mund të shihet edhe si një sfidë e qëndrueshme ndaj vendimmarrjes politike. Megjithatë, rezultati i ndryshimit social vjen si pasojë e disa faktorëve kryesorë kontribues, për shembull frakturat sociale. Një pjesë e studiuesve argumentojnë se lëvizjet sociale nuk duhet të identifikohen ekskluzivisht me organizatat apo organizma të tjerë socialë, pasi ato shpesh janë të mbështetura nga faktorë të tjerë të kontrollit që mund të zhbëjnë qëllimin e lëvizjes, siç mund të jenë veprimet individuale, manifestimet kulturore, liderët e opinionit publik etj. Gjithsesi, mund të thuhet se nuk ka rëndësi se për çfarë ndodh ndryshimi social, por

është lëvizja në vetvete ajo që e shkakton atë. Për këtë arsye mund të sugjerohet se, për

aq kohë sa ndryshimi është më progresiv se më parë, lëvizjet sociale janë vendimtare për të bërë dallimin mes së shkuarës dhe së ardhmes së shoqërisë.

Mund të theksohet se ndryshimet e mëdha politike dhe sociale të shekullit XIX dhe XX erdhën si pasojë e veprimtarisë dhe mobilizimit të lëvizjeve sociale. Për ta konkretizuar këtë mund të sjellim ndërmend lëvizjet për të drejtat civile, lëvizjet feministe, lëvizjet ambientaliste apo protestat kundër regjimeve autoritare në Europën Qendrore dhe Lindore. Të qenët pjesë e lëvizjeve sociale është parë si një veprim racional dhe një formë pjesëmarrjeje që është në harmoni me përhapjen e një kulture politike demokratike (McAdam & Snow, 2009). Në këtë këndvështrim, studiuesit i konsiderojnë lëvizjet sociale si mjet të nevojshëm të ndryshimeve sociale dhe të një procesi të mëtejshëm të demokratizimit. Pjesëmarrja në lëvizjet sociale tashmë është pranuar plotësisht si një pjesë integruese e repertorit të veprimit politik të qytetarëve të zakonshëm (McAdam & Snow, 2009).

Kështu, një përkufizim konciz dhe i dobishëm i lëvizjeve sociale jepet duke i parë ato si sfida kolektive, bazuar në qëllime të përbashkëta dhe ndërgjegjësuese, në raport me elitat, kundërshtarët dhe autoritetet (Tarrow, 1998). Lëvizjet sociale mund të shfaqen në forma të ndryshme, për shembull, lëvizjet për të drejtat civile, lëvizjet feministe apo edhe lëvizjet ambientaliste. Autorë të ndryshëm, si Marco Giugni, Doug McAdam and Charles Tilly, listojnë disa forma të pjesëmarrjes që lëvizjet sociale përdorin. Ndër to mund të përmendim: bojkotet, marshimet, protestat, demonstratat etj. Kjo nënkupton se lëvizjet sociale jo vetëm nxisin demokratizimin, por edhe janë thelbësore për demokracinë liberale.

Për më tepër, rezultatet e studimeve thekson si rolin e rëndësishëm të individit ashtu edhe rolin e lëvizjeve sociale në një shoqëri. Për t'iu referuar

Ferguson-it, i cili thotë: “Edhe pse grupet e advokimit janë aktorë të jashtëm të politikës dhe aktivistët janë sipërmarrës të këtyre politikave të cilët shtyjnë për ndryshim, ndryshimi në politikën e brendshme me shumë gjasa vjen kur aktivistët krijojnë mundësi për mbështetje ndaj kauzës së tyre (Ferguson, 1971).

Studimi dhe analizimi i lëvizjeve sociale na sjell në vëmendje vështirësinë që lidhet me interpretimin e tyre dhe kjo edhe nga ndikimi i disa faktorëve të jashtëm. Debatet politike, vëmendja e opinionit publik apo edhe mbulimi jokorrekt nga media i lëvizjeve sociale, mund të konsiderohen si elemente të jashtme të cilat sjellin konfuzion në interpretimin dhe analizimin e lëvizjeve sociale.

Përkufizimi i lëvizjeve sociale mund të përmblidhet në dy drejtime kryesore (Pakulski, 1991):

a- përkufizimi i tyre sipas debateve të teorisë politike. Krahas sfidave ndaj qasjeve të lëvizjeve sociale, duhen përcaktuar edhe çështjet praktike, si ndaj institucionalizimit. Për shembull, në vendet me demokraci të konsoliduar, mobilizimi pas lëvizjeve ambientaliste po tërheq gjithmonë e më shumë mbështetës, duke u kthyer kështu në një kërcënim për partitë politike dhe grupet e tjera të interesit, pasi lëvizjet veprojnë si brenda dhe jashtë kanaleve të politikëbërjes tradicionale;

b- përkufizimi i konceptit. Ndryshe nga format e tjera të bashkëveprimit social, për shembull koncepti i familjes ose i partisë, të cilat janë tërësisht të institucionalizuara, koncepti i lëvizjeve sociale përdoret në një shumëllojshmëri kuptimesh. Në gjuhën e përditshme shërben si përshkrim i aktiviteteve spontane. Njëkohësisht, në fjalorin e lëvizjeve sociale gjendet një përkufizim më i gjerë, si për shembull “format e ndryshme të sjelljes kolektive që kanë për qëllim riorganizimin social”. Mosqartësia dhe konceptualizimi vjen gjithashtu edhe si pasojë e interpretimeve klasike dhe atyre bashkëkohore. Gjatë shekullit XIX lëvizjet sociale trajtohen si

organizime masive dhe spontane apo simptoma të rendit kapitalist, sipas interpretimit që u jep Karl Marksi lëvizjeve sociale, veçanërisht lëvizjeve të punëtorëve, duke i artikuluar këto të fundit si konflikt klasor. Pothuajse të njëjtin prototip të lëvizjeve pa edhe Alex Toquevill-i gjatë Revolucionit Francez, por ndryshe nga Marksi, këtë lëvizje ai nuk e lidhi me ndasitë klasore, por e konsideroi si rezultat i përmirësimit të marrëdhënieve sociale (Tocquevill, 1956).

Max Weber i identifikon lëvizjet sociale, nga njëra anë, me protestat e klasave shoqërore të paprivilegjuara në raport me statusin ekonomik; nga ana tjetër, ai i lidh lëvizjet me liderin (shtrirjen e mbështetjes së liderit karizmatik, popullor etj.). Këto forma interpretimi mbijetuan shumë pak. Ndërsa mendimtarët e shekullit XIX interpretuan lëvizjet e masave rreth modelit të Revolucionit Francez, shqetësimeve politike apo zhvillimit industrial, gjysma e dytë e shekullit XX solli Revolucionin Rus apo mobilizimet fashiste në Europë. Të kombinuara, këto forma interpretimi nxitën zhvillimin e qasjeve mbi lëvizjet masive duke u zhvilluar kryesisht nën interpretimin e sjelljes kolektive.

Sociologu William Kornhauser do të vinte në pikëpyetje pikëpamjet mbi pjesëmarrjen masive/ sjelljen kolektive, duke argumentuar se qytetarët pasivë, normalisht, ndihen të izoluar nga rendi shoqëror, pasi janë të pafuqishëm për të sjellë ndryshimin. Pjesëmarrja në lëvizjet sociale të drejton ndaj idesë së pushtetit, sepse i lejon ata të arrijnë qëllime të përbashkëta dhe në këtë mënyrë, të sjellin ndryshimin social (Hooghe, 2005). Megjithatë, vetëm një pjesë e lëvizjeve sociale kanë tendencën për të ndryshuar rendin social, të tjera kanë për qëllim zbatimin e politikave publike në terma afatgjatë apo drejtimin e shoqërisë ndaj vlerave të cilat ato përqafojnë.

Lëvizjet sociale që lindën dhe u zhvilluan në vitet 1960, sollën një ndikim të madh, gati të detyruar, të studimit të lëvizjeve nga disiplina e shkencave politike, për t'i studiuar ato jo vetëm si grupime me qëllimin për të

transformuar shoqërinë, por edhe si pasojë e rendit socio-politik. Për herë të parë, vetë akademikët filluan të jenë pjesë e këtyre lëvizjeve.

Gjithashtu, disiplinat e historisë apo psikologjisë sollën përfundimet se revolta të tilla nuk mund të shihen më thjesht si reagime emocionale që i kanë munguar historisë politike, por duhet të interpretohen si rezultat i një sërë ndryshimesh në strukturat sociale. Një pjesë e rëndësishme e teorive mbi studimin e lëvizjeve sociale që lindën në atë periudhë e të cilat do të përdoren dhe për këtë artikull, mund të klasifikohen si më poshtë (Pakulski, 1991):

- Teoria e sjelljes kolektive: e përftuar nga Smelser në vitin 1962 dhe e zhvilluar më vonë nga shkolla struktural-funksionaliste. Në fillimet e shekullit XX do t'i shohim lëvizjet sociale të studiuara më së shumti si formë e sjelljes kolektive, e ndikuar kjo nga njohuritë mbi psikologjinë e turmave. Pikëpamja konservatore mbi sjelljen kolektive bazohet mbi teorinë e psikologut Gustave le Bon mbi teorinë e turmave. Le Bon thekson se pjesëmarrësit në tubime masive shfaqin tendencën për të ndjekur turmën dhe mbi të gjitha, ndjekin liderin. Stabiliteti i shoqërisë ishte i sigurt nga elitat kombëtare, të cilat ishin të afta të kundërshtonin çdolloj forme jo të rregullt të pjesëmarrjes (Bon, 1977). Besohej se individët do të humbnin racionalitetin e tyre nëse bëheshin pjesë e turmave. Si përfundim, sjellja kolektive ka aftësinë të orientojë drejt tubimit masiv, trazirave, por gjithashtu edhe drejt dhunës kolektive.

Megjithatë, ky perceptim mbi sjelljen kolektive u rikonceptualizua nga Neil Smelser, duke theksuar se lëvizjet paraqesin forma gjysmëracionale ndaj kushteve "jonormale", që vijnë si pasojë e tendosjes së marrëdhënieve shoqërore dhe institucionale, duke krijuar kështu një mosfunksionim të të gjithë sistemit social (Smelser, 1962).

Së bashku me shfaqjet e tjera të sjelljes kolektive, si paniku, edhe lëvizjet sociale janë pjesë e sjelljes kolektive. Në kontrast me format e tjera, ato janë

plotësisht racionale. Konceptimi dhe shpjegimi i Smelser-it për teorinë e sjelljes kolektive është më i gjerë, më skematik krahasuar me interpretimet e autorëve të tjerë. Principet kryesore të lëvizjeve sociale janë qartësisht të përcaktuara rreth këtyre dimensione të mobilizimit, si karakteri (kolektivja), natyra (joinstitucionale), forma e besimit (aksioni). Arsyetimi i Smelser-it përfshin gjashtë aspekte hierarkike të cilat lidhen me fuqinë, karakterin dhe trajektoren e lëvizjeve (Smelser, 1962): 1- strukturën e përgjithshme depërtuese; 2- tendosjen strukturore; 3- besimet e përgjithësuara; 4- faktorët nxitës; 5- mobilizimin e pjesëmarrësve; dhe së fundmi, 6- mekanizmat për kontrollin social. Këto gjashtë aspekte gjithashtu formojnë atë çfarë autori e quan "skema e shtuar e vlerave" të interpretimit dhe shpjegimit. Për shembull, lëvizjet e orientuara drejt vlerave, me anë të sjelljes kolektive, tentojnë të rikthejnë, mbrojnë, të modifikojnë apo edhe të krijojnë vlera të reja në emër të besimeve të përgjithësuara (Shnabel, 2016). Lëvizjet me të cilat mund të përfaqësohet ky model interpretimi, janë lëvizjet antikolonizim apo lëvizjet radikale revolucionare.

Kritikat me të cilat ballafaqohet qasja e sjelljes kolektive nga Smelser (Pakulski, 1991), së pari, vijnë si pasojë e keqinterpretimit të lëvizjeve sociale, duke i ngatërruar ato me format e tjera të sjelljes kolektive, si paniku, sjelljet armiqësore etj., dhe këmbënguljes që ato reflektojnë orientime dhe besime gjysmëracionale, jo intelektuale. Së dyti, Smelser kritikohet në interpretimin e tij ndaj sjelljes kolektive, pasi vendos format e thjeshta mbi të cilat shfaqet kjo e fundit në një proces kompleks, siç janë lëvizjet sociale. Përfshirja e revolucioneve nga Smleser në interpretimin e sjelljes kolektive duket të jetë e papërshtatshme sipas kritereve të sjelljes kolektive, pasi revolucionet e suksesshme gjithmonë përfshijnë zgjedhjet racionale, të llogaritura, zhvillojnë strategji dhe ndajnë besime. Kjo duket të jetë në kundërshtim me lëvizjet e drejtuara ndaj vlerave sipas interpretimit të tij. Së treti, perceptimi se sjellja normale sociale është e njëtrajtshme me format institucionale dhe konvencionale është realisht sfiduese për kritikët e

teorisë së Smleser-it. Lëvizjet shihen prej tij si kushte patologjike të shoqërisë: struktura e tendosjes dhe mbyllja e hapësirave të zgjedhjes duken si kushtet për krijimin e lëvizjeve sociale.

- Teoria e mobilizimit: zhvilluar më së shumti prej studiuesve amerikanë. Kjo qasje mund të klasifikohet edhe si kritikë ndaj teorisë së sjelljes kolektive. Sociologët John McCarthy dhe Mayer

Zalad do të shënonin pikën kyçe mbi studimin e lëvizjeve sociale. Në studimin e tyre mbi teorinë e mobilizimit (the resource mobilization 1977) (N & D, 1979) studiuesit argumentojnë se lëvizjet sociale nuk janë thjesht forma reagimi për pakënaqësitë apo ankesat e ndryshme. Lëvizjet sociale janë edhe përgjigje e kushteve dhe zhvillimeve, si historike apo edhe politike, për shembull suksesi i disa prej lëvizjeve për të drejtat e njeriut në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndaj, llojet mbi të cilat interpretohen lëvizjet sociale nga autorët që mbështesin teorinë e mobilizimit janë kryesisht në shkallë më të vogël veprimi, drejtuar drejt politikave dhe rrallë shfaqen si grupe të organizuara. Mbështetësit e kësaj qasjeje i shohin lëvizjet sociale si zgjatime të politikës racionale dhe të institucionalizuar. Kështu, lëvizjet sociale kanë si qëllim të influencojnë politikëbërjen duke mobilizuar më shumë burime se instrumentet e politikës tradicionale, duke përfshirë kështu si burimet materiale (para, shërbime etj.) dhe ato jomateriale (autoritet, mbështetje publike, bashkëveprim moral). Me fjalë të tjera, lëvizjet sociale i përfshijnë të dyja format, ato tradicionale dhe ato jotradicionale, të cilat gjenerojnë influencë dhe presion ndaj vendimmarrjes politike. Njësoj si instrumentet tradicionale të politikëbërjes, lëvizjet kanë për qëllim nisjen ose alternimin e politikave apo edhe të ushtrojnë pushtetin tek institucionet politike. Veprimet e anëtarëve të lëvizjeve sociale janë të mirëmenduara, të llogaritura dhe racionale, pasi qëllimet e tyre janë reale dhe të prekshme.

Mbështetësit e teorisë së mobilizimit hedhin poshtë arsyetimet e sjelljes kolektive në lidhje me burimet dhe origjinën e lëvizjeve (Shnabel, 2016). Në vend që të analizohet marrëdhënia e tendosur, përjashtimi politik, frustrimi, vëmendja e analizimit shkon drejt përgjegjësive të reja ndaj situatave të reja dhe mundësive të reja. Lëvizjet nën këtë këndvështrim janë parë si forma të reja të pjesëmarrjes politike, duke krijuar burime të reja të pjesëmarrjes politike në shoqëritë e demokracisë moderne. Gjithashtu, ato mund të shihen si grupe të reja presioni ose filiza të partive demokratike. Nga perspektiva e teorisë së mobilizimit, lëvizjet krijojnë ndërprerje të sjelljes "jonormale", pasi ato shfaqen si pjesë e procesit politik. Eksperimentimi me format e reja të pjesëmarrjes nxit përfshirjen dhe lehtëson artikulimin e pakicës apo interesat e grupeve të papërfaqësuara. Në këtë mënyrë, lëvizjet sociale dhe format e tyre të veprimit janë në përputhje të plotë me principet e demokracisë liberale, si të drejtat për barazi dhe përfaqësim.

Pra, si çdo sjellje tjetër kolektive, lëvizjet sociale kanë nevojë dhe varen nga burimet materiale, nga të cilat mund të përmendim kohën, burimet financiare, organizimin paraprak strukturor apo dhe aftësitë organizuese. Kjo mënyrë të pari e lëvizjeve sociale vjen si rrjedhojë e teorisë së zgjedhjes racionale për të theksuar se pjesëmarrja në lëvizjet sociale nuk është pasojë e frustrimit apo pakënaqësisë momentale, por vjen si konkluzion i domosdoshëm dhe pjesëmarrja konsiderohet e arsyeshme, që do të çojë drejt disa ndryshimeve politike apo sociale. Ndryshe nga organizmat e tjerë shoqërorë apo edhe politikë, që vendosin theksin tek organizimi burokratik për koordinim, lëvizjet sociale kanë të rëndësishëm konsensusin dhe përkushtimin ndaj burimeve të tyre. Studiuesit të cilët mbështesin teorinë e mësipërme, kryesisht fokusohen në analizimin e lëvizjeve lokale, organizimet në shkallë të vogël që nuk tentojnë të dominojnë stabilitetin politik. Ajo çfarë i shpëton shpeshherë vëmendjes së studiuesve, është diferenca gjithëpërfshirëse mes organizimeve në shkallë lokale dhe atyre në shkallë më të gjerë, diferencë e cila përçan dhe transformon rendin social-politik. Pika e dështimit të teorisë së mobilizimit mund të thuhet

se është mbivlerësimi i pyetjes “Si?” duke anashkaluar pyetjen “Pse?”, si dhe tendenca për të adaptuar, instrumentalizuar, lëvizjet sociale (Pakulski, 1991).

4. Konkluzione

Vitet 1970 do të sillnin risi për sa i përket studimit dhe aktivizimit të lëvizjeve sociale, duke mbartur në vetvete paradigmën e re që do të nënkuptonte se karakteristikat strukturore të aktivistëve vijnë nga klasa e re e mesme, dallohen për statusin e tyre arsimor dhe mbi të gjitha, nuk përbëhen ekskluzivisht nga një grup i specifikuar social, mes të cilëve krijojnë marrëdhënie të qëndrueshme dhe universale. Paradigma e re e lëvizjeve sociale për studiuesit do të përkthehej në klasifikime në bazë të logjikës së veprimit të lëvizjeve dhe orientimit të brendshëm, duke i klasifikuar ato si “lëvizje të reja sociale”. Thënë ndryshe, te lëvizjet e reja sociale konfliktualiteti me përfaqësimin nuk vjen më si pasojë e diferencimeve klasore, por nga vlerat e reja, si autonomia, identiteti, varësia apo edhe burokratizimi. Pra, në thelb “e reja”, në vetvete, nuk ndryshon rrënjët e lëvizjeve sociale, por ato marrin vëmendje të re ndaj vlerave të reja dhe mënyrës së tyre të veprimit. Nga ana tjetër, lëvizjet politike marrin jetë kryesisht nga frakturat sociale, përmbajnë në vetvete karakteristika populiste, tentojnë të politizojnë identitetin dhe të institucionalizojnë marrëdhëniet mes grupit mobilizues.

Dy janë elementet që bashkojnë format e demokracisë liberale dhe mobilizimit (i cili konkretizohet në lëvizje sociale dhe politike): **përfaqësimi** dhe **pjesëmarrja**, të cilët përbëjnë dhe elementet e rëndësishme për këtë artikull për të përcaktuar dinamikat e lëvizjeve të reja sociale-politike dhe atyre politike në Shqipëri. Sipas Robert A. Dahl, tipari më i rëndësishëm i demokracisë së drejtpërdrejtë qëndron pikërisht në të drejtën e të gjithë qytetarëve jo vetëm për të miratuar ligje, por edhe për t’i iniciuar ato. Pra, në demokracinë e drejtpërdrejtë qytetarët kanë

karakteristikën e iniciativës ligjvënëse (Dahl, 2005). Në sistemet e demokracisë përfaqësuese kjo karakteristikë delegohet te përfaqësuesit ligjvënës.

Nga ana tjetër, Norberto Bobbio e përkufizon demokracinë në bazë të dy kritereve themelore: a- fuqia vendimmarrëse, e cila duhet të karakterizohet nga një numër shumë i lartë i qytetarëve; dhe b- procesi i vendimmarrjes që duhet të jetë parim i shumicës. Për të demokracia shihet si proces i qeverisjes, duke iu përgjigjur dy pyetjeve: a- Cilët dhe si qeverisin? dhe b- Cili vendos se kush qeveris dhe në bazë të cilës procedurë? (Yturbe, 1997).

Duke qenë se demokracitë liberale (ato përfaqësuese) shpeshherë janë kritikuar si të paafta për të përfaqësuar interesat dhe nevojat e grupeve të ndryshme, format e reja të pjesëmarrjes janë kthyer në një domosdoshmëri. Shembull për këtë ishte fillimi i vitit 1960 në demokracitë e konsoliduara, kur mobilizimi nga poshtë jo vetëm sfidoi elitat politike dhe politikëbërjen tradicionale, por edhe riformësoi rëndësinë e vendimmarrjes së drejtpërdrejtë. Kështu, format e reja të sjelljes kolektive jo vetëm u legjitimuan, por edhe u panë si të arsyeshme dhe të domosdoshme për sistemet demokratike të qeverisjes. Konceptet e liberalizmit dhe demokracisë mund të gjenden në një marrëdhënie të tensionuar atëherë kur reflektohen në sistemin e demokracisë përfaqësuese, nga paaftësia e kësaj të fundit për të mbajtur "premtimet". Aty ku sistemi i demokracisë përfaqësuese e ka të pamundur të përgjigjet në përfaqësim, lëvizjet sociale dhe politike ndërhyjnë duke e korrigjuar atë.

Bibliography

- Bon, L. (1977). The crowd: A study of the popular mind. New York: Penguin Books.
- Dahl, R. (2005). Poliarkia, pjesëmarrja dhe opozita. Tirane: pegi.
- Ferguson, A. (1971). An essay on the history of civil society. Micigan: Online Distributed Proofreading Team.
- Hooghe, M. (2005). Ethnic Organisations and Social Movement Theory: The Political Opportunity Structure for Ethnic Mobilisation in Flanders. Journal of Ethnic and Migration Studies Vol 5 Issue 5, 975-990.
- Klandermans, B., & Staggenborg, S. (2002). Methods of Social Movements Research. Minnesota: The University of Minnesota Press.
- McAdam, D., & Snow, D. (2009). Readings on Social Movements, Origins, Dynamics, and Outcomes. Oxford: Oxford University Press.
- N, Z. M., & D, M. J. (1979). The dynamic of social movements: Reseurce mobilization, social control and tactic. Cambrige:: Winthrop.
- Pakulski, J. (1991). Social movements, the politics of moral protest. Sidney: Longman Cheshire.
- Porta, D. d. (2014). Methodologjical Practicies in Social Movements Research. Oxford: Oxford University Press.
- Shnabel, A. (2016). Social movements and the rationality of choice . Në J. Roose, & H. Dietz, Social theory and social movemnts (fv. 39-55). Wiesbaden.: Springer.
- Smelser, N. (1962). Smelser, N. (1962). Theory of collective behaviour. London: Routlege & Kegan Paul.

- Snow, D., Prota, D., Andermans, B., & McAdams, D. (2013). The wiley-blacwell encyclopedia of social and political movements. Oxford: The wiley-blacwell,.
- Tarrow, S. (1998). Power in Movement. Cambrige: Cambrige University Press.
- Tocquevill, A. d. (1956). The old regime and French revolution. New York: Harper&Row.
- Yturbe, N. (1997). On Norberto Bobbio's Theory of Democracy. Political Theory Vol 25 No 3 SAGE Publication, 377-400.

Williams, Noli dhe Konica, ambasadorët e parë të marrëdhënieve Shqipëri-SHBA

Prof. Asoc. Arben Cici

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

arben.cici@umsh.edu.al

Abstract

In the practice of international law, the recognition of a state and the establishment of diplomatic relations is not a formal procedure only in respect of meeting the conditions of birth and existence of the state according to the criteria of international law. This paper aims at an analysis of historical figures in the establishment of relations between Albania and the USA.

Keywords: Albania, USA, history, diplomatic relations

Abstrakt

Në praktikën e të drejtës ndërkombëtare njohja e një shteti dhe vendosja e marrëdhënieve diplomatike nuk është një procedurë formale vetëm në respekt të plotësimit të kushteve të lindjes dhe ekzistencës së shtetit sipas kritereve të të drejtës ndërkombëtare. Ky punim synon një analizë të figurave historike në vendosjen e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe SHBA.

Fjalë kyce: Shqipëri, SHBA, histori, marrëdhënie diplomatike

Njohja, në themel, është një veprim politik autonom, i shprehur nëpërmjet një veprimi juridik autonom ndërkombëtar, në dobi të interesave dhe dobisë që ajo sjell në planin e brendshëm dhe të jashtëm. Ky veprim shumë i rëndësishëm politiko-juridik merret pas një analize dhe periudhe të domosdoshme njohjeje e vëzhgimi në rrafshin politik dhe ekonomik dypalësh, rajonal e global, gjeo-strategjik e ushtarak, afatshkurtër, afatmesëm e afatgjatë, historik, etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor.

Kjo analizë kërkon angazhim serioz dhe të mjaftueshëm si në aspektin kohor, ashtu edhe në atë njerëzor dhe profesional. Ajo ndihmon jo vetëm në vendimin për njohje ose jo të një shteti por, sidomos në qëndrimin politik që do të mbahet ndaj tij në nivelin dypalësh, rajonal e shumëpalësh, duke e vendosur kështu në rrethin e duhur të miqësisë të veprimeve dhe interesave të politikës së jashtme.

Kjo fazë e gjatë dhe e domosdoshme, për një vendim të pjekur dhe në kohën e duhur për të njohur Shqipërinë nga ana e Shteteve të Bashkuara përfundoi, kur në telegramin e tij të 25 korrikut 1922, Sekretari i Shtetit, Charles Evans Hughes, e udhëzoi Komisionerin Amerikan në Shqipëri, Maxwell Blake, që më 28 korrik 1922, "t'i dërgonte Ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë njoftimin me shkrim për njohjen "de jure" të Shqipërisë nga Shtetet e Bashkuara"[82], duke i hapur kështu rrugën çastit përfundimtar të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike, me dorëzimin e kredencialeve më 4 dhjetor 1922, në Tiranë, nga Ministri Fuqiplotë Ulysses Grant-Smith.

Madje, qeveria amerikane kishte udhëzuar Maxwell Blake të shkëmbente nota zyrtare me Kryetarin e Qeverisë shqiptare të asaj kohe Xhafer Ypin, për të siguruar statusin e ndërsjellë të kombit më të favorizuar në traktatet e ardhshme tregtare midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara[83].

[82] https://history.state.gov/countries/albania
[83] https://history.state.gov/countries/albania

Një nga kontributorët më të devotshëm, të zëshëm dhe të vendosur të marrëdhënieve amerikano shqiptare dhe ndikuesi i palodhur mbi qasjen e politikës amerikane ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë është ambasadori George nFred Williams[84].

Ai mbetet, i ngarkuari i parë zyrtar amerikan për të njohur, vlerësuar dhe raportuar mbi situatën në Shqipëri, në vitin 1914. Ministër fuqiplotë në Greqi, i akredituar edhe në Malin e Zi, Williams u bë përfaqësuesi zyrtar amerikan në Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit për Shqipërinë, me seli në Durrës[85]. Pjesëmarrja e tij në KNK, si pjesëmarrja e parë zyrtare amerikane në çështjet e Evropës, vjen në çastet e ndryshimit të thellë të politikës së saj të jashtme të qartësimit të "Doktrinës Monroe" dhe rivlerësimit të qëndrimit të saj në Evropë dhe ndaj Evropës, nga administrata e re e Presidentit Wilson, i cili, sipas disa qëmtimeve kërkoi zbatimin e "Global Monroe Doctrine".[86]

Raportet, analizat dhe vlerësimet e Ministrit Williams mbi Shqipërinë në Departamentin e Shtetit pasqyronin realitetin e ndodhive dhe përshkrimin e ngjarjeve, interpretuar nga mendësia e këndvështrimi amerikan dhe interesat e qasjet e ShBA-së ndaj Evropës dhe fuqive të Mëdha, në prag të Luftës së Parë Botërore.

Në botimin e tij të vitit 1918, "The Skypetars"[87] ai përshkruan anarkinë që sundonte në Durrës; pamundësinë e funksionimit të qeverisë së Princ Vidit, jo vetëm për shkak të luftërave mes fraksioneve politike e fetare shqiptare, por edhe si rezultat i qëndrimeve kontradiktore dhe mosmarrëveshjeve brenda anëtareve të KNK-së, për të vendosur paqen dhe qetësinë në vend. Përfaqësuesit diplomatikë të fuqive evropiane shikonin ngushtësisht vetëm

[84]https://bioguide.congress.gov/search/bio/W000497
[85]https://tile.loc.gov/storage-services/master/frd/frdcstdy/al/albaniacountryst00zick/albaniacountryst00zick.pdf
86Neil Smith, "A GLOBAL MONROE DOCTRINE?", The Endgame of Globalization, 1st Edition, Published 2004, eBook ISBN9780203997925.
[87]Georges Fred Williams, "The Skymetars" , 1918.

interesat e vendeve të tyre. Ata kishin braktisur misionin e përbashkët për të cilin ishin mandatuar në mbështetje të Princ Vidit dhe funksionimin e shtrirjen e qeverisjes së tij në mbarë vendin.

Williams shkruan: "Unë jo vetëm u habita por edhe u tmerrova, për ngatërresat që gjeta në Durrës. Secili anëtar i komisionit ishte me armë në dorë kundër tjetrit dhe në vend që të dëgjonin mbi lajmet e dobishme që unë solla, secili e shkonte kohën duke më pështpëritur në vesh gjerat pa vend dhe keq-bërjet e tjetrit".[88]

Propozimet e tij për të qetësuare qartësuar situatën në Shqipëri, me hapa e veprime të përbashkëta konkrete, në dobi të qeverisjes Vidi, u ndeshën me kundërshtinë dhe pengesat e këtyre diplomatëve, duke lënë në mëshirë të fatit dhe të fraksioneve politike e fetare vendore, si qeverinë Vidi, ashtu edhe vetë Shqipërinë.

Williams është shumë kritik ndaj qëndrimit të përfaqësuesve të fuqive të mëdha në Shqipëri dhe politikës dhe veprimeve të tyre në raport me qeverinë e Vidit, por sidomos ndaj indiferencës dhe mosveprimit, duke lejuar që, përballë syve të tyre, të bëheshin masakra mizore ndaj popullsisë civile në vend. Kjo ndërhyrje amerikane në punët e tyre në Shqipëri nuk u mirëprit aspak, madje u pengua duke lejuar gjakderdhje vëllazërore dhe liri të plotë si Epirotëve në Jug ashtu edhe kryengritësve të Esad Pashës e Haxhi Qamilit.[89]

Ja si e shpreh zhgënjimin e tij të thellë përfaqësuesi amerikan i KNK-së kur përshkruan implikimin e fuqive evropiane dhe fajësinë e tyre në dramën shqiptare të atyre viteve: "Ai ishte gati të bënte paqe me vlonjatët dhe kur ky lajm erdhi në Vlorë u prit me shumë kënaqësi dhe duartrokitje. Atë mbas-dreke dy luftanije të fuqive të mëdha, që mbanin anëtarët e komisionit

[88]George Fred Willson, "Shqiptarët", Shtëpia Botuese Argeta-LMG, Tiranë, 1999, fq.50.
[89] Idem, fq. 52-53.

ndërkombëtar arritën në liman, të cilat nën hijet e topave të Evropës nuk lejuan bashkimin që unë kisha propozuar"[90]

Duket se Ministri Williams, ky "wilsonian" i thekur, përfaqësues i denjë i korpusit demokrat[91] të ShBA-së, në këtë kënd të humbur të Evropës, kërkoi që edhe vetë Amerika të ishte më e shpejtë, më e drejtpërdrejtë, më e vendosur dhe më e guximshme, në reagimin e saj, deri edhe ushtarak, për të mbrojtur shqiptarët nga padrejtësitë në dritën e diellit.

"Por Amerika rri në heshtje. A nuk ka vapor me kryqëzuar dete për të shpëtuar barinjtë, emigrantë të Vlorës? Asnjë shtet nuk u munduar për t'i ardhur në ndihmë në vuajtjet e rënda këtyre viktimave të diplomacisë së padrejtë të Evropës. Populli i Shteteve të Bashkuara nuk din faktin se unë po i shkruaj këto fletë vetëm për t'i parashtruar këtyre ndodhinë e dhimbshme të shqiptarëve trima të cilët lypin lirinë e tyre" [92] Raportimet dhe analizat e tij të detajuara mbi situatën në Shqipëri padyshim që janë kontribut i vyer, sepse përgatitën terrenin për procesin e njohjes së Shqipërisë nga qeveria e Shteteve Bashkuara të Amerikës dhe qëndrimin e drejtë ndaj saj në forumet ku vendosej fati i Shqipërisë.

Në të njëjtën kohë ato sensibilizuan median[93] dhe opinionin publik amerikan duke ndërmarrë një fushatë ndihme humanitare shumë të nevojshme për një pjesë të popullsisë shqiptare që jetonte në mes të mjerimit dhe kaosit,

[90]Idem, fq. 52.

[91]He wasmember of the State house of representatives in 1890; elected as a Democrat to the Fifty-second Congress (March 4, 1891-March 3, 1893); unsuccessful candidate for reelection in 1892 to the Fifty-thirdCongress; was an unsuccessfulDemocraticnomineeforGovernor in 1895, 1896, and 1897; resumed the practice of law in Boston, Mass.; delegate to several State conventions; delegate to the Democratic National Conventions in 1896, 1900, 1904 and 1908; Minister to Greece and Montenegro in 1913 and 1914; resumed the practice of lawuntilhisretirement in 1930; died in Brookline, near Boston, Mass., July 11, 1932; interment in the Old Village Cemetery, Dedham, Mass.

[92]George Fred Willson, "Shqiptarët", Shtëpia Botuese Argeta-LMG, Tiranë, 1999, fq.67

[93]https://www.nytimes.com/1914/07/08/archives/wilson-to-make-apology-to-europe-voluntary-expression-of-regret-at.html;
https://archive.org/details/independen79v80newy/page/n17/mode/1up?view=theater

mungesës së ushqimeve dhe pasigurisë si pasojë e dëbimit nga shtëpitë dhe shkatërrimit të tyre[94].

"Albanian Relief Fund", një shoqatë bamirëse për mbledhje ndihmash për popullin shqiptar me qendër në New York, i bën apel dramatik jo vetëm popullit amerikan, por në qershor të viti 1915 i dërgoi një letër presidenti Wilson, ku i kërkonte që qeveria amerikane të ndërhynte që anijet amerikane me ndihma humanitare që dërgoheshin prej tyre në Shqipëri të mos pengoheshin nga palët ndërluftuese në Mesdhe.[95] Në letër shkruhej se Shqipëria ishte vend asnjanës në luftën botërore dhe se në atë vend më shumë se gjysma e popullsisë, 500 mijë njerëz ishin duke vdekur nga uria.[96]

Williamse kuptoi sa e rëndësishme ishte pozita gjeografike e Shqipërisë dhe u përpoq të ndërgjegjësonte administratën amerikanë në dy plane: në planin e të drejtave të njeriut dhe të drejtës së ligjshme të një populli, në mbrojtje të territorit dhe kufijve të vet dhe në planin gjeostrategjik afatgjatë të interesave amerikane, duke vënë theksin në faktin se Shqipëria ishte udha natyrale e kalimit prej Adriatikut në Lindje, porta dalëse e tregtisë së Ballkanit dhe një nyje strategjike e kontrollit të ngushticës ushtarake dhe tregtare të Otrantos. Ai kuptoi rëndësinë e korridoreve strategjike të lidhjes se porteve detare shqiptare me portin e Selanikut për dalje në Egje dhe në Bosfor.

"Për të marrë në dorë këta çelësa diplomacia e Evropës ka punuar për dy shekuj rresht", nënvizon në komentet e tij George Fred Williams,[97] i cili shumë shpejt, i ndodhur përballë mos-reagimit të menjëhershëm të ShBA-së zhgënjehet dëshpërimisht dhe reagon duke i dhënë dorëheqjen Presidentit Wilson.

[94]"L'IndependenceAlbanaise", 1 qershor 1915, f.62.
[95]HarisSilajxhic, "Shqipëria dhe ShBA në arkivat e Uashingtonit", Shtëpia Botuese 'Dituria", Tiranë 1999, f.6.
[96]NationalArchives of USA, Washington D.C. Decimal File 1910-1939, 875 48/20.
[97]Georges Fred Williams, "The Skymetars" , 1918, page 20

Një artikull i gjatë, i veçantë, u botua në faqen 13 të gazetës "The Independent"[98] të datës 6 korrik 1914 dhe në New York Times[99] të datës 8 korrik 1914 ku fliste për Ambasadorin Williams, situatën në Shqipëri dhe thirrjen e fortë të tij, vemendjen dhe përqendrimin që administrata e Presidentit Wilson duhet të mbante ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë. "Shqiptarët kanë një aleat të ri. Ai është George Fred Williams, Ministri i Shteteve të Bashkuara në Greqi dhe në Mal të Zi, i cili pasi vizitoi Shqipërinë për të parë situatën nga afër në Principatën e re, është shqetësuar aq shumë nga ato që pa atje, nga punët e këqija të regjimit aktual, sa që dha menjëherë dorëheqjen, madje edhe pa pritur përgjigjen nga Washingtoni,", shkruan The Independent.[100]

Ky diplomat i shkëlqyer i çështjes shqiptare vazhdoi përkushtimin e tij edhe pasi u kthye në Amerikë.

Në mitingun e madh të organizuar nga shoqata "Vatra", më 1 janar 1919, kundër planeve për copëtimin e Shqipërisë gjatë Konferencës së Paqes, Williams, në krah të Fan Nolit e Konicës, mbajti një fjalim të shkëlqyer, duke u konfirmuar pa mëdyshje si një nga personalitetet amerikane që vendosën gurë-themelet e qëndrimeve dhe vendimeve të ShBA-së ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë në çastet jetike dhe kritike të ekzistencës së tyre, një "wilsonian" i vërtetë, në mendje dhe në zemër.

Një tjetër personalitet gur-themeli që ka ndikuar,si në vendimin e njohjes së Shqipërisë, ashtu edhe në qasjes "wilsoniane" ndaj çështjes së Shqipërisë e shqiptarëve,është Fan Noli.

Fati deshte që Presidenti Wilson të kishte të ftuar në ceremoninë që organizoi më 4 korrik 1918, në Malin Vermon, në Washington ketë shqiptar të madh e të palodhur dhe të dëgjojë me kërshëri e vëmendje, përmes një

[98] https://archive.org/details/independen79v80neëy/page/n17/mode/1up?vieë=theater
[99] https://www.nytimes.com/1914/07/08/archives/wilson-to-make-apology-to-europe-voluntary-expression-of-regret-at.html
[100] https://archive.org/details/independen79v80neëy/page/n17/mode/1up?view=theater

elokuence mahnitëse dhe një anglishteje harvardiane, shqetësimin e shqiptarëve dhe kërkesën e drejtë dhe lutjen ndaj Presidentit të vendit më të fuqishëm në botë, i cili kishte vendosur të ndryshonte rrjedhën e ngjarjeve dhe historinë e Evropës dhe të botës.

Fan Noli përfaqësoi shpirtërisht Shqipërinë dhe zyrtarisht "Vatrën", në këtë aktivitet ku Presidenti Wilson kishte ftuar delegatët e Kongresit të Kombeve të Shtypura për të shpallur publikisht edhe programin e "Katër Pikave". Pikërisht, në ditën e kremtimit të lindjes së kombit amerikan, Fan Noli i kërkoi Presidentit Wilson të mbronte, edhe për Shqipërinë, këtë shtet të sapo-lindur, parimet që kishte deklaruar në fjalimin e tij, përpara përfaqësuesve të Kombeve të Shtypura, në mënyrë që edhe ajo të fitonte të drejtat e saj"[101] dhe se "e vetmja shpresë për Shqiptarët është Amerika dhe ju z. President".[102]

Noli u takua dy herë me Presidentin Wilson, brenda kësaj dite historike, për Shqipërinë dhe me peshë në marrëdhëniet e mëtejme, Shqipëri-Shtetet e Bashkuara. Ai mori premtimin nga Presidenti Wilsonse, citoj: "ato parime do të mbretërojnë se për to luftojmë"[103] duke e siguruar se Amerika do të duhej të konsiderohej aleate e Shqipërisë dhe shqiptarëve në këtë kauzë të madhe dhe duke e garantuar se citoj "Unë, u përgjigj ai, do të kem vetëm një zë në kongresin e paqes dhe atë zë do ta përdor dhe për të drejtat e Shqipërisë".[104]

Sipas "Ligjërimeve" të Nolit " Atë ditë fati i Shqipërisë ish m'i ndriçuar" [105] dhe me të drejtë ishte një çast historik për të ardhmen e Shqipërisë, që u vërtetua më pas, nga angazhimi i vendosur dhe i palëkundur i Presidenti Wilson dhe ShBA-së ndaj fatit të Shqipërisë e shqiptarëve.

[101]Fan Noli, "Ligjërimet", Botimet "Dudaj", 2002, f. 96.
[102]Idem.
[103]Idem.
[104]Idem.
[105]Idem.

Në fjalën e tij prekëse, në parlamentin shqiptar, më 11 shkurt 1924, ditën e vdekjes së Presidenti Wilson, Fan Noli kujton: "E kam njohur këtë kalorës të kohëve në një kohë tragjike, më 4 të korrikut 1918, në Yacht-in Presidencial "Mayflower", ku i rrethuar prej kabinetit, prej trupit diplomatik dhe prej përfaqësonjësve të racave të ndryshme në Shtetet e Bashkuara, shkonte te varri i Washingtonit për të prononcuar të parin diskors luftëtar. Ahere iu afrova dhe i bëra një apel në emër të kombit tonë fatzi, dhe përgjigjen e tij bujare e mbaj mend sikur po e dëgjon sot: "Një zë do të kem në kongresin e paqes dhe atë zë do ta përdor për të mirën e Shqipërisë"[106].

Ky duket sa ka qenë takimi i vetëm i Presidenti Wilson me një shqiptar, i cili fatmirësisht ishte Fan Noli, shqiptari më përfaqësues dhe dinjitoz në sytë e Amerikës në ato vite të vështira për Shqipërinë, nëpërmjet të cilit, u krijua një opinion dhe simpati e sinqertë për shqiptarët.

Fatkeqësisht Ministri fuqiplotë i parë zyrtar i Shqipërisë në ShBA nuk mundi të takojë këtë President të dashur e të vlerësuar nga shqiptarët. Për shkaqe të pakuptimta, arsye të vogla dhe të pajustifikuara, në raport me rëndësinë dhe peshën, por edhe me mirënjohjen që na duhet të tregonim ndaj SHBA-së, Shqipëria dërgoi Ministrin e parë diplomatik në ShBA vetëm më 8 tetor 1926. Për herë të parë, zyrtarisht, i Dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministri Fuqiplotë Faik Konica shqiptoi frazën e artë të paraqitjes së letrave kredenciale përpara presidentit amerikan Coolidge.

Faik Konica, me sjelljen dhe aktivitetin e tij, personalitetin dhe përgatitjen e tij mahnitëse, kapërceu shumë shpejt boshllëkun katërvjeçar pa përfaqësues diplomatik në Washington. Gjesti i parë i tij dëshmoi një mirënjohje të thellë e ndjesë të sinqertë ndaj Amerikës. Ai la mbresa vlerësuese në qarqet e larta zyrtare amerikane.

[106]Fan Noli, Vepra, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1996, vëllimi VI, fq. 152.

Konica e dinte se sa shumë Shqipëria i detyrohej Presidentit Wilson, ndaj ai shkoi menjëherë në Kapelën e Betlehemit të Katedrales Kombëtare të Washintonit, për të vendosur një kurorë madhështore, me trëndafila rozë dhe të bardhë, me mbishkrimin "Nga Republika e Shqipërisë", në varrin e Presidentit amerikan, që ndryshoi përgjithmonë fatin e Shqipërisë dhe të shqiptarëve.

"Washington Post" i datës 26 tetor 1926 i bën jehonë këtij veprimi me titullin "Albanian Minister at Tomb of Willson".[107] Faik Konica, ky përfaqësues i shkëlqyer diplomatik i Shqipërisë në Amerikë, falë aktivitetit e sidomos falë njohurive të tij enciklopedike e oratorisë mundi të krijojë një emër të madh dhe një vlerësim të admirueshëm jo vetëm për veten e tij por në dobi të Shqipërisë dhe interesave të saj në Washington.

Ministri Williams, Fan Noli dhe Ministri Fuqiplotë Faik Konica, falë kontributeve dhe përkushtimit të tyre shembullor, i treguan Amerikës për Shqipërinë e vogël dhe ndikuan padyshim në politikën amerikane në vitet e vetmisë së madhe të Shqipërisë, në çastet më të vështira të ekzistencës së saj, ndaj me të drejtë ata mbeten ambasadorët e parë e njëkohësisht arkitektët e themeleve dhe shtratit politik e diplomatik të ecurisë dhe historisë së marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

[107]Washington Post", 26 tetor 1926

Bibliografi

- https://history.state.gov/countries/albania
- https://history.state.gov/countries/albania
- https://bioguide.congress.gov/search/bio/W000497
- https://tile.loc.gov/storage-services/master/frd/frdcstdy/al/albaniacountryst00zick/albaniacountryst00zick.pdf
- https://www.nytimes.com/1914/07/08/archives/wilson-to-make-apology-to-europe-voluntary-expression-of-regret-at.html;
- https://archive.org/details/independen79v80newy/page/n17/mode/1up?vieë=theater
- https://archive.org/details/independen79v80newy/page/n17/mode/1up?view=theater
- https://www.nytimes.com/1914/07/08/archives/wilson-to-make-apology-to-europe-voluntary-expression-of-regret-at.html
- https://archive.org/details/independen79v80newy/page/n17/mode/1up?view=theater
- Neil Smith, "A GLOBAL MONROE DOCTRINE?", The Endgame of Globalization, 1st Edition, Published 2004, e Book ISBN9780203997925.
- Georges Fred Williams, "The Skymetars" , 1918.
- George Fred Willson, "Shqiptarët", Shtëpia Botuese Argeta-LMG, Tiranë, 1999

- Haris Silajxhic, “Shqipëria dhe ShBA në arkivat e Uashingtonit”, Shtëpia Botuese ‘Dituria”, Tiranë 1999
- National Archives of USA, Washington D.C. Decimal File 1910-1939, 875 48/20.
- Fan Noli, “Ligjërimet”, Botimet “Dudaj”, 2002
- Fan Noli, Vepra, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1996, vëllimi VI,
- Washington Post”, 26 tetor 1926

Evazioni fiskal në Shqipëri dhe Itali – një vështrim krahasues

PhD Fiona Tako
Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë
fiona.tako@umsh.edu.al

Abstract

The long transition process in Albania has highlighted a number of problems, among which tax evasion occupies an important place. Tax policies in this direction have focused on the harmonization, consolidation and effectiveness of the legal framework and legal tools for its implementation in practice. Despite the efforts, even though over the years the level of fiscal evasion has suffered a significant reduction, it still remains one of the most problematic issues of the economic-legal system in Albania. Tax control, as one of the main instruments in the fight against evasion, as we will see, is still weak and problematic, mainly for two main reasons: firstly, the level of corruption in this sector and secondly, the behavior of the contributors themselves, be they natural or legal persons.

Keywords: tax evasion; legal framework; punitive measures; comparative view;

Abstrakt

Procesi i gjate i tranzicionit në Shqipëri ka nxjerr në pah një sërë problemesh, ndër të cilët zë një vend të rëndësishëm ai i evazionit tatimor. Politikat tatimore në këtë drejtim kanë patur në fokus harmonizimin, konsolidimin dhe efektivitetin e kuadrit ligjor dhe mjeteve ligjore për zbatimin e tij në konkret. Pavarësisht përpjekjeve, edhe pse ndër vite niveli i evazionit fiskal ka pësuar ulje te ndjeshme, sërish kjo mbetet një ndër çështjet më problematike të sistemit ekonomiko-ligjor në Shqipëri. Kontrolli tatimor, si një ndër instrumentet kryesor në luftën kundër evazonit, ashtu siç do të shikojmë, ende është i dobët dhe problematik, kryesisht për dy shkaqe kryesore: së pari niveli i korrupsionit në këtë sektor dhe së dyti sjellja së vetë kontribuesve, qofshin këta persona fizik apo juridik.

Fjalë kyçe: evazioni fiskal; kuadri ligjor; masat ndëshkuese; vështrim krahasues;

Përgjatë këtyre 30 viteve, sistemi fiskal në Shqipëri ka pësuar ndryshime të shumta. Fillimisht sfida qe ndërtimi nga gjeneza i sistemi fiskal në përputhje me ekonominë e re e të lirë të tregut, që tashmë ishte një koncept që duhej rindërtuar. Kalvari i ndryshimeve dhe përshtatjeve legjislative, që në fillim, paraqiti vështirësi të konsiderueshme dhe impakti konkret në shoqëri ishte, në rastin më të mirë, modest. Menjëherë pas ndryshimit të sistemit qeverisës në vitin 1990, ekonomia jonë karakterizohej nga informaliteti pasi një pjesë e madhe e aktivitetit tregtar ushtrohej "në të zezë", pra pa u regjistruar fare në organet tatimore, duke shmangur plotësisht pagimin e tatimit dhe taksave të tjera në arkën e shtetit, ndërsa, edhe ajo pjesë që ishte e regjistruar, punonte edhe kjo thuajse në informalitet të plotë, duke mos deklaruar të

ardhurat reale nga aktiviteti tregtar. Nga ana tjetër, ky fenomen i informalitetit, përveç se nga vetë sjellja e individit që dihet se ka tendencën e shamngies nga pagesa dhe maksimalizimin e të ardhurave, stimulohej edhe nga faktorë të tjerë siç ishtë mungesa thuajse totale e kontrollit të organeve shtetërore mbi aktivitetet tregtare dhe, mbi të gjitha, niveli i lartë i korrupsionit në administratën tatimore dhe përgjithësisht në të gjithë aparatin shtetëror. Faktor të tjerë të rëndësishëm, me ndikim të madh në rritjen e informalitetit, ishte edhe mungesa e bashkëpunimit midis organeve shtetërore dhe mungesa e profesionalitetit dhe trajnimeve në radhët e punonjësve të administratës tatimore. Ndër vite, faktor tjetër i rëndësishëm në rritjen e nivelit të evazionit, ndoshta edhe padashje, është bërë ndryshimi i shpeshtë i kuadrit ligjor dhe hyrja në fuqi menjëherë i këtyre ligjeve, aq i shpeshtë sa në shumë raste bizneset nuk kanë arritur të informohen në kohë mbi ndryshimet e pësuara. Edhe vetë sistemi, në raste të caktuar, mendohet të ketë influencuar në rritjen e nivelit të evazionit.

Ndryshime të mëdha e të rëndësishme në këtë aspekt u ndjenë fillimisht më konsolidimin e legjislacionit tatimor, rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e administrimit dhe më pas, në vitin 2009, rol të rëndësishëm luajti informatizimi i sistemit të tatim-taksave, duke u bërë i detyrueshëm pagimi i taksave online. Deri në vitin 2014 ndryshimet qenë të vrullshme dhe efektive, duke u forcuar pozicioni i administratës tatimore, duke u zgjeruar fusha e kompetencës së tyre dhe duke u rritur ndjeshëm niveli profesional i kësaj administrate.

Evazioni fiskal ndëshkohet mbi bazë të parimit se ai është një veprim që vjen në kundërshtim me ligjin dhe parimet bazë mbi të cilat ngrihet shoqëria, për shkak se nëpërmjet këtyre veprimeve tentohet shmangia nga detyrimi dhe mospagesa e shumave të përcaktuara në arkën e shtetit, pra në thelb nënkupton një "vjedhje" të shtetit. Evazioni fiskal nuk është një fenomen shqiptar, sigurisht që ai është mbarëbotëror, sigurisht në nivele të ndryshme, dhe ndaj ai konsiderohet si një plagë e madhe sociale në të gjithë

vendet e botës dhe të gjithë, ndër vite, kanë ashpërsuar luftën kundër këtij fenomeni. Kjo luftë bëhet nëpërmjet përdorimit të mjeteve ligjore në dispozicion, por edhe nëpërmjet ndërgjegjësimit të shoqërisë mbi rrezikshmërinë e këtij fenomeni. Çdo qytetar duhet të luajë rolin e vetë në këtë luftë, qoftë duke kërkuar çdo herë, në çdo vend, për çdo shërbim të marrë, faturën tatimore përkatëse. Sot, nëpërmjet parimit "nëse nuk marr kupon tatimor kam të drejtë të mos paguajë", synohet pikërisht kjo, ndërgjegjësimi qytetar dhe lufta e përbashkët, shtet-qytetar, ndaj fenomenit të evazionit.

Në Shqipëri, pjesa ndëshkimore e fenomenit "evazion fiskal" dhe "evazion tatimor" filloi të pësojë ndryshime të rëndësishme duke filluar nga viti 2001. Reformat e ndërmarra midis viteve 2001 dhe 2015 patën një rëndësi të veçantë, së pari në aspektin teoriko-juridik të problematikës, duke mirëpërcaktuar konceptet bazë mbi evazionin tatimor, por edhe në aspektin praktik, kryesisht në lidhje më ndëshkueshmërinë e fenomenit. Kjo sepse përgjatë këtij harku kohor, legjislacioni tatimor dhe Kodi Penal pësuan ndryshime të ndjeshme, duke u shtuar figura të reja të veprave penale, parime të reja por edhe institucione të tëra të reja në fushën e evazionit fiskal. Këto ndryshime i dhanë një fuqi të konsiderueshme instrumenteve ligjor në luftën kundër evazionit, duke u kriminalizuar një sërë veprash penale kundër personit, pasurisë, trafikimeve etj, ndryshime ndër të cilat bëjnë pjesë edhe ato të i takonit nenit 180 të Kodit Penal, konkretisht veprës penale "Mbi fshehjen e të ardhurave" si dhe shtimi i nenit 182 pika a) "Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarive tregtare". Të gjitha reformat, nga viti 1990 e mbrapa, me kriminalizimin e veprimeve te caktuara që lidheshin me aktivitetin tregtaro-ekonomik, synonin krijimin e një sistemi të fortë mbrojtje ndaj këtyre veprimeve të konsideruara nga ligji si të dëmshme për shoqërinë.

Në Shqipëri, sot, rregullimi ligjor i evazionit tatimor mbështetet, përvec se në ligjet e posaçme, edhe në Kodin Penal të ndryshuar. Kodi Penal, në

ndryshimet e tij, në raste të caktuara, e ka konsideruar evazionin si vepër penale dhe ka parashikuar edhe ndëshkimin me burg dhe një ashpërsim i tillë i masave ndëshkimore shihet si një arritje pozitive në luftën kundër këtij fenomeni.

Me ndryshimet e pësuara, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë ka ashpërsuar vazhdimisht sanksionet në rastet e evazionit fiskal, por edhe duke parashikuar vepra të reja penale dhe duke ripërcaktuar llojin e masës dhe mënyrën e caktimit të dënimit penal për ato vepra penale që në fushën tatimore dhe doganore, konsiderohen nga ligjvënësi si të rënda. Stimuli për ashpërsimin e dënimeve penale vjen pikërisht nga nevoja e një fushate të mirëfilltë lufte rrënjësore kundër informalitetit në biznes, por edhe vepra të tjera me impakt të madh në ekonomi, në arkat shtetërore por edhe në jetën sociale të popullatës siç është kontrabanda. Përveç shtimin e veprave penale dhe ashpërsimin e masave ndëshkimore, ndryshimet në Kodin Penal sollën edhe një tjetër risi: bashkimin mekanik të dënimeve. Gjithashtu, ne bazë të ndryshimeve të Kodit Penal, shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, kur përbën kundravajtje administrative, përbën vepër penale dhe ligji ngarkon me detyrim organin tatimor që, menjëherë pasi ka konstatuar shkeljen ti dërgojë prokurorisë aktet e nevojshme për fillimin e procedimit penal. Të gjitha këto masa kanë në fokus pikërisht luftën kundër krimit, forcimin dhe konsolidimin e ligjit në fushën doganore, tatimore si dhe të sigurisë publike, pra kryesisht forcimin e shtetit ligjor.

Në këtë kuadër, një ndër ndryshimet ligjore më të rëndësishme ishte ajo që lidhet me rastin e moskryerjes së detyrave nga ana e organit tatimor. Në këtë rast, pra kur nëpunësi i administratës tatimore nuk arrin të vjelë apo nuk vjel me qëllim, taksat që një subjekt ekonomik duhet të paguajë brenda një afati të caktuar ligjor, ai mund të dënohet deri me 7 vjet heqje lirie. Ndërkohë, nga ana tjetër, subjekti apo individi që kryen veprimtari ekonomike pa u regjistruar në tatime, dënohet deri në 3 vjet burg. Edhe neni 180 gërma a)parashikon që në rastin e ushtrimit të një aktiviteti tregtar të regjistruar në

organet tatimore, mosdeklarimi i të punësuarve si dhe moslëshimi i kuponit tatimor, konsiderohet si vepër penale dhe dënohet me burgim deri në 3 vjet. Vëmë re që dënimi është më i ashpër në rastin kur është punonjësi i administratës ai që nuk kryen si duhet detyrat e tij funksionale. Kjo tregon se ligjvënësi synon të rrisë përgjegjësinë e administratës dhe vigjilencën e saj ndaj evazionit, sigurisht edhe luftën ndaj korrupsionit, duke ashpërsuar masat ndëshkimore individuale të vetë administratës.

Të gjithë këto ndryshime, si në Kodin Penal, por edhe në atë të procedurës penale, kanë ndikuar ndjeshëm në uljen e evazionit fiskal dhe përgjithësisht në atë të krimit financiar. Pavarësisht përmirësimeve të vazhdueshme, ende ndjehet nevoja e vazhdimit të kësaj lufte me qëllim arritjen e një kontrolli më të mirë dhe më efektin në konkret nga ana e prokurorisë në mënyrë të tillë që cikli të përmbyllet më ndëshkimet e duhura ligjore. Gjithashtu, duhet të rritet vigjilenca dhe të forcohet kontrolli doganor, ndoshta duke ashpërsuar edhe më tej masat ndëshkimore si për individët ashtu edhe për administratën, pasi, në shumicën e rasteve, evazioni tatimor konstatohet se realizohet pikërisht në momentin e importit, kryesisht importi i mallrave të ashtuquajtura "të forta" si pijet, duhani dhe karburantet, sepse vendi ynë bazohet pothuajse totalisht tek importi dhe shume me pak tek prodhimi, ndaj dhe në procesin e prodhimi evazioni, në përgjithësi, është shumë më i ulët se në atë të importit. Duhet theksuar edhe se një ndër problematikat më të mëdha të vendit tonë, praktikë dhe problem që haset shumë herë më rrallë në vendet e tjera, është i ashtuquajturi problem i dy bilanceve apo faturave. Kjo është një praktikë e përhapur kryesisht tek shoqëritë e mëdha dhe shpesh herë konstatohet lehtësisht nga marrëdhëniet që ato kanë me bankat. Në këtë kuadër, mendojmë se duhen ashpërsuar masat ndëshkimore edhe për subjektet financiare që bien në dijeni të këtyre fakteve dhe nuk raportojnë në organet kompetente.

Kodi Penal, përsa i përket dënimeve me burgim, që konsiderohet një dënim i rëndë sado të jetë ai, i parashikon ato në raste të caktuara, kur vepra penale

konsiderohet si vepra me rrezikshmëri të mëdha shoqërore sepse prekin interesa të mëdha ekonomike shtetërore dhe shoqërore. Duke qënë se objekti i këtyre veprave penale është i njëjtë, Kodi Penal i ka dedikuar Seksionin e IV, Kreu III, pikërisht veprave penale të kryera nga shoqëri tregtare, por edhe ato me taksat dhe tatimet.

Përsa i përket veprave pale të kryera nga shoqëri tregtare, kodi parashikon një numër të konsiderueshëm të tyre, duke parashikuar si masa ndëshkimore nga gjoba deri në burgim sikurse ndodh në rastin e shpërdorimit të kompetencave nga ana e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorët e shoqërisë, shpërdorim që ka si qëllim final përfitimin personal apo të shoqërisë, apo edhe për të favorizuar një shoqëri tjetër ku shpërdoruesi ka interesa, sanksioni penal parashikon jo vetëm gjobë por edhe burgim gjer në pesë vjet. Një tjetër vepër penale më rëndësi të veçantë në sektorin e veprave penale të kryera nga shoqëritë tregtare është ajo e korrupsionit aktiv dhe pasiv, të parashikuara nga nenet 164/a dhe 164/b të K.P. Korrupsionit aktiv në sektorin privat dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet ndërsa korrupsioni pasiv në sektorin privat dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet. Në këtë rast kemi një diferencim të masës së dënimit midis korrupsionit aktiv dhe atij pasiv, duke u konsideruar më i rëndë dhe me impakt më të madh ky i fundit, dhe rrjedhimisht edhe masa e dënimit është më e madhe. Edhe një sërë veprash penale të tjera në këtë sektor, siç janë falsifikimi i nënshkrimeve, emetimi i parregullt i aksioneve, mbajtja e padrejtë e dy cilësive, dhënia e informacioneve të rreme, zbulimi i sekreteve të shoqërisë tashmë dënohen të gjitha me burgim, maksimalisht deri në 5 vjet. Një tjetër vepër penale që duhet dhe konsiderohet shumë e rëndësishme për shkak të impaktit të madh social dhe shoqëror që ajo ka dhe që mund të konsiderohet pa frikë si një ndër plagët sociale më të mëdha të vendit tonë, është punësimi i paligjshëm. Kodi Penan në nenin 170/a, parashikon se punësimi pa regjistrim në organet kompetente ose pa garantuar sigurimin e të punësuarit sipas rregullave, kur

është dhënë më parë masë administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë deri në 10 mijë lekë për çdo rast ose me burgim deri në 1 vit.

Përmendëm më lart rëndësinë e madhe të ushtrimit të kontrollit doganor në rastin e importit të mallrave, duke qenë se ekonomia e vendit tonë bazohet kryesisht mbi import-eskportin e mallrave dhe më pak në atë të prodhimit. Duke patur parasysh këtë situate, Kodi Penal i ka dedikuar një seksion të plotë, seksionin V të Kreut III, pikërisht krimeve në fushën doganore. Edhe dënimet në lidhje më këto krime kanë ardhur vazhdimisht duke u ashpërsuar me qëllim luftën e korrupsionit, evazionit dhe konkurrencës së pandershme. Kështu, kodi parashikon që kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara, import – eksporti ose transitimi i paligjshëm i këtyre mallrave, i kryer me çdo mënyrë a mjet qoftë, dënohen me burgim deri në dhjetë vjet ndërsa kontrabanda me mallra për të cilat paguhet akcizë, nëpërmjet çdo lloj forme dhe që kanë për qëllim shmangien nga detyrimet doganore ose përfitimin pjesor a tërësor të një përjashtimi, rimbursimi ose reduktimi nga tarifat doganore, taksat, tatimet, akciza ose të një avantazhi të çfarëdoshëm që ka të bëjë me importin ose eksportin e mallrave, dënohet me burgim deri në shtatë vjet, ashtu sikurse ndodh në rastin e import-eksportimi ose transitimit të mallrave, për të cilat kërkohet licencë kur dënimi i parashikuar është burgim deri në pesë vjet. Në rastet e bashkëpunimit apo ripërsëritjes, masat ndëshkimore rriten. Kur kontrabanda kryhet nga punonjës të doganave ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, qoftë edhe në bashkëpunim me persona të tjerë, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. Edhe tregtimi apo transportimi i mallrave kontrabandë dhe ruajtja apo depozitimi i tyre, sërish dënohen me burgim maksimalisht deri në 10 vjet. Të gjithë këto vepra penale janë konsideruar nga ligjvënësi si vepra penale të rënda dhe masat ndëshkimore për to gjithashtu janë të ashpra pasi fokusi është lufta kundër fenomeneve të tilla siç është evazioni dhe kontrabanda.

Ndëshkime të rënda penale janë parashikuar nga ligjvënësi edhe në rastin e veprave penale që lidhen me taksat dhe tatimet, të cilave iu është dedikuar Seksioni VI i Kreut të III të Kodit Penal. Sigurisht që fokusi kryesor i këtyre veprave penale që, duke patur objekt të njëjtë janë përfshirë në të njëjtin kre dhe të njëjtin seksion,është pikërisht fshehja e të ardhurave në dëm të shtetit, duke shmangur pra pagimin e taskave apo tatimeve, sipas parashikimeve të legjislacionit tatimor. Neni 180 i Kodit Penal parashikon pikërisht veprën penale të fshehjes së të ardhurave. Ai parashikon se "fshehja apo shmangia nga pagimi e detyrimeve tatimore, nëpërmjet mosdorëzimit të dokumenteve ose mosdeklarimit të të dhënave të nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi, dorëzimi i dokumenteve të falsifikuara, apo deklaratave ose informacioneve të rreme, me qëllim fitimin material, për vete apo për të tjerët, përmes përllogaritjes së pasaktë të shumës së tatimit, taksës, apo kontributit, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim deri në tri vjet. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se pesë milionë lekë, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet me qëllim fshehjen apo shmangien nga pagimi të një detyrimi tatimor me vlerë më të lartë se tetë milionë lekë, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet". Ligjvënësi ka bërë një përshkallëzim të veprës penale: sa më e lartë të jetë vlera e detyrimit, aq më i lartë dënimi me burgim dhe kjo për shkak se dëmi që i vjen shtetit është në proporcion me fshehjen apo shmangien e detyrimit. Ashtu siç kemi përmendur me lart, neni 180/a trajton situatën e moslëshimit të kuptonit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore nga personi, i cili ka detyrimin të lëshojë kuponin tatimor, dëftesën ose faturën tatimore. Në rastin kur është marrë më pare një masë administrative për të njëjtin veprim, atëherë, në rast ripërsëritje, ai dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Ushtrimi i një aktiviteti tregtar të paligjshëm ose të paregjistruar në organet tatimore, të papajisur me kasë fiskale, sipas dispozitave ligjore në fuqi, ose dhënia e urdhrave në kundërshtim me ligjin, me qëllim moslëshimin e kuponit tatimor, dëftesës ose faturës tatimore, kur

është marrë më parë masa administrative, dënohet me burgim deri në tre vjet. Përsa i përket mospagimit të taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.

Rol të rëndësishëm dhe primar në luftën kundër evazionit por edhe korrupsionit, patjetër që kanë edhe nëpunësit e administratës tatimore. Në këtë aspekt, ligjvënësi ka dashur ta theksojë më shumë përgjegjësine e tyre duke marrë masa ndëshkimore të rënda në raste abuzimesh. Kështu, neni 180 i K.P parashikon se, ashtu siç e kemi përmendur dhe më lart, në rastin e moskryerjes nga ana e administratës tatimore të detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë, që janë ngarkuar me këto detyra, kur bëhet për fajin e tyre, dënohet me burgim deri në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Me informatizimin e sistemit dhe pajisjen e subjekteve tregtare me kasa fiskale, një vepër penale e një rëndësie të veçantë është edhe ajo e parashikuar nga neni 181 i K. P dhe që bën fjalë për rastin e ndryshimit apo ndërhyrjes në aparatet dhe arkat matëse regjistruese e të lëshimit të kuponave, apo përdorimi i aparateve dhe arkave të ndryshuara, apo lejimi i përdorimit nga të tjerët i aparateve dhe arkave të parregullta, me qëllim shmangien nga pagimi i plotë i tatimit. Këto veprime përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim gjer në dy vjet, ashtu sikundër edhe prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare që dënohet me burgim deri në një vit.

Ndër vite, legjislacioni jonë, në fusha të ndryshme, është mbështetur dhe ka huazuar kryesisht nga legjislacioni i shtetit Italian. Në rastin e evazionit fiskal, ajo çka na bie në sy është fakti se rastet e evazionit fiskal dhe masat ndëshkimore për këto raste nuk përfshihen në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë por në dy ligje të posaçme: Dekreti Legjislativ 74 i vitit 2000, i

ndryshuar me Dekret Ligjin nr. 138 i vitit 2011, ndryshuar me Dekretin Legjislativ nr. 158/2015.

Edhe sipas legjislacionit Italia, evazioni fiskal konsiderohet si një vepër penale e mirëfilltë, edhe pse nuk i referohet një sjelljeje specifike të mirëpërcaktuar. Sipas ligjit Italian, dënohet kushdo që, nëpërmjet çdo mjeti apo modaliteti të mundshëm, nuk paguan detyrimet tatimore apo taksat, apo i paguan në një masë më të vogël se sa ajo e duhura, duke i sjellë kështu një dëm arkës së shtetit. Pra evazioni fiskal, sipas legjislacionit Italian, përfshin të gjithë sjelljet e personave fizikë apo juridik, që vinë në kundërshtim me legjislacionin tatimor, në dëm të arkës së shtetit. Ligjvënësi Italian, ndryshe nga ai shqiptar, kur diferencon në këtë sektor midis një vepre penale të dënueshme me burg apo një kundravajtje administrative të dënueshme vetëm me gjobë, këtë e bën duke iu referuar masës së evazionit: shumë që nuk i është paguar arkës së shtetit. Pra, kufiri që ndan ndëshkimin me burg apo me gjobë është i një natyre monetare sasiore: kur vlera është e lartë rrezikohet dënimi me burg, kur ajo është e vogël me gjobë apo shumfish të shumës së papaguar. Është vetë ligji që përcakton këtë kufi.

Dekretet Legjislative të përmendura më lart përcaktojnë kufirin e evazionit, veprimet që e kalojnë dhe klasifikojnë evazionin si një vepër penale. Nën këtë kufi, sipas ligjit Italian, nuk ka asnjë pasojë penale dhe në çdo rast, bëhet fjalë vetëm për tatim mbi të ardhurat, pra ato që quhen Irpef, Ires dhe Iva. Në rastet e tjera që përfshinë Imu, Tasi, Tari, taksat e makinave apo të tjera, kemi të bëjmë ekskluzivisht me sanksione administrative.

Për ligjin Italian, evazioni fiskal merr konotacion penal në disa raste të caktuara si më poshtë:

a) deklarime të rreme;

b) deklarime të pasakta;

c) mungesë deklarimi;

d) mosderdhja e tvsh (Iva);

e) lëshimi i faturave të rreme;

f) fshehje dhe shkatërrim i dokumentacionit kontabël.

Në të gjithë këto raste parashikohen dënime penale, ashtu siç do ti shohim më poshtë, dhe bëhet fjalë për dënime penale personale, që i aplikohen vetëm personave fizikë dhe që nuk trashëgohen tek pasardhësit. Edhe në rastin e shoqërive tregtare, ligji Italian parashikon se ndiqet penalisht vetëm personi fizik që përfaqëson shoqërinë, pikërisht atij të cilit i atribuohet sjellja apo veprimi penalisht i dënueshëm. Gjithashtu, legjislacioni Italian parashikon që ai i cili dënohet për evazion fiskal nuk ka të drejtë të kërkojë pezullimin me kusht të dënimit në rastin kur shuma e padeklaruar kalon 30% të volumit të aktivitetit dhe/ose 3 milion euro.

Në rastin e parë, atë të deklarimit të rremë apo falsifikimit të deklarimeve apo të ardhurave, që është edhe vepra penale më e përhapur në fushën fiskale në Itali, dënimi me burgim parashikohet kur: a) taksa e shmangur është më e madhe se 30 mijë euro, duke iu referuar secilit taksim; b) të ardhurat e padeklaruara kalojnë 5% të totalit dhe sidoqoftë kur janë më shumë se 1.5 milion euro. Dënimi i parashikuar është burgim nga 1 deri në 6 vjet.

Në rastin e dytë, atë të deklarimit të pasaktë, që konsiderohet si i paqëllimshëm por që në çdo rast bëhet fjalë për një sjellje të vetëdijshme, jemi përpara veprës penale të dënueshme me burgim kur: a) taksa e shmangur kalon shumën 150 mijë euro, që së fundmi është ulur në 100 mijë euro; b) të ardhurat e padeklaruara kalojnë 10% të totalit dhe në çdo rast kur janë më shumë se 3 milion euro. Masa e dënimit të parashikuar është nga 1 deri në 3 vjet burg.

Në rastin e tretë, atë të mungesës së deklarimit, që ndodh kur taksapaguesi nuk paraqet deklarimin e të ardhurave brenda 90 ditëve nga përfundimi i afatit të caktuar, bëjmë fjalë për dënim penal kur evazioni fiskal i kalon 50

mijë euro. Në rastin e mosdeklarimit të tvsh-së, caku i caktuar nga ligji është 250 mijë euro. Në këto raste, dënimi i parashikuar është nga 1 deri në 3 vjet.

Në rastin e katërt, atë të lëshimit të faturave të rreme, pra lëshimin e faturave për veprime ekonomike inekzistente, pavarësisht përdorimit të tyre nga ana e atij që i merr këto fatura, dënimi i parashikuar është me burgim nga 6 muaj deri në 6 vjet.

Në rastin e pestë, atë të fshehjes apo shkatërrimit të dokumentacionit kontabël, rast i cili verifikohet kur taksapaguesi fsheh apo shkatërron dokumente të cilat ka detyrim ligjor për ti ruajtur, me qëllimin e fshehjes së volumit real të aktivitetit tregtar apo të ardhurave. Edhe në këtë rast, dënimi i parashikuar është ai me burg për një periudhë që varion nga 6 muaj deri në 5 vjet.

Shohim pra se në rastin e Italisë, rastet e veprave penale që lidhen me evazioni fiskal janë më të kufizuara duke pasur në themel të tyre masën e dëmit që veprimet apo mosveprimet e caktuara i sjellin shtetit, pra arkës së tij, por edhe shoqërisë në tërësi. Dënimet me gjoba apo me pagimin e shumëfishit të vlerës së taksës apo tatimit të padeklaruar, të fshehur apo të deklaruar jo të saktë, sigurisht janë shumë më të shpeshta edhe për faktin se strukturat shtetërore në këtë sektor janë shumë më profesionale dhe të konsoliduara se sa në vendin tonë dhe vjelja e tyre është shumë herë më e lehtë për administratën tatimore. Edhe ndërgjegjësimi qytetar, por edhe frika nga ligji dhe ndëshkimet ligjore, janë shumë më të mëdha së në Shqipëri ndaj dhe masa e evazionit është më e ulët por sigurisht që ekziston pasi, ashtu siç kemi përmendur edhe më lart, vetë natyra njerëzore është e predispozuar për të shmangur pagesa të tilla dhe për të maksimalizuar të ardhurat e vetjake.

Ende mbetet shume për të bërë në fushën e evazionit fiskal dhe tatimor, edhe pse hapat që janë bërë në këtë drejtim kanë qenë të sigurt dhe më rendiment të lartë.